



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Masteri Shkencave në “Menaxhim
Marketing”**

ofruar nga

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Dr. Albana Madhi

PhD. Ani Mbrica

Dhjetor / 2024

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT
Master i Shkencave në “Menaxhim Marketing”

1	IAL aplikues:	Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës (UAMD)
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Marketingut (Fakulteti i Biznesit)
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në “Menaxhim Marketing”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 1002, datë 30.09.2009
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Riorganizuar me Vendim Senati Nr. 113, datë 14.06.2018, miratuar nga MASR me shkresë Nr. 7243/1 Prot., datë 22.08.2018.
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër MASR Nr. 279, datë 22.10.2020
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	12 PAE/ 3 PAK (Aneks tabela 7, v.a. 2022-2023)
18	Numri i studentëve:	42 student (Aneks tabela21, v.a. 2022-2023)
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit Master i Shkencave në “Menaxhim Marketing” ofrohet nga Departamenti i Marketingut në Fakultetin e Biznesit, në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës. Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës, është krijuar me VKM nr. 801, datë 20 dhjetor 2005 “Për hapjen e Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës, si Institucion i Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor në Republikën e Shqipërisë. Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës, ka kaluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit të zhvilluar nga ASCAL. Pas akreditimit të parë institucional në Dhjetor të vitit 2016 me një afat vlefshmërie 4 vite, IAL UAMD ka marrë akreditimin e dytë pozitiv të institucionit sipas vendimit të BA nr.18 datë 24.03.2022 përsëri me një kohëzgjatje prej 4 vite akademike. Afati përfundimtar i vlefshmërisë së akreditimit të IAL është 23.03.2026.

Programi i studimit Master i Shkencave në “Menaxhim Marketing” është ofruar fillimisht sipas VKM-së nr. 685 datë 25.10.2008 “Për riorganizimin e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës” nën emërtimin Master Shkencor në Menaxhim me profil në Marketing licencuar me VKM nr.1002 datë 30.09.2009 në përmbyllje të të cilit lëshohet diplomë e Nivelit të Dytë (DND). Në përputhje me kërkesat e ligjit 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL-të në Republikën e Shqipërisë” programi është riorganizuar si program studimi i ciklit të dytë me emërtimin Master Shkencor në Menaxhim Marketing me vendim të Senatit nr.123 prot. datë 14.06.2018 për riorganizimin, i cili është miratuar sipas shkresës MASR me nr.7243/1 prot. datë 22.08.2018. Gjithashtu sipas shkresës nr. 676 prot. datë 08.06.2020 të Njesisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë, Departamenti i Marketingut ka realizuar riorganizimin e kurrikulës së këtij programi studimi në përputhje me VKM nr.41, datë 24.01.2018 dhe udhëzimin nr.1 datë 14.01.2020.

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës përbëhet nga 5 njësi kryesore/Fakultete: Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Politike, Fakulteti i Edukimit, Fakulteti i Studimeve Profesionale, Fakulteti i Biznesit dhe Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit. Programi i studimit Master Shkencor në “Menaxhim Marketing” ofrohet nga Fakulteti i Biznesit i cili përbëhet nga 5 njësi bazë/Departamente:

- Departamenti i Shkencave Ekonomike
- Departamenti i Menaxhimit
- Departamenti i Marketingut
- Departamenti i Financave – Kontabilitetit
- Departamenti i Turizmit

Aktet rregullatore të IAL-së, Statuti e Rregulloret e Institucionit janë rishikuar në përputhje me ligjin për arsimin e Lartë dhe aktet normative në fuqi, siç janë konstatuar dhe nga GJV gjatë shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitave në IAL. Institucioni ka përgatitur një Plan Strategjik i cili është i nevojshëm për zhvillimin e qëndrueshëm të programit të studimit si dhe përgatitjen për tregun e punës të studentëve që diplomohen.

Programi i studimit Master Shkencor në “Menaxhim Marketing” ofrohet si një program studimi i ciklit të dytë, me 120 kredite, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje 4 semestra akademikë. Ky program studimi është hartuar në konsideratë të zhvillimeve social-ekonomike të vendit tonë si dhe një analize të tregut të punës. Siç paraqitet në dokumentat orientuese të IAL-së, programi synon t’u ofrojë studentëve njohuri të thelluara në fushën e drejtimit marketing, ndërtimin dhe vlerësimin e raporteve ekonomike dhe marketing, përgatitjen e kërkimit sasior dhe cilësor me synim përgatitjen e vendimmarrësve, menaxherëve dhe studiuesve të marketingut. Programi i ciklit të dytë Master Shkencor në “Menaxhim Marketing”synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh dhe specialitetesh si menaxher marketingu, menaxher produkti dhe marke, analist i kërkimit të tregut, menaxher i kërkimit marketing etj. duke plotësuar nevoja të konsiderueshme të tregut dhe institucioneve, në vijim të realizimit të objektivave e prioriteteve strategjike të zhvillimit ekonomik e shoqëror të vendit.

GVJ kërkoi dhe aksesoi gjatë vizitës të dhënat lidhur me përbërjen e stafit, titujt akademikë dhe ngarkesën e personelit akademik. GVJ vlerëson se personeli akademik, ndihmës mësimesh-shkencor dhe administrativ angazhohet për përmbushjen e objektivave të programit të studimit dhe të zhvillimit të institucionit. Drejtoria e Kurrikulës dhe Standarteve të Cilësisë si dhe Departamenti si njësi bazë e zhvillimit të kurrikulave mativ ecurinë e programit të studimit për qëllime përmirësimi duke përdorur një metodologji me instrumente matëse dhe vlerësuese si pyetësorët për studentët, raporte të njëjësive kryesore e njëjësive bazë, vlerësime për pedagogët nga Departamenti i Marketingut, por edhe Fakulteti. Institucioni realizon vlerësim të programit të studimit nëpërmjet pyetësorit të studentëve për vlerësimin e pedagogëve, nëpërmjet studimit të tregut të punës si një proces i drejtuar nga Koordinatori i programit të studimit, nëpërmjet vlerësimeve të NJSBC si dhe vetëvlerësimit nga grupi i vlerësuesve të brendshëm për akreditimin e programit. Vlerësimi zhvillohet gjithashtu nga drejtuesi i njësisë bazë, por edhe në nivel Fakulteti nëpërmjet shkëmbimit interaktiv me stafin dhe vlerësimeve në fund të vitit bazuar në veprimtarinë shkencore të personelit akademik, të cilat rezultojnë të dokumentuara në departamentin e Marketingut si njësi përgjegjëse e programit.

Institucioni vë në dispozicion të studentëve platformën e bibliotekës online, një bibliotekë e pasur me literaturë bashkëkohore, gjithashtu edhe pjesë e rrjeteve dixhitale duke lehtësuar aksesin e studentëve. Pranimi i studentëve në këtë program studimi është realizuar sipas kritereve që vendos ligji Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, por dhe Statutit të Universitetit, Rregullores së Fakultetit, Departamentit dhe të Programit. Institucioni mban të dhëna dhe kontakte me studentët e këtij programi përmes sistemit të komunikimit të brendshëm, ku çdo student ka hapësirë vetjake të dedikuar përmes të cilit informohet e ka akses në dokumentacionin elektronik. GVJ konstatoi se përmes Sektorit të Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës institucioni mban kontakte me studentët dhe pas përfundimit të studimeve. Institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione homologe vendase e të huaja me qëllim kualifikimin e mëtejshëm të stafit, tërheqjen e studentëve të huaj, ndërtimin e programeve të reja të studimit dhe ndërkombëtarizimin

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Procesi i vlerësimit të jashtëm të programit të studimit Master i Shkencave në “Menaxhim Marketing” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës ka ndjekur hapat rigoroze të cilat janë në zbatim të Ligjit për Arsimin e Lartë dhe bazës ligjore për veprimin e Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL). Procesi nisi me kontaktin me ekspertët, të cilët u trajnuan për standardet e cilësisë dhe kriteret, si edhe mbi përdorimin e sistemit elektronik, në seksionin paneli i ekspertit. Në këtë fazë të parë u vendos një komunikim i mirë i grupit të punës, i përbërë nga ekspertët dhe koordinatori Teknik i ASCAL. Pas njohjes dhe vlerësimit të dosjes së vetëvlerësimit të dorëzuar nga institucioni, u hartua axhenda e vizitës në institucion. Në fazën e dytë, u zbatua me rigozitet axhenda e takimeve në 24.10.2023 dhe 25.10.2023, gjatë vizitës në institucion.

GVJ mbledhi informacion të nevojshme për një vlerësim rigoroz bazuar në takime me Dekanin e Fakultetit të Ekonomisë, Përgjegjës të Departamentit të Marketingut, Grupin e vetëvlerësimit, stafin akademik të programit të studimit, Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Sekretarinë mësimore, Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Juridike, dhe Studentët e programit të studimit. Të gjitha informacionet e mbledhura nga takimet, u përdorën nga grupi i vlerësimit të jashtëm, i përbërë nga Dr. Albana Madhi dhe PhD. Ani Mbrica për hartimin e Raportit të Vlerësimit të Jashtëm.

Gjatë të gjithë procesit GVJ u asistua dhe nga koordinatori teknik i ASCAL, Znj. Rajna Lila.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Menaxhim Marketing”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p>	<p>Programi i studimit Master Shkencor në “Menaxhim Marketing” i ofruar nga Departamenti i Marketingut, në Fakultetin e Biznesit, në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës, është në përputhje me Vizionin dhe Qëllimet e Institucionit të shprehura tek Strategjia e Zhvillimit Institucional 2020-2025, miratuar me vendim të Senatit Akademik nr. 1324 prot. datë 26.10.2020 si dhe miratuar me vendimin nr. 1456/6 prot. të Bordit të Administrimit datë 26.11.2020, Pika II (Misioni) dhe IV(Programet e studimit: nevojat e individit, të shoqërisë dhe të tregut të punës). Ky program është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe zhvillimeve ekonomike e sociale të vendit.</p> <p>Duke u karakterizuar gjithnjë e më shumë si një qendër akademike cilësore dhe inovative UAMD integrohet në proceset social-ekonomike, duke garantuar një shtytje të rëndësishme të komponentëve të ndryshëm të shoqërisë, në mirëqënien dhe ndërgjegjësimin e saj. Programet e studimit të ofruara janë bashkëkohore, në përputhje me nevojat e tregut të punës, të territorit, të shoqërisë dhe të studentit, si dhe në interes të zhvillimit rajonal e kombëtar. Nëpërmjet investimit në cilësinë e mësimdhënies UAMD synon që procesi i transferimit të dijeve të jetë gjithnjë e më i harmonizuar me njohuritë më të përparuara kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p>Ky program i paraprin sfidave të politikave të zhvillimit ekonomik në vendin tonë në mbështetje të interesave kombëtare si edhe të prioritetëve të zhvillimit, siç edhe përcaktohen tek shtylla II-Agjenda për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, ndërlidhjen dhe rritjen e gjelbër dhe shtylla III- Kohezioni social të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Europian 2030. Sipas pikës III të strategjisë së IAL UAMD specifikohet se “burime të rëndësishme që konsolidojnë vlerat e UAMD-së, janë Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Konventat Ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe</p>

	<p>Statuti i UAMD-së, në bazë të të cilave Universiteti aspirojnë përmbushjen e misionit të tij në frymën e respektimit të dinjitetit të njeriut, të parimit të barazisë dhe pluralizimit të ideve". Referuar deklaratës së vizionit të Planit Strategjik të departamentit të Marketingut për periudhën 2021-2025, departamenti si njësi bazë që ofron programin e studimit Master Shkencor në "Menaxhim Marketing" synon që së bashku me studentët e tij, të përfaqësojnë një vlerë të shtuar për Fakultetin e Biznesit dhe të shërbejnë si partnerë të çmuar të biznesit dhe institucioneve me të cilat ata bashkëpunojnë, duke ofruar energji të reja dhe inovative, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë dhe konkurrueshmërisë në sektorin ekonomik.</p> <p>Programet e studimit të ofruara nga UAMD, janë një pjesë e rëndësishme me vlerë strategjike për ekonominë e vendit dhe zhvillimin e tij afatgjatë. Zhvillimi ekonomik i vendit nuk mund të arrihet pa zhvillimin e biznesit i cili është i ndërlidhur dhe i integruar me zhvillimet në disiplinën e marketingut gjithashtu. Në këtë kontekst, ndërtimi i programit Master Shkencor në "Menaxhim Marketing", garanton qëndrueshmëri, e cila konstatohet dukshëm përgjatë analizës së treguesve, e përforcuar edhe nga gjykimet e stafit akademik.</p> <p>GVJ gjykon se UAMD nëpërmjet programeve të tij, veçanërisht Master Shkencor në "Menaxhim Marketing", objekt i vlerësimit, përçon vlerat akademike dhe kulturore të vendit, në përputhje të plotë jo vetëm me karakteristikat e modelit të tranzicionit nga ekonomia e centralizuar në ekonomi tregu, por çka është më thelbësorja me burimet njerëzore si edhe mundësitë e sipërmarrjes, për një përdorim efektiv të tyre, me qëllim rritjen ekonomike dhe zhvillimin social të vendit.</p> <p><i>Referenca: An. 1_ Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025.pdf;</i> <i>Referenca: An. 2_ Statuti i UAMD.pdf;</i> <i>Referenca: An. 3_Plan Strategjik i Departamentit Marketing 2021 - 2025 .pdf;</i> <i>Referenca: RVB MSC. Menaxhim Marketing.pdf; Vizita në institucion; Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim European 2030</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>UAMD i udhëhequr nga misioni i përgatitjes së studentëve si profesionistë e qytetarë aktivë për shoqërinë demokratike shqiptare dhe për vlerat evropiane, si dhe duke synuar gjithashtu të formojë specialistë të lartë dhe shkencëtarë të rinj, ka hartuar dhe realizon programe, të cilat garantojnë përvetësimin e dijeve dhe njohurive shumëdimensionale, në drejtimet që vijojnë:</p>

	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Formimin menaxherial në drejtim të zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm. ▪ Përfshirjen e aspekteve praktike me studimet lëndore përgjatë të gjithë kurrikulës, duke mundësuar nxënien e njohjes së transferueshme të aplikueshme në tregun e punës. ▪ Ofrimi i zgjidhjeve të integruara ndaj problematikave rajonale dhe kombëtare të fushave studimore nëpërmjet veprimtarive njohëse, promovuese, krijuese e kërkimore me objektiv promovimin e vlerave qytetare dhe komunitare. ▪ Promovimin dhe mbështetjen e ndërkombëtarizimit të studimeve nëpërmjet ofrimit të programeve në gjuhë të huaj dhe optimizimit të impaktit që mobiliteti ofron. <p>UAMD synon të jetë faktor vendimtar në “ekonominë e dijes”, nëpërmjet formimit të profesionistëve të rinj, të gatshëm të përballen me sfidat e tregut të punës dhe në të njëjtën kohë të shfrytëzojnë mundësitë që bota dhe tregjet ndërkombëtare ofrojnë.</p> <p><i>GVJ vlerëson se programi i studimit Master Shkencor në “Menaxhim Biznesi” në ciklin e dytë të studimeve, si pjesë e Departamentit të Marketingut, hartohet dhe ofrohet në përputhje të plotë me fushën e veprimtarisë së institucionit si edhe me qëllimin dhe misionin e tij.</i></p> <p><i>Referenca: An. 1_ Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025.pdf;</i> <i>Referenca: An. 2_ Statuti i UAMD.pdf;</i> <i>Referenca: An. 3_Plan Strategjik i Departamentit Marketing 2021 - 2025 .pdf;</i> <i>Referenca: RVB MSC. Menaxhim Marketing.pdf; Vizita në institucion;</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimeve akademike të Institucionit.</p>	<p>Programi i studimit Master Shkencor në “Menaxhim Marketing” është hartuar dhe ofrohet nga Departamenti i Marketingut. Rregullorja e departamentit si edhe rregullorja e programit të studimit Master Shkencor në “Menaxhim Marketing” përcaktojnë qartë objektivat e programit, si një program që synon përgatitjen e studentëve si menaxherë marketingu të aftë për të marrë vendime bazuar në egzaminimin sistematik të situatave dhe fenomeneve, vlerësimin e raporteve dhe kërkimin sasior e cilësor gjatë situatave dhe fenomeneve të ndryshme që lidhen me funksionimin e një organizate në kontekstin e menaxhimit të marketingut. Gjithashtu si një program që synon</p>

	<p>përgatitjen shkencore të specialistëve për fushën e marketingut për studime doktorate të mëtejshme.</p> <p>GVJ gjykon që ky program përputhet plotësisht me Strategjinë e Zhvillimit Institucional, e cila i kushton vëmendje të veçantë gjetjes së mënyrave inovatore për rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe ofrimin e njohurive dhe dijeve bashkëkohore, për të realizuar objektivat e institucionit, dhe përtej tyre kontribuar në realizimin e objektivave të zhvillimit ekonomik dhe social të vendit.</p> <p>Rregullorja e programit të studimit Master Shkencor në “Menaxhim Marketing” përcakton qartë në <i>Kreut I, neni 1</i> të saj se përveç mbështetjes në bazën ligjore rregullatore ajo mbështetet gjithashtu në statutin e UAMD-së, rregulloren e Përgjithshme të UAMD-së, rregulloren e Fakultetit dhe Departamentit.</p> <p><i>GVJ konstaton se struktura dhe përmbajtja e programit të studimit përputhet plotësisht me drejtimit themelore akademike të institucionit (Statuti i Institucionit- neni 4 pika 3.a. përgatitja e specialistëve që përmbushin kërkesat e tregut shqiptar e ndërkombëtar të punës, dhe 3.b. formimi i shkencëtarëve të rinj nëpërmjet punës kërkimore e shkencore të nivelit më të lartë bashkëkohor; Rregullorja e Departamentit: kreu V-kërkimi shkencor, neni 21 pika 2: kërkimi shkencor realizohet në përputhje me misionin dhe fushat e veprimtarisë së FB dhe të vetë Departamentit).</i></p> <p><i>Referenca: An._1_ Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025.pdf;</i> <i>Referenca: An._2_ Statuti i UAMD.pdf;</i> <i>Referenca: An. 4 Rregullore e UAMD.pdf;</i> <i>Referenca: An. _12_ Rregullore e programit Master shkencor MM.pdf;</i> <i>Referenca: An. _19_ Rregulloret e Fakultetit të Biznesit.pdf;</i> <i>Referenca: An. _54_ Rregullore e Departamentit Marketing.pdf</i> <i>Referenca: RVB MSC. Menaxhim Marketing.pdf; Vizita në institucion;</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit</p>	<p><i>Statuti i Institucionit (misioni i IAL neni 3 pika 1.c. zhvillimi i të menduarit kritik e analitik si dhe kultivimi i ndjenjës së përgjegjësisë dhe anagzhimit ndaj njeriut, kulturave, ngjarjeve dhe çështjeve të ndryshme që kanë lidhje me individin dhe komunitetin), Rregullorja e Institucionit (neni 30- veprimtaria e kërkimit shkencor, pika 1, IAL UAMD kryen veprimtari kërkimore shkencore bazë ose të zbatuar, studime, eksertizë shkencore, projekte për zhvillim, dhe veprimtari të</i></p>

<p>mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>tjera krijuese që synojnë rritjen e cilësisë së arsimit dhe zhvillimin e vendit), <i>Rregullorja e Departamentit (neni 21 – kërkimi shkencor</i>: Departamenti i Marketingut kryen veprimtari kërkimore shkencore studime, ekspertizë shkencore, projekte për zhvillim dhe veprimtari të tjera krijuese, që synojnë rritjen e cilësisë së arsimit dhe zhvillimin e vendit), <i>Rregullorja e Fakultetit (seksioni II- kërkimi shkencor, neni 26)</i> dhe <i>Rregullorja e programit të studimit (objektivi 2: zhvillimi i aftësive për zhvillimin e fushatave marketing; objektivi 4: përgatitja e profesionistëve në fushën e drejtimit marketing, në përzgjedhjen e alternativave të marketingut dhe të mënyrave më të mira për menaxhimin e tyre; objektivi 7: përgatitja e profesionistëve në fushën e kërkimit sasior dhe cilësor dhe njohjen e modeleve për vlerësimin e këtyre kërkimeve përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike.</i></p> <p>Referuar qëllimit strategjik 4 “Përmirësimi i imazhit të vendit dhe promovimi i produkteve autentike lokale” si dhe objektivit strategjik 4.4. “Ri-orientimi i Promovimit drejt Potencialeve Turistike” dhe objektivit të tij specifik 4.4.1. “Hartimi i Strategjisë së Brandit dhe Marketingut të Turizmit” të Strategjisë Kombëtare të Turizmit 2019-2023, programi i studimit Master Shkencor në “Menaxhim Marketing” i shërben interesit kombëtar dhe adreson prirjet globale të zhvillimit në funksion të krijimit të kapaciteteve të kapitalit human për të kontribuar sipas prioriteteve të kësaj strategjie. Gjithashtu, referuar Strategjisë kombëtare për Zhvillim dhe Integrim European 2021-2030 prioriteti i përcaktuar për zhvillimin e akuakulturës blu dhe ndërtimin e brand-it kombëtar për akuakulturën blusipas agjendës për ekonominë blu korespondon me natyrën dhe konceptimin e këtij programi studimi për të mbështetur këtë prioritet të kësaj strategjie.</p> <p><i>Referenca: An. 2 Statuti i UAMD.pdf;</i> <i>Referenca: An. 4 Rregullore e UAMD.pdf;</i> <i>Referenca: An. 12 Rregullore e programit Master shkencor MM.pdf;</i> <i>Referenca: An. 19 Rregulloret e Fakultetit të Biznesit.pdf;</i> <i>Referenca: An. 54 Rregullore e Departamentit Marketing.pdf</i> <i>Referenca: RVB MSC. Menaxhim Marketing.pdf; Vizita në institucion; Referenca: Strategjia Kombëtare e Turizmit 2019-2023; Strategjisë kombëtare për Zhvillim dhe Integrim European 2021-2030</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Nga shqyrtimi i programit dhe diskutimet e zhvilluara me përfaqësues të UAMD u konstatua se programi Master Shkencor në “Menaxhim Marketing” përbën vlerë të shtuar në ofertën akademike të fakultetit, të</i></p>

	<p><i>transformuar për t'ju përgjigjur nevojave të zhvillimit të vendit. GVJ konstaton se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit përputhet me fushat akademike kërkimore të njësisë kryesore.</i></p> <p><i>GVJ do të sugjeronte përcaktimin e fushave kërkimore të njësisë bazë dhe asaj kryesore duke i përfshirë këto në dokumnetacionin rregullator si tek Rregullorja e Departamentit, Rregullorja e Fakultetit si dhe tek Rregullorja e Programit të studimit. Gjithashtu, GVJ konstaton se mungon një plan strategjik për zhvillimin e programit të studimit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Zbatimi i strategjisë mbi zhvillimin institucional gjen mbështetje në programet e të gjitha cikleve ku përmes shtyllës akademike synohet kryerja me efikasitet e procesit të mësimdhënies, për të mundësuar pajisjen e studentëve me dijet bashkëkohore në fushën e marketingut. Studentët e diplomuar përvetësojnë njohuri të thelluara mbi përvetësimin e aftësive mbi zhvillimin e fushatave marketing, përzgjedhjen e alternativave të marketimit dhe të mënyrave më të mira për menaxhimin e tyre, aftësinë për të ndërtuar dhe vlerësuar raporte ekonomike dhe marketing etj. Ky program studimi synon një edukim dhe përgatitje profesionale të studentëve që ndjekin këtë program.</p> <p>Njësisia bazë ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike për të siguruar cilësinë më të lartë në mësimdhënie.</p> <p><i>Referenca: An._1_ Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025.pdf;</i> <i>Referenca: An._3_ Plan Strategjik i Departamentit Marketing 2021 - 2025 .pdf</i> <i>Referenca: An._5_ Stafit Akademik i Departamentit Marketing per vitet 2013 - 2023.pdf</i> <i>Referenca: An._6_ Stafit akademik i departamentit marketing me fushat.pdf</i></p>

	<p><i>Referenca: An_22_Raporti 2020 - 2021 mbi marreveshjet e bashkepunimit dhe nderkombetarizimit.pdf</i></p> <p><i>Referenca:RVB MSC. Menaxhim Marketing.pdf; Vizita në institucion;</i></p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Fusha e programit të studimit Master Shkencor në “Menaxhim Marketing” është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore – Fakulteti i Biznesit. Në zbatim të Pikës 6 të Nenit 86, “Kodifikimi i programeve të studimit”, të Ligjit 80/2015 si dhe në mbështetje të VKM Nr. 310, datë 11.05.2022 dhe Udhëzimit Nr. 31, datë 15.11.2022, IAL UAMD, ka miratuar me vendim të Departamentit të Marketingut nr.26 datë 05.12.2022 propozimin për kodin 72MS0414 S për programin e ciklit të dytë të studimit Master i shkencave në “Menaxhim Marketing”. Më parë IAL ka aplikuar kodifikimin e programeve sipas kornizës shqiptare të kualifikimeve dhe ISCED-F 2013.</p> <p>Personeli akademik nxitet të marrë pjesë në projekte kërkimore, konferenca e aktivitete të tjera shkencore, të publikojë rezultatet e punës kërkimore. Institucioni ka nxitur dhe mbështetur anëtarët e personelit akademik që të avancojnë në shkallët e kualifikimit të tyre akademik, duke krijuar lehtësira për t’iu përgjigjur përmbushjes së kërkesave ligjore për pjesëmarrje në konferenca, publikimin e artikujve shkencorë si dhe mobilitetin e personelit në institucione të tjera të arsimit të lartë ose ato kërkimore jashtë vendit.</p> <p><i>Referenca: An_1_Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025.pdf;</i></p> <p><i>Referenca:VKM Nr. 310, datë 11.05.2022; Udhëzim Nr. 31, datë 15.11.2022</i></p> <p><i>Referenca:An_3_Plan Strategjik i Departamentit Marketing 2021 - 2025 .pdf;</i></p> <p><i>Referenca:An_6_Stafi akademik i departamentit marketing me fushat.pdf</i></p> <p><i>Referenca:An_9_Kodifikimi i programeve, Vendim Departamenti.pdf</i></p> <p><i>Referenca:An_10_Tabela e kodifikimit perpara hyrjes ne fuqi te bazave ligjore.pdf</i></p> <p><i>Referenca:An_11_Krijimi i grupeve mesimore kerkimore dhe lektoret perkat nder vite.pdf</i></p> <p><i>Referenca:An_65_Rregullore për menaxhimin e aktiviteteve</i></p>

	<p><i>kerkimore - shkencore.pdf</i> <i>Referenca: An. 66_Projekti buxheti i konferencave.pdf</i> <i>Referenca: An. 67_Thirrja nga UAMD per projektet kerkimore shkencore dhe te nderkombetarizimit.pdf</i> <i>Referenca: An. 115_Publikime dhe konferenca shkencore stafi i departamentit.pdf;</i> <i>Referenca: RVB MSC. Menaxhim Marketing.pdf; Vizita në institucion;</i></p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Fusha e programit të studimit Master Shkencor në “Menaxhim Marketing” është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë përgjegjëse bazë për programin e studimit, Departamenti i Marketingut.</p> <p>Duke u bazuar në Planin Strategjik të Departamentit të Marketingut në lidhje me kërkimin shkencor theksohet: Departamenti i Marketingut synon të shndërrohet në një departament udhëheqës në Kërkimin.</p> <p>Shkencor dhe në ofrimin e programeve të studimit të lidhura ngushtësisht me tregun e punës duke u fokusuar drejt inovacionit për të qenë në sinkron të plotëme zhvillimet dinamike në fushën e marketingut.</p> <p><i>Referenca: An. 3_Plan Strategjik i Departamentit Marketing 2021 - 2025 .pdf;</i> <i>Referenca: An. 6_Stafi akademik i departamentit marketing me fushat.pdf</i> <i>Referenca: An. 11_Krijimi i grupeve mesimore kerkimore dhe lektoret perkat nder vite.pdf</i> <i>Referenca: An. 65_Rregullore për menaxhimin e aktiviteteve kerkimore - shkencore.pdf</i> <i>Referenca: An. 66_Projekti buxheti i konferencave.pdf</i> <i>Referenca: An. 67_Thirrja nga UAMD per projektet kerkimore shkencore dhe te nderkombetarizimit.pdf</i> <i>Referenca: An. 115_Publikime dhe konferenca shkencore stafi i departamentit.pdf;</i> <i>Referenca: RVB MSC. Menaxhim Marketing.pdf; Vizita në institucion;</i></p>
<p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia</p>	<p>Ky nuk aplikohet për këtë program studimi.</p>

e tij garantohet nga institucionet partnere.									
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Institucioni, përmes Sektorit të Komunikimit, Alumnit dhe Karrierësi dhe përmes ekspertëve të fushës të ftuar në auditor , ju krijojnë mundësinë studentëve aktual dhe atyre të diplomuar (ish-studentëve, pjesë e Alumni) që të konsultohen në mënyrë të vazhdueshme në lidhje me nevojat e tyre për karrierë dhe riorientim në tregun e punës. <i>Referenca:RVB MSC. Menaxhim Marketing.pdf; Vizita në institucion;</i>								
Konkluzione	<i>Fusha e programit të studimit Master Shkencor në “Menaxhim Marketing” është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë përgjegjëse për programin e studimit.Njësia bazë ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike për të siguruar cilësinë më të mirë në mësimdhënie.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Nga vizita në Institucion, GVJ konstatoi se për mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit të studimit Master Shkencor në “Menaxhim Marketing”, Departamenti i Marketingut si njësi bazë përgjegjëse koordinon punën për të përmbushur objektivat e programit dhe duke angazhuar staf të kualifikuar. Një pjesë e konsiderueshme e lëndëve bazë të programit mbulohen nga stafi me kohë të plotë (rreth 79% e tyre). Programi i studimit Master Shkencor në “Menaxhim Marketing” lejon bashkërendim të stafit në disa disiplina formimi, si e-marketing, kërkim shkencor dhe kontabilitet financiar. I gjithë procesi për përmbushjen e disiplinave të formimit dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor mbikëqyret nga instancat drejtuese të UAMD duke filluar nga Rektori, Dekani, Përgjegjësi i Departamentit, NJZHKSC etj.

	<p>Çdo vit akademik realizohet dhe një analizë e punës së njërive në përputhje me Rregulloren dhe Statutin e UAMD.</p> <p><i>Referenca: An._1_Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025.pdf;</i> <i>Referenca: An._2_Statuti i UAMD.pdf;</i> <i>Referenca: An. 4Rregullore e UAMD.pdf;</i> <i>Referenca: An. _12_Rregullore e programit Master shkencor MM.pdf;</i> <i>Referenca: An. _19_Rregulloret e Fakultetit të Biznesit.pdf;</i> <i>Referenca: An. _54_Rregullore e Departamentit Marketing.pdf</i> <i>Referenca: RVB MSC. Menaxhim Marketing.pdf; Vizita në institucion;</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni për hartimin, mbikqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi. Referuar Ankes tabelës nr.5 institucioni, ka ndërmjetësuar 8 marrëveshje bashkëpunimi me aktorë të tregut të punës në nivel Departamenti dhe 32 marrëveshje bashkëpunimi në nivel Fakulteti (sipërmarrje, institucione publike, OJF, IAL kombëtare e ndërkombëtare) të cilët japin një kontribut tepër të vyer për lehtësimin e tranzicionit të studentëve nga studimi në tregun e punës, nëpërmjet realizimit të praktikave mësimore si dhe mundësi për shkëmbimin e eksperiencave të mësimdhënies në institucionet ndërkombëtare.</p> <p>Sipas raportit vjetor 2020-2021 lidhur me marrëveshjet e bashkëpunimit dhe ndërkombëtarizimin UAMD ka nënshkruar në rang institucional 40 marrëveshje bilaterale nën programin Erasmus+ në kuadër të komponentit të shkëmbimeve. Ndërsa lista e bashkëpunimeve në rang institucional duke përfshirë si partnerë IAL kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe institucione të tjera përfshin 143 aktorë institucionalë.</p> <p>Departamenti dhe të gjithë anëtarët e stafit mund të përfshihen në bashkëpunime nëpërmjet projekteve, nëse kualifikimi i tyre profesional përputhet me kërkesat e projektit.</p> <p>Referuar Planit të Zhvillimit Strategjik të institucionit, çështja VI. Ndërkombëtarizimi specifikohet se UAMD, synon rritjen e vizibilitetit në arenën ndërkombëtare të arsimit të lartë, nëpërmjet zhvillimit dhe forcimit të strukturave primare dhe atyre</p>

	<p>mbështetëse, përndërkombëtarizimin e institucionit. Gjithashtu, objektiv strategjik është edhe zhvillimi, bashkëpunimi dhe nxitja e partneriteteve në nivel lokal, kombëtar, ballkanik, ndërkombëtar nëpërmjet marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe.</p> <p><i>Referenca: An._1_ Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025.pdf;</i></p> <p><i>Referenca: An._20_Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të Fakultetit të Biznesit.pdf;</i></p> <p><i>Referenca: An._21_ Marrëveshje Bashkëpunimi UAMD 2021 - 2022.pdf;</i></p> <p><i>Referenca: An._22_Raporti 2020 - 2021 mbi marrëveshjet e bashkëpunimit dhe nderkombetarizimit.pdf;</i></p> <p><i>Referenca: An._23_Marrëveshjet e bashkëpunimit të Departamentit Marketing.pdf</i></p> <p><i>Referenca: An._24_Lista e Mobilitetit të Stafit & Studenteve në fakultetin e biznesit.pdf</i></p> <p><i>Referenca: An._25_Analiza vjetore e UAMD 2021 - 2022.pdf</i></p> <p><i>Referenca: RVB MSC. Menaxhim Marketing.pdf; Vizita në institucion;</i></p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Referuar rregullores së praktikës që IAL UAMD ka hartuar për programet e studimit master shkencor dhe master profesional, neni 3 i rregullores përcakton sipas pikës 1, 2 dhe 3 se: Zv.Dekani për Kërkimin Shkencor i cili është përgjegjës për Ciklin e Dytë të Studimeve, koordinon dhe monitoron zhvillimin e praktikave mësimore për studentët e të gjitha Master-ave Profesionale dhe Shkencore (me kohë të plotë) në Fakultetin e Biznesit, UAMD; Përgjegjësi i Departamentit organizon procesin e caktimit të pedagogëve përgjegjës për mbikëqyrjen e studentëve gjatë praktikës, si dhe drejton e monitoron procesin që ngamamenti i caktimit të studentëve në institucione/organizata/ kompani e deri në momentin e vlerësimit të kësaj disipline me notë; Fakulteti i Biznesit dhe Zyra e Karrierës kujdeset për parapërgatitjen e studentëve për procesin e praktikave mësimore dhe për orientimin e tyre në institucione/organizata/kompani. Gjithashtu, në pikën 1 të nenit 4 të kësaj rregullore specifikohet se: për gjetjen e institucionit/organizatës/kompanisë ku do të zhvillohet praktika, studentët bazohen te marrëveshjet e bashkëpunimit të Fakultetit të Biznesit. Gjithashtu përdor rrejet individuale (njohje, interes apo sugjerime), si dhe databazën e UAMD.</p>

	<p>Në sajë të marrëveshjeve të bashkëpunimit të arritura nga institucioni (8 marrëveshje bashkëpunimi të nënshkruara në nivel departamenti dhe 32 në nivel fakulteti). Njësia përgjegjëse për programin mundëson realizimin e praktikës profesionale të studentëve. GVJ konstaton se mbikqyrja e praktikës gjithashtu realizohet në mënyrë të institucionalizuar në sajë të dokumentacionit tip të parapërgatitur (paketa e praktikës, neni 4 pika 7 e rregullores) i cili plotësohet nga mbikqyrësi përgjatë realizimit të praktikës mësimore. Takimi me studentët konfirmoi vlefshmërinë e praktikave profesionale, të cilat ju shërbejnë atyre për të fituar shprehitë e para të punës praktike si edhe njohjen me tregun e punës. GVJ vlerëson se në drejtim të praktikave, rrjeti i bashkëpunimeve të njësisë përgjegjëse për programin, përbën një avantazh.</p> <p><i>Referenca: An_20_Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të Fakultetit të Biznesit.pdf;</i> <i>Referenca: An_21_Marreveshje Bashkepunimi UAMD 2021 - 2022.pdf;</i> <i>Referenca: An_22_Raporti 2020 - 2021 mbi marreveshjet e bashkepunimit dhe nderkombetarizimit.pdf;</i> <i>Referenca: An_23_Marreveshjet e bashkepunimit te Departamentit Marketing.pdf</i> <i>Referenca: An_94_Rregullore e Praktikës Profesionale.pdf</i> <i>Referenca:RVB MSC. Menaxhim Marketing.pdf; Vizita në institucion;</i></p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Megjithëse në nivel universiteti, analiza e përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit është objekt diskutimi, njësia përgjegjëse për programin do të ishte e interesuar të analizonte përfitimet në fushën e saj të interesit. Megjithatë kjo analizë nuk mund të realizohet nga njësia përgjegjëse për programin, pasi institucioni menaxhohet kryesisht në mënyrë të centralizuar. Njësia përgjegjëse për programin raporton, por nuk analizon në mënyrë të pavarur, sepse marrëveshjet janë në nivel institucioni. Sidoqoftë, njësia përgjegjëse është pjesë e analizës vjetore. Një formë e analizës së këtyre përfitimeve e realizuar nga Departamenti i Marketingut është pikërisht integrimi i çështjes së përcaktuar nga ky kriter në analizën vjetore të arritjes së objektivave të Departamentit, si dhe gjurmimi i të dhënave të punësimit të studentëve si rezultat i marrëveshjeve të</p>

	<p>bashkëpunimit. GVJ konstaton gjithashtu se çështja e përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit nuk analizohet si tematikë e veçuar, por në kuadrin e përgjithshëm të analizës vjetore. Në këto kushte GVJ do të sugjeronte hartimin e një dokumenti tip të analizës së përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në nivelin e njësisë përgjegjëse për programin e studimit.</p> <p><i>Referenca: An_22_Raporti 2020 - 2021 mbi marreveshjet e bashkepunimit dhe nderkombetarizimit.pdf;</i> <i>Referenca: RVB MSC. Menaxhim Marketing.pdf; Vizita në institucion;</i></p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se IAL nuk ka një strategji ndërkombëtarizimi aktuale, ndërsa në dokumentin e planit strategjik të IAL përmendet Strategjia e Ndërkombëtarizimit 2019-2021. GVJ sugjeron hartimin e strategjisë së ndërkombëtarizimit për periudhën 2022 e në vijim.</i></p> <p><i>GVJ konstaton gjithashtu se çështja e përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit nuk analizohet si tematikë e veçuar, por në kuadrin e përgjithshëm të analizës vjetore. GVJ do të sugjeronte hartimin e një dokumenti tip të analizës së përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në nivelin e njësisë përgjegjëse për programin e studimit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi është i organizuar në përputhje me Sistemin European të Transferimit të Krediteve (ECTS), konkretisht si një sistem studimi me kohë të plotë, me 120 ECTS, me kohëzgjatje 2 vite akademik.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Sipas planit mësimor ky program përbëhet nga Lëndë bazë të detyrueshme- përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme (3 lëndë/module/3 x 4 ECTS=12 ECTS/10%), 2. Lëndë Karakterizuese- (9 lëndë/module/9 x 7 ECTS= 63 ECTS/ 52.5%), 3. Lëndë ndërdisiplinore ose/dhe integruese (10 lëndë/module /me zgjedhje 4 nga 10 lëndë/4 x 5 ECTS= 20 ECTS/16.6%), 4. Lëndë Plotësuese- praktika profesionale (1 lëndë/module/12 ECTS/10%), si edhe Detyrimet Përmbyllëse – Mikroteza/13 ECTS/10.9%). <p>Plani mësimor është i organizuar në 2 semestra të shpërndarë në një vit akademik, me lëndë e module të vlerësuara me kredite.</p> <p>Detyrimi përmbyllës për marrjen e diplomës shlyhet në trajtën e një Mikroteze. Kreditet e çdo disipline mësimore dhe veprimtarie formuese përlllogariten duke mbajtur parasysh ngarkesën në orë mësimore në auditor, si dhe punën individuale që duhet kryer nga studenti për përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara në programin e lëndës. Një kredit është 25 orë mësimore punë e studentit, ku futen orë mësimore në auditor (leksione, seminare, ushtrime, projekt/detyra, dhe veprimtari të tjera formuese brenda disiplinës), si dhe orë pune individuale të studentit.</p> <p><i>Referenca: An. _12_Rregullore e programit Master shkencor MM.pdf;</i></p> <p><i>Referenca: An. _44_Kurrikul dhe plani mesimor Master shkencor</i></p>

	<p><i>MM riorganizim1.pdf;</i> <i>Referenca: Ligji për Arsimin e Lartë 80/2015; VKM 412, viti 2018;</i> <i>VKM 879, viti 2019</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale dhe specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>GVJ, pasi analizoi programin e studimit, mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni si edhe pas diskutimeve me stafin akademik të institucionin, gjykon se programi që vlerësohet realizon formimin e shprehive të veçanta dhe aftësimin e profesionistëve të ardhshëm me qëllim që t’iu përgjigjet më mirë nevojave të tregut, mbështetur edhe në eksperiencën e institucionit. Njësia kryesore ofron programin e studimit Master Shkencor në “Menaxhim Marketing” si Diplomë e veçantë. Hapja e këtij program është udhëhequr nga analiza e nevojave të tregut kryesisht.</p> <p>Përcaktimi i rezultateve të të nxënimit në programet mësimore (syllabuset e lëndëve) të secilës lëndë, ndihmon vlerësimin e arritjeve të studentëve në drejtim të formimit të shprehive të veçanta. Në dokumentin objektivat e programit të studimit rezultatet e të nxënimit të programit të studimit përfshijnë aftësi për: përzgjedhjen e teknikave të duhura për menaxhimin e mediave, zhvillimin e fushatave marketing, ekzaminimin sistematik të temave të ndryshme mbështetur në baza të fortateorike, përzgjedhjen e alternativave të marketimit dhe të mënyrave më të mira për menaxhimin e tyre. Këto rezultate të të nxënimit pasqyrohen gjithashtu sipas lëndëve të ofruara nga programi i studimit tek silabuset përkatëse të shprehura në terma të njohurive, aftësive dhe kompetencave profesionale dhe analitike që përfiton studenti.</p> <p>GVJ gjykon që nevojitet një studim tregu i aktualizuar që nxjerr në pah nevojat reale të tregut në fushën e marketingut. Ky studim do të ndihmonte IAL për të evidentuar aftësitë që i nevojiten studentit që studion në këtë program studimi Gjithashtu, IAL duhet të kryej një rishpërndarje të lëndëve në kurrikul edhe në përputhje me shpjegimin e kategorive të veprimtarive formuese, kryesisht në kategorinë A - Lëndë bazë të detyrueshme, kategorinë B- Lëndë karakterizuese dhe kategorinë C - Lëndë ndërdisiplinore. Në kategorinë C të veprimtarisë formuese lëndët duhet të pasqyrojnë profilizimin në menaxhim marketingu dhe jo në fusha të tjera.</p> <p>GVJ gjykon që njësia kryesore është e pajisur me të gjitha</p>

	<p>instrumentat dhe kapacitetet e nevojshme që të realizojë programet e studimit të ciklit të dytë tilla që zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fushën akademike dhe profesionale të marketingut.</p> <p><i>Referenca: An. _12_Rregullore e programit Master shkencor MM.pdf;</i></p> <p><i>Referenca: An. _44_Kurrikul dhe plani mesimor Master shkencor MM riorganizim1.pdf;</i></p> <p><i>Referenca: An. _46_Objektivat e Msc Menaxh marketing.pdf</i></p> <p><i>Referenca: An. _50_Syllabuset e lendeve te MSH per vitin 2022 - 2023.pdf</i></p> <p><i>Referenca:RVB MSC. Menaxhim Marketing.pdf; Vizita në institucion;</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Programi i studimit Master Shkencor në “Menaxhim Marketing” është i organizuar në module të formimit të përgjithshëm, të formimit karakterizues, ndërdisiplinore dhe/ose integrues si edhe module formuese me zgjedhje, përveç praktikës mësimore profesionale dhe përgatitjes së diplomës, të cilat e kanë të përcaktuar qartë përbajtjen e tyre, mënyrën e organizimit si edhe format e mësimdhënies.</p> <p>Plani mësimor i programit të studimit Master Shkencor në “Menaxhim Marketing” përcakton ngarkesën në kredite lidhur me praktikën profesionale dhe detyrimet përmbyllëse, specifikisht tek kategoria D (12 ECTS ose 10%) - lëndë plotësuese ku përfshihet Praktikë Profesionale dhe tek kategoria E (13 ECTS ose 10.9 %) detyrime përmbyllëse, në përputhje me specifikimet ligjore.</p> <p><i>Referenca: An. _12_Rregullore e programit Master shkencor MM.pdf;</i></p> <p><i>Referenca: An. _44_Kurrikul dhe plani mesimor Master shkencor MM riorganizim1.pdf;</i></p> <p><i>Referenca: An. 48Rregullore e Mikrotezës .pdf</i></p> <p><i>Referenca: An. 49. E-mail i komunikimit me student te MSH per temen e diplomes.pdf</i></p> <p><i>Referenca:Ligji për Arsimin e Lartë 80/2015; VKM 412,viti 2018; VKM 879,viti 2019</i></p> <p><i>Referenca:RVB MSC. Menaxhim Marketing.pdf; Vizita në</i></p>

	<i>institucion;</i>
<p>Kriteri 4.Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	Këto kritere nuk aplikohen për këtë program studimi.
<p>Kriteri 5.Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	
<p>Kriteri 6.Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	

<p>Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtësë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Programi i studimit Master Shkencor në “Menaxhim Marketing” ka një ngjashmëri rreth 70% me programin e studimit Master Shkencor në Marketing ofruar nga Fakulteti i Ekonomisë së Universitetit të Tiranës. Kjo ngjashmëri mundëson bashkëpunim në fushat e studimit dhe për organizimin e konferencave.</p> <p><i>Referenca: An. _50_Syllabuset e lendeve te MSH per vitin 2022 - 2023.pdf</i> <i>Referenca:RVB MSC. Menaxhim Marketing.pdf; Vizita në institucion;</i></p>
<p>Kriteri 8.Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Në zbatim të Pikës 6 të Nenit 86, “Kodifikimi i programeve të studimit”, të Ligjit 80/2015 si dhe në mbështetje tëVKM Nr. 310, datë 11.05.2022 dhe Udhëzimit Nr. 31, datë 15.11.2022, IAL UAMD, ka miratuar me vendim të Departamentit të Marketingut nr.26 datë 05.12.2022 propozimin për kodin 72MS0414 Spër programin e ciklit të dytë të studimit Master i shkencavenë “Menaxhim Marketing”. Kodifikimi i programit ndihmon edhe në kodifikimin dhe klasifikimin e lëndëve.</p> <p><i>Referenca:An. _9_Kodifikimi i programeve, Vendim Departamenti.pdf</i> <i>Referenca:An. _10_Tabela e kodifikimit perpara hyrjes ne fuqi te bazave ligjore.pdf</i> <i>Referenca:RVB MSC. Menaxhim Marketing.pdf; Vizita në institucion;</i></p>
<p>Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>Institucioni nuk ofron aktualisht një program studimi të përbashkët me ndonjë universitet partner ndërkombëtar por është në proces të realizimit të një marrëveshje të tillë.</p> <p><i>Referenca:An. _51_Komunikim me universitetin e Spanjes per diploma duale .pdf;</i> <i>Referenca:RVB MSC. Menaxhim Marketing.pdf; Vizita në institucion;</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ, pasi analizoi programin e studimit, mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni si edhe pas diskutimeve me stafin akademik të institucionin, gjykon se programi që vlerësohet realizon formimin e shprehive të veçanta dhe aftësimin e profesionistëve të ardhshëm me qëllim që t’iu përgjigjet më mirë nevojave të tregut, mbështetur edhe në</i></p>

	<p><i>eksperiencën e institucionit.</i></p> <p><i>GVJ gjykon që nevojitet një studim tregu i aktualizuar që nxjerr në pah nevojat reale të tregut në fushën e marketingut. Ky studim do të ndihmonte IAL për të evidentuar aftësitë që i nevojiten studentit që studion në këtë program studimi. Gjithashtu, IAL duhet të kryej një rishpërndarje të lëndëve në kurrikul edhe në përputhje me shpjegimin e kategorive të veprimtarive formuese, kryesisht në kategorinë A - Lëndë bazë të detyrueshme, kategorinë B- Lëndë karakterizuese dhe kategorinë C - Lëndë ndërdisiplinore. Në kategorinë C të veprimtarisë formuese lëndët duhet të pasqyrojnë profilizimin në menaxhim marketingu dhe jo në fusha të tjera.</i></p> <p><i>GVJ konstaton se programi Master Shkencor në “Menaxhim Marketingu” ofron njohuri të përparuara në fushën e studimit marketing. GVJ gjykon që program i studimit që vlerësohet, nëpërmjet veprimtarive formuese të tij, ndikon në arritjen e objektivave akademike të mësimdhënies dhe të mësimnxënies.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Fakulteti i Biznesit pranë IAL UAMD është Njësia Kryesore përgjegjëse për programin e studimit në akreditim. Ky fakultet është hapur me Vendim të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Nr. 801, dt 20.12.2005, si një nga njësitë kryesore të Universitetit “Aleksandër Moisiu” (UAMD). Kur u krijua ai njihet si “Fakulteti i Ekonomisë dhe Administrimit”, ndërsa që nga viti 2010 emërtohet si “Fakulteti i Biznesit” (FB). Fakulteti përbëhet nga pesë njësi bazë, ndër të cilët Departamenti i Marketingut është</p> <p><i>Njësia Bazë përgjegjëse për programin e studimit Master Shkencor në “Menaxhim Marketing”. Organizimi dhe struktura e fakultetit është në përputhje të plotë me nenin 23 të Ligjit 80/2015. Pas akreditimit të parë institucional në Dhjetor të vitit 2016 me një afat vlefshmërie 4 vite, IAL ka marrë akreditimin e</i></p>

dytë pozitiv sipas VBA nr.18 datë 24.03.2022 me një kohëzgjatje prej 4 vite akademike, me afat vlefshmërie 23.03.2026. Struktura akademike përputhet plotësisht me misionin, qëllimin dhe objektivat e Programit që vlerësohet. Organizimi i saj mbështet plotësisht aktivitetin akademik si edhe operacional.

Të dhëna për Departamentin e Marketingut:

Tituj/ grada	2020 – 2021		2021 – 2022		2022 – 2023	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	1	1	1	1	-	2
Prof. Asoc.	6	3	6	3	4	2
Dr./PhD.	7	1	6	2	5	-
Msc.	2	9	2	10	2	7
Totali	16	14	15	16	11	11

Stafi akademik që angazhohet në realizimin e programit të studimit Master Shkencor në “Menaxhim Marketing” ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit në përputhje me kërkesat bashkëkohore të sigurimit të cilësisë të moduleve mësimore.

Në këtë program studimi, për vitin akademik 2022-2023 stafi akademik i angazhuar që mban gradën Profesor dhe Profesor i Asociuar përbën 60%, dhe 40% e stafit të angazhuar mban gradën Doktor (sipas aneks tabelës 6). Konkretisht:

Për vitin akademik 2022-2023:

Personeli akademik i brendshëm i angazhuar në këtë program studimi (PAE) rezulton se është (12 gjithsej) ndërsa Personeli akademik i jashtëm (PAK) rezulton se është (3 gjithsej) me këto kualifikime (sipas aneks tabelës 6.1 dhe 7):

Titulli/Grada	PAE	PAK
Prof.Dr	1	1
Prof As	5	2
Dr	6	-
Msc	-	-
Gjithsej	12	3

Raporti është 80 % PAE dhe 20 % PAK. Ky fakt tregon se Personeli akademik me kohë të plotë kundrejt atij me kohë të pjesshme, përmbush detyrimet ligjore (Vendimit Nr 418, date 10/05/2017) për raportin të paktën 70 % PAE dhe jo më shumë se 30 % PAK.

Për vitin akademik 2021-2022:

Personeli akademik i brendshëm i angazhuar në këtë program studimi (PAE) rezulton se është (12 gjithsej) ndërsa Personeli akademik i jashtëm (PAK) rezulton se është (2 gjithsej) me këto kualifikime (sipas aneks tabelës 6.2 dhe 7):

Titulli/Grada	PAE	PAK
Prof.Dr	-	-
Prof As	5	-
Dr	7	2
Msc	-	-
Gjithsej	12	2

Raporti është 85,7% PAE dhe 14,3% PAK. Ky fakt tregon se personeli akademik me kohë të plotë kundrejt atij me kohë të pjesshme, përmbush detyrimet ligjore (Vendimit Nr 418, date 10/05/2017) për raportin të paktën 70 % PAE dhe jo më shumë se 30 % PAK.

Për vitin akademik 2020-2021:

Personeli akademik i brendshëm i angazhuar në këtë program studimi (PAE) rezulton se është (12 gjithsej) ndërsa Personeli akademik i jashtëm (PAK) rezulton se është (2 gjithsej) me këto kualifikime (sipas aneks tabelave 6.3 dhe 7):

Titulli/Grada	PAE	PAK
Prof.Dr	-	1
Prof As	6	-
Dr	6	1
Msc	-	-
Gjithsej	12	2

Raporti është 85,7% PAE dhe 14,3% PAK. Ky fakt tregon se personeli akademik me kohë të plotë kundrejt atij me kohë të pjesshme, përmbush detyrimet ligjore (Vendimit Nr 418, date 10/05/2017) për raportin të paktën 70 % PAE dhe jo më shumë se 30 % PAK.

Njësia bazë merr të gjitha masat për të garantuar zhvillimin e vazhdueshëm profesional dhe shekncor të stafit, e cila realizohet nëpërmjet:

	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Seminareve dhe trajnimeve të organizuara nga njësia. ▪ Pjesëmarrjes në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare. ▪ Pjesëmarrjes në projekte ▪ Shkëmbimeve akademike nëpërmjet projektit Erasmus. <p>Çdo udhëtim apo pjesëmarrje sjell praktika të reja mësimdhënie, të cilat ju bëhen të njohura të gjithë anëtarëve të stafit nëpërmjet raporteve që plotësohen nga secili përfitues, pas kthimit nga aktiviteti. Këto praktika diskutohen në departament dhe ndihmojnë njësinë për të krijuar dhe zbatuar metoda të reja novatore. Diskutimet me stafin gjatë vizitës në institucion përforëcuan opinionin se mobiliteti i stafit është një mënyrë shumë e mirë për rritje dhe zhvillim.</p> <p>Gvj, pasi analizoi dokumentacionin, gjykon që Njësia bazë, përgjegjëse për programin që vlerësohet, i përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p> <p><i>Referenca: An. 2 Statuti i UAMD.pdf;</i> <i>Referenca: An. 4 Rregullore e UAMD.pdf;</i> <i>Referenca: An. 12 Rregullore e programit Master shkencor MM.pdf;</i> <i>Referenca: An. 19 Rregulloret e Fakultetit të Biznesit.pdf;</i> <i>Referenca: An. 27 RVB e fakultetit te biznesit 2020-2021.pdf</i> <i>Referenca: An. 54 Rregullore e Departamentit Marketing.pdf</i> <i>Referenca: An. Tabelat shoqeruese ASCAL.pdf</i> <i>Referenca: RVB MSC. Menaxhim Marketing.pdf; Vizita në institucion;</i> <i>Referenca: Ligji 80/2015</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Departamenti si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit në procesin e zhvillimit të praktikës profesionale sipas dokumenti Rregullore e Praktikës (referenca 94) specifikon se në fillim të semestrit studenti në bashkëpunim me pedagogun e praktikës për zgjedhin institucionin ku studenti do të zhvillojë praktikën si dhe objektivat për tu përmbushur gjatë periudhës së praktikës. Ndërsa në funksion të lëndës metodat e kërkimit shkencor studentët mund të kryejnë disa orë mësimore në laboratorët e IT për përpunimin e të dhënave për detyrat e kursit, projektet si dhe mikrotezën.</p> <p><i>Referenca: An. 2 Statuti i UAMD.pdf;</i></p>

	<p><i>Referenca: An. 52 Foto të laboratorëve dhe auditoreve .pdf</i> <i>Referenca: RVB MSC. Menaxhim Marketing.pdf; Vizita në institucion;</i></p>			
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Njësia kryesore i kushton rëndësi të veçantë përgatitjes së dokumentacionit i cili udhëheq veprimtarinë e institucionit. Shqyrtimi i dokumentacionit të Njesisë bazë (neni 7, pika 4 dhe neni 15), konfirmon se koordinatori i programit të studimit koordinon punën për përgatitjen e dokumentacionit pedagogjik; programeve lëndore (syllabuset), paketën e praktikës profesionale dhe të udhëzimeve për temën e Diplomimit. Gjithashtu koordinatori i programit të studimit kujdeset për implementim të të gjitha aktiviteteve të planifikuara në program e studimit që ai koordinon, mban kontakte dhe ndihmon në organizim të takimeve me biznese dhe tryeza të tjera me qëllim nxitjen e bashkëpunimit, realizimin e analizave të punës së përbashkët, merr pjesë në tryeza ad hoc në interes të programit të studimit; nxit dhe ndjek krijimin e marrëveshjeve në funksion të programit të studimit; mbikëqyr procesin e kryerjes së praktikave studentore; organizon vlerësimin e brendshëm të Programit të studimit; si dhe kryen detyra të tjera që i caktohen nga Përgjegjësi i Departamentit të Marketingut.</p> <p>Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga UAMD (referenca53 Memo e departamentit për koordinorët e masterit) koordinatori i programit të studimit emërohet nga përgjegjësi i departamentit.</p> <p><i>Referenca: An. 54 Rregullore e Departamentit Marketing.pdf</i> <i>Referenca: An. 53 Memo e Departamentit për koordinorët e Masterit.pdf</i> <i>Referenca: RVB MSC. Menaxhim Marketing.pdf; Vizita në institucion;</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ, pasi analizoi dokumentacionin, gjykon që Njësia bazë, përgjegjëse për programin që vlerësohet, i përmbush të gjithadetyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. Ndërsa stafi akademik që angazhohet në realizimin e programit të studimit Master Shkencor në "Menaxhim Marketing" ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit në përputhje me kërkesat bashkëkohore të të sigurimit të cilësisë të moduleve mësimore.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

				X
--	--	--	--	---

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Siç rezulton nga dokumentat themelore rregullatore të hartuara nga institucioni dhe njësia bazë, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit janë ndërtuar në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi (VKM Nr.564, datë 28.5.2009 për hapjen e programeve të reja të studimit master i nivelit të dytë). Njësia bazë, Departamenti i Marketingut, përgjegjës për programin Master Shkencor në “Menaxhim Marketing”, disponon informacionet e nevojshme, si ato që transmetohen nga strukturat eprore institucionale ashtu edhe ato që hartohen brenda departamentit, në përputhje me organigramën dhe organizimin hierarkik të prodhimit dhe qarkullimit të informacionit.</p> <p>Legjislacioni udhëheqës (Ligje dhe Vendime të Këshillit të Ministrave) për veprimtarinë e Institucioneve të Arsimit të Lartë, analizohet në Rektorat dhe mbi këtë bazë, hartohen dokumentat kryesore rregullatore në nivel fakulteti dhe më tej, departamenti. Ky dokumentacion përfshin vendime të brendshme, udhëzime, rregullore si edhe statuti, të cilat vijnë të protokolluara dhe sipas afateve nga rektorati, përcillen në dekanat, i cili realizon detyrat e tij, duke miratuar rregulloret përkatëse dhe përcjellë informacionin mbi vendimet dhe vlerësimet në të dy drejtimet.</p> <p>Rregullorja e brendshme e departamentit (Rregullore e Departamentit të Marketingut) miratuar me vendimin nr.9 datë 11.06.2019 të Departamentit të Marketingut, rregullorja e Fakultetit, miratuar me Vendim të Senatit Akademik nr.852/8prot. datë 09.11.2019, si dhe rregullorja e programit të studimit, miratuar me vendim departamenti 85/1 prot. datë 10.02.2022 përcaktojnë gjithashtu marrëdhëniet e departamentit me studentët.</p> <p>GVJ konstaton se njësia bazë i kushton vëmendje përgatitjes së dokumentacionit rregullator dhe udhëhiqet në veprimtarinë e saj institucionale nga legjislacioni.</p> <p><i>Referenca: An. 2 Statuti i UAMD.pdf;</i> <i>Referenca: An. 4Rregullore e UAMD.pdf;</i></p>

	<p><i>Referenca: An. _12_Rregullore e programit Master shkencor MM.pdf;</i></p> <p><i>Referenca: An. _19_Rregulloret e Fakultetit të Biznesit.pdf;</i></p> <p><i>Referenca: An. _54_Rregullore e Departamentit Marketing.pdf</i></p> <p><i>Referenca:RVB MSC. Menaxhim Marketing.pdf; Vizita në institucion;</i></p> <p><i>Referenca: Ligji 80/2015</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>GVJ konstaton se programi Master Shkencor në “Menaxhim Marketing” është i mbështetur në Strategjinë e Zhvillimit Institucional të UAMD 2020-2025, si edhe në Planin mësimor. Në këto dokumenta përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/ jashtë auditorit, duke konsideruar që studentit i nevoiten 120 ECTS për të fituar Diplomën Master Shkencor në “Menaxhim Marketing”. Në këtë plan, ngarkesa e vitit akademik (60 ECTS) është llogaritur 1.500 orë, (60 ECTS *25 orë për 1 ECTS) nga të cilat jo më pak se 50% përfaqësojnë punë të pavarur.</p> <p>Gjithashtu, Njësia Bazë ka përcaktuar të gjitha rregullat që kanë të bëjnë me frekuentimin, ndjekjen e programit si edhe mënyrën e vlerësimit të dijeve. Këto element përveç se të përcaktuara në Rregulloren e Fakultetit, Rregulloren e programit janë gjithashtu të përcaktuara në syllabusin e secilës lëndë.</p> <p>Vlerësimi i dijeve të studentit ndahet në vlerësim të vazhduar dhe vlerësim përfundimtar. Vlerësimi i vazhduar konsiston në 50% të totalit të pikëve dhe konsiston në dy elementë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Testi i ndërmjetëm ▪ Detyra e kursit <p>Sipas nenit 66, pika 2 “Frekuentimi i orëve mësimore”, të Rregullores së IAL frekuentimi në këtë program studimi është i detyrueshëm në masën 75%, dhe përcaktohet se nëse studenti arrin mbi 25% të mungesave skualifikohet dhe nuk mund të futet në provimin përfundimtar. Ky përcaktim në rregulloren e IAL është në përputhje me pikën 3.a. të udhëzimit nr.6479 prot. Datë 07.10.2022. GVJ konstaton se në syllabuset e lëndëve të këtij programi studimi përcaktohet se “studenti që mungon në 25% të orëve të kursit vlerësohet automatikisht me notën 4 dhe duhet të ndjekë përsëri kursin vitin e ardhshëm” duke qenë në kontraditë me pikën 2 të nenit 66 të rregullores së IAL si dhe me udhëzimin ligjor.</p>

	<p><i>Referenca: An. 1 Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025.pdf</i></p> <p><i>Referenca: An. 2 Statuti i UAMD.pdf;</i></p> <p><i>Referenca: An. 4 Rregullore e UAMD.pdf;</i></p> <p><i>Referenca: An. 12 Rregullore e programit Master shkencor MM.pdf;</i></p> <p><i>Referenca: An. 19 Rregulloret e Fakultetit të Biznesit.pdf;</i></p> <p><i>Referenca: An. 54 Rregullore e Departamentit Marketing.pdf</i></p> <p><i>Referenca: An. 50 Syllabuset e lendeve të MSH për vitin 2022 - 2023.pdf</i></p> <p><i>Referenca: RVB MSC. Menaxhim Marketing.pdf; Vizita në institucion;</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Institucioni ka përpunuar informacione të detajuara, të cilat ju përcillen studentëve nëpërmjet disa dokumentave thelbësore, siç janë: Rregullorja e Programit Master Shkencor në “Menaxhim Marketing”, Rregullorja e Departamentit, Rregullorja e Fakultetit si edhe Statuti i UAMD.</p> <p>Këto dokumenta përcaktojnë të gjithë elementët dhe mekanizmat e duhur për të rregulluar marrëdhëniet e studentëve me institucionin, në funksion të realizimit të qëllimit të tyre si: regjistrimi, ndjekja, përfundimi i studimeve dhe diplomimi në programin e studimit, Master Shkencor në “Menaxhim Marketing”.</p> <p>Kriteret për pranimin e studentëve në programin e studimit janë në përputhje me nenin 74 të ligjit 80/2015 të arsimit të lartë, me udhëzimet e përvitshme të MASR, në kriteret e parashikuara në Rregulloren e programit të studimit sipas nenit 27. Këto çështje specifikohe gjithashtu edhe tek Statuti i UAMD, neni 74 (Transferimi i studimeve, njohja dhe njehsimi i diplomave). Procesi i pranimit të studentëve bëhet mbi bazë të një transparence të plotë, ku kriteret e pranimit, afatet, lista e kandidatëve fitues etj. shpallen në mjedise publike dhe kandidati për student ka të drejtën e ankimimit në strukturat përkatëse në rast nevojë.</p> <p><i>Referenca: An. 2 Statuti i UAMD.pdf;</i></p> <p><i>Referenca: An. 4 Rregullore e UAMD.pdf;</i></p> <p><i>Referenca: An. 12 Rregullore e programit Master shkencor MM.pdf;</i></p> <p><i>Referenca: An. 19 Rregulloret e Fakultetit të Biznesit.pdf;</i></p> <p><i>Referenca: An. 54 Rregullore e Departamentit Marketing.pdf</i></p>

	<p><i>Referenca:RVB MSC. Menaxhim Marketing.pdf; Vizita në institucion;</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Analiza e Syllabuseve të detajuara të lëndëve dëshmon se informacioni mbi përmbajtjen dhe formën e organizimit të mësimdhënies, për secilën lëndë të programit, është i detajuar, i plotë dhe i lehtë për t'u përdorur. Syllabusi përmban: Përmbledhjen dhe rezultatet e të nxënit, konceptet themelore, tematikën e secilës orë mësimi, formën e kontrollit të dijeve dhe literaturën. Formatit i syllabuseve përputhet me standardet e përcaktuara në VKM 41, datë 24.01.2018.</p> <p>Syllabusi, i përgatitur nga pedagogu i lëndës, depozitohet i firmosur, tek Njësia Bazë, përpara fillimit të semestrit. Pedagogu i lëndës është përgjegjës për prezantimin e syllabusit si edhe sqarimin e modaliteteve të ndjekjes së lëndës, në orën e parë të mësimi.</p> <p>GVJ konstaton se programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme në lidhje me kërkesat e kriterit 4.</p> <p><i>Referenca: An. _50_Syllabuset e lendeve te MSH per vitin 2022 - 2023.pdf</i></p> <p><i>Referenca:RVB MSC. Menaxhim Marketing.pdf; Vizita në institucion;</i></p>
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p>Me qëllim plotësimin më të mirë të nevojave të tregut, departamenti si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit duke i bërë përpjekjet për përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm të programit të studimit pjesë të planit vjetor të punës së departamentit. Shefi i departamentit i kërkon anëtarëve të departamentit propozime lidhur me përditësimet për literaturën e lëndëve dhe moduleve të programit të studimit si dhe për metodat e mësimdhënies. Gjithashtu bazuar në rregulloren e institucionit si dhe sipas vizitës në institucion Sektorit i Zhvillimit të Kurrikulave dhe Cilësisë ka detyra thelbësore për të mbështetur procesin e përmirësimit dhe përditësimit të vazhdueshëm të programit të studimit.</p> <p><i>Referenca: An._26_ Analiza Vjetore e Departamentit të Marketingut, 2021-2022.pdf;</i></p> <p><i>Referenca: An. _54_ Rregullore e Departamentit Marketing.pdf;</i></p> <p><i>Referenca: An. _50_Syllabuset e lendeve te MSH per vitin 2022 -</i></p>

	2023.pdf; Referenca:RVB MSC. Menaxhim Marketing.pdf; Vizita në institucion;			
Konkluzione	GVJ konkludon se struktura e programit i përfaqësohet nga programeve të ngjashme ndërkombëtare. GVJ mbështet përfundimin se programi i studimit jo vetëm mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve, por edhe punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut të punës. GVJ rekomandon rishikimin e përcaktimit të të frekuentimit në syllabuset e programit të studimit në mënyrë që të përputhet me pikën 2 të nenit 66 të rregullores së IAL si dhe me udhëzimin ligjor nr.6479 prot. Datë 07.10.2022. Kjo pasi GVJ ka konstatuar mospërputhje sipas përshkrimit në kriterin 2 të këtij standardi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënësve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	<p>Programi që po vlerësohet, Master Shkencor në “Menaxhim Marketing” është ndërtuar sipas 5 drejtimeve themelore, përkatësisht Lëndë Bazë, Karakterizuese, Ndërdisciplinore dhe me zgjedhje, Plotësuese dhe Detyrime Përmbyllëse, në përmbajtjen e të cilave janë klasifikuar lëndët në aktivitete formuese dhe aktivitete praktike, në funksion të programit të studimit si edhe për të rritur mundësitë e punësimin të studentëve, nëpërmjet rritjes së nivelit profesional të tyre.</p> <p>Të gjitha veprimtaritë akademike si mësimi në auditor (leksione, seminare, ushtrime si dhe kontrolli i vazhdueshëm) janë në funksion të arritjes të objektivave të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Metodat e mësimdhënies mbështetin të mësuarit interaktiv si edhe nxitjen e mendimit të tyre krijues.</p> <p>Bashkëpunimi me organizatat e biznesit nëpërmjet të ftuarve dhe/ose vizitave mbështet tranzicionin e studentëve nga shkolla në tregun e punës. Zhvillimi i praktikës profesionale ndikon në rritjen e efektivitetit të tyre.</p>

	<p><i>Referenca: An. _12_Rregullore e programit Master shkencor MM.pdf;</i></p> <p><i>Referenca: An. _20_Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Referenca: An. _44_Kurrikul dhe plani mesimor Master shkencor MM riorganizim1.pdf;</i></p> <p><i>Referenca: An. _50_Syllabuset e lendeve te MSH per vitin 2022 - 2023.pdf</i></p> <p><i>Referenca:RVB MSC. Menaxhim Marketing.pdf; Vizita në institucion;</i></p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Siç konstatohet nga Plani mësimor si edhe nga diskutimet në institucion, lëndët e shpërndara ndërmjet dy semestrave janë organizuar në formë të tillë që studenti të ketë një ngarkesë të shpërndarë gjatë gjithë ciklit të studimit. Kjo shpërndarje mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor</p> <p>Planet mësimore si edhe dokumentat plotësuese për vitin akademik 2022-2023 sigurojnë informacion të mjaftueshëm dhe të detajuar mbi ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, duke konsideruar që studentit i nevoiten 120ECTS për të fituar Diplomën Master Shkencor në “Menaxhim Marketing”.</p> <p><i>Referenca: An. _12_Rregullore e programit Master shkencor MM.pdf;</i></p> <p><i>Referenca: An. _20_Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të Fakultetit të Biznesit.pdf</i></p> <p><i>Referenca: An. _44_Kurrikul dhe plani mesimor Master shkencor MM riorganizim1.pdf;</i></p> <p><i>Referenca: An. _50_Syllabuset e lendeve te MSH per vitin 2022 - 2023.pdf</i></p> <p><i>Referenca:RVB MSC. Menaxhim Marketing.pdf; Vizita në institucion;</i></p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të</p>	<p>Informacioni i siguruar nga shqyrtimi i rregullores së departamentit dhe të programit të studimit konfirmon se ky program studimi ju siguron studentëve diplomë Master Shkencor në “Menaxhim Marketing” , në sajë të së cilës ata mund të ushtrojnë profesionin si specialistë dhe menaxherë marketingu për kompani e organizata të ndryshme publike dhe private në çështje që</p>

<p>ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>lidhen me zhvillimin e fushatave marketing, përzgjedhjen dhe menaxhimin e alternativave të marketimit, realizimin e kërkimeve sasiore dhe cilësore duke vlerësuar sistuatat për vendimarrje etj.</p> <p>Programi i studimit është ndërtuar plotësisht në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij si edhe profilin përkatës. Plani mësimor përveç argumentave të mbështetura në analizën e kriterëve të standardit II.1, II.2 dhe II.3, shërben gjithashtu për të verifikuar mënyrën e organizimit të lëndëve të përgjithshme ndaj lëndëve specifike të profesionit. Ndonëse raporti teori/praktikë në kuadrin e çdo lënde është në përputhje të plotë me profilin e programit, në kuadrin e përgjithshëm të studimeve, vlerësimi i praktikës në kohë dhe nëpërmjet krediteve, thekson natyrën praktike dhe efektive të njohurive të siguruara, duke rritur vlefshmërinë e diplomës së përfutur.</p> <p>Ky program i siguron studentëve aftësi të thelluara profesionale në fushën e menaxhimit të marketingut, të trajtojnë me profesionalizëm çështje tëkonceptimit dhe zhvillimit tëfushatave marketing dhe të drejtimit me efektivitet tëtyre. GVJ konkludon se struktura e programit i përfaqëson programeve të ngjashme ndërkombëtare.</p> <p><i>Referenca: An. _12_Rregullore e programit Master shkencor MM.pdf;</i> <i>Referenca: An. _44_Kurrikul dhe plani mesimor Master shkencor MM riorganizim1.pdf;</i> <i>Referenca: An. _50_Syllabuset e lendeve te MSH per vitin 2022 - 2023.pdf</i> <i>Referenca: An. _54_Rregullore e Departamentit Marketing.pdf</i> <i>Referenca:RVB MSC. Menaxhim Marketing.pdf; Vizita në institucion;</i></p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Objektivat formuese të programit, të specifikuar tek Rregullorja e Programit dhe Rregullorja e Departamentit, janë plotësisht të mbështetura nga struktura dhe organizimi i planit mësimor.Objektivat formuese të secilës lëndë janë të formuluar në mënyrë të qartë tek syllabuset përkatëse. GVJ gjykon që arritja e objektivave formuese në çdo lëndë është e mbështetur nga struktura e lëndës, në veçanti nga ndarja ndërmjet veprimtarive formuese si sipas lëndëve ashtu edhe sipas programit të përgjithshëm të studimeve akademike në Menaxhim Marketing</p>

	<p>cikli i dytë. Strukturimi i programit të studimit mundëson gjithashtu edhe lehtësimin e transferimeve dhe lëvizshmërinë e studentëve mes IAL-ve brenda dhe jashtë vendit.</p> <p><i>Referenca: An. _12_Rregullore e programit Master shkencor MM.pdf;</i> <i>Referenca: An. _44_Kurrikul dhe plani mesimor Master shkencor MM riorganizim1.pdf;</i> <i>Referenca: An. _50_Syllabuset e lendeve te MSH per vitin 2022 - 2023.pdf</i> <i>Referenca: An. _54_Rregullore e Departamentit Marketing.pdf</i> <i>Referenca:RVB MSC. Menaxhim Marketing.pdf; Vizita në institucion;</i></p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Përmirësimi i përmbajtjes së lëndëve dhe moduleve është objekt i diskutimit në departament, bazuar në diskutimet me personelin e departamentit. Këtij qëllimi i shërben eksperiencë e fituar nga pjesëmarrja në programe kualifikimi jashtë vendit e disa pedagogëve si edhe këmbimi i eksperiencës me disa universitete të cilat aplikojnë programe të ngjashme.</p> <p>Programet e lëndëve përditësohen çdo vit akademik. Përditësimi përfshin literature bashkëkohore si në tituj edhe në vit botimi si edhe metoda më efektive e të përparuara të mësimdhënies. Literatura e çdo lënde, si literature e detyrueshme, ashtu edhe ajo alternative, janë pjesë e syllabusit të lëndës.</p> <p><i>GVJ konstaton se nuk ka një studim tregu të aktualizuar i cili do të shërbente nevojave të programit të studimit për përditësimin e syllabuseve. GVJ sugjeron ndërmarrjen e një studimi tregu aktual në funksion të përmirësimit të programit të studimit.</i></p> <p><i>Referenca: An. _26_Analiza Vjetore e Departamentit të Marketingut, 2021-2022.pdf</i> <i>Referenca: An. _50_Syllabuset e lendeve te MSH per vitin 2022 - 2023.pdf</i> <i>Referenca: An. _54_Rregullore e Departamentit Marketing.pdf</i> <i>Referenca: An. _117_Studimi i qartë.pdf</i> <u>61. E-mail per perditesimin e syllabus dhe relacionin per ndryshimin e tyre.pdf</u> <i>Referenca:RVB MSC. Menaxhim Marketing.pdf; Vizita në</i></p>

<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p><i>institucion;</i></p> <p>Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara, përmes dhënies së njohurive të thelluara profesionale në fushën e menaxhimit të marketingut dhe vënies së tyre në praktikë në organizata të ndryshme private apo publike si dhe ato jo fitimprurëse.</p> <p>Njësia bazë konsideron nevojë parësore analizën e vazhdueshme të programit të studimit nëpërmjet analizës vjetore të departamentit, të cilën e ka realizuar dhe e ka përdorur për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies si edhe rritur efektivitetin e studimeve akademike, të konfirmuar nga pozicionimi në treg të studentëve dhe karriera e tyre.</p> <p><i>Njëlloj sikurse është përmendur edhe në kriterin e mësipërm GVJ konstaton se nuk ka një studim tregu të aktualizuar i cili do të shërbente nevojave të programit të studimit për përditësimin e syllabuseve. GVJ sugjeron ndërmarrjen e një studimi tregu aktual në funksion të përmirësimit të programit të studimit. Ky studim do të ndihmonte IAL për të evidentuar aftësitë që i nevojiten studentit që studion në këtë program studimi Gjithashtu, do të ndihmonte IAL për një rishpërndarje të lëndëve në kurrikul edhe në përputhje me shpjegimin e kategorive të veprimtarive formuese, kryesisht në kategorinë A - Lëndë bazë të detyrueshme, kategorinë B- Lëndë karakterizuese dhe kategorinë C - Lëndë ndërdisiplinore. Në kategorinë C të veprimtarisë formuese lëndët duhet të pasqyrojnë profilizimin në menaxhim marketingu dhe jo në fusha të tjera.</i></p> <p><i>Referenca: An. _26_Analiza Vjetore e Departamentit të Marketingut, 2021-2022.pdf</i></p> <p><i>Referenca: An. 41.1Punesimet dhe gjurmimi i tyre Master Shkencor Menaxhim Marketing.pdf;</i></p> <p><i>Referenca: An. _50_Syllabuset e lendeve te MSH per vitin 2022 - 2023.pdf</i></p> <p><i>Referenca: An. _54_Rregullore e Departamentit Marketing.pdf</i></p> <p><i>Referenca: An. _117_Studimi i qartë.pdf</i></p> <p><i>Referenca:RVB MSC. Menaxhim Marketing.pdf; Vizita në institucion;</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e</p>	<p>Nisur nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Objektivat formuese të programit; ▪ Harmonizimi i lëndëve bazë dhe karakterizuese me ato me

<p>mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>zgjedhje dhe plotësuese;</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Ndërthurja e njohurive teorike dhe praktike; ▪ Përmirësimi i vazhdueshëm i përmbajtjes së lëndëve dhe literaturës; ▪ Përmirësimi i metodave të mësimdhënies; ▪ Kriteret e pranimit dhe transferimit <p>GVJ mbështet përfundimin se program i studimit jo vetëm mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve, por edhe punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut të punës.</p> <p>Nëpërmjet dokumentit Rregullore e praktikës profesionale, IAL ka specifikuar mënyrën e zhvillimit të praktikës pranë sipërmarrjes si dhe rolin e të gjithë aktorëve të përfshirë në këtë proces formues që shërben si një urë lidhëse për studentin për të integruar teorinë e mësuar në auditor me praktikën konkrete që shfaq tregu i punës. Sektori i komunikimit, alumnit dhe karrierës, koordinatori i programit të studimit dhe përgjegjësi i departamentit realizojnë takime me studentët e diplomuar në IAL UAMD, për tu mbështetur në eksperiencën e tyre si një burim i rëndësishëm informacioni që mundëson përshtatjen me kërkesat e tregut të punës.</p> <p>Njësia bazë i kushton vëmendje të veçantë përmirësimin të përmbajtjes së programeve të studimit, gjë e cila konstatohet nga dokumentacioni udhëzues i përgatitur nga institucioni, mbi kriteret dhe formatin e syllabuseve, si edhe materialet didaktike të nevojshme që duhet të përfshihen në mënyrë të detyrueshme në syllabus.</p> <p><i>GVJ konstaton se mungon një dokumentim i përditësuar i studimit të tregut të punës.</i></p> <p><i>Referenca: An. _26_Analiza Vjetore e Departamentit të Marketingut, 2021-2022.pdf</i></p> <p><i>Referenca: An. 41.1Punesimet dhe gjurmimi i tyre Master Shkencor Menaxhim Marketing.pdf;</i></p> <p><i>Referenca: An. _50_Syllabuset e lendeve te MSH per vitin 2022 - 2023.pdf</i></p> <p><i>Referenca: An. _54_ Rregullore e Departamentit Marketing.pdf</i></p> <p><i>Referenca: An. _117_ Studimi i qartë.pdf</i></p> <p><i>Referenca:RVB MSC. Menaxhim Marketing.pdf; Vizita në</i></p>
---	---

	<i>institucion;</i>			
Konkluzione	<p><i>GVJ konkludon se struktura e programit i përafrohet programeve të ngjashme ndërkombëtare. GVJ mbështet përfundimin se program i studimit jo vetëm mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve, por edhe punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut të punës.</i></p> <p><i>GVJ konstaton se nuk ka një studim tregu të aktualizuar i cili do ti shërbente jashtëzakonisht shumë nevojave të programit të studimit për përshtatje me tregun si dhe përditësimittë syllabuseve. GVJ sugjeron ndërmarrjen e një studimi tregu aktual në funksion të përmirësimit të programit të studimit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përpunje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Departamenti i Marketingut si njësi bazë e programit të studimit implementon disa instrumenta për të garantuar përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës. Lidhur e me aktorët e brendshëm departamenti në bashkëpunim me Njësinë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë dhe Drejtoria e Kurrikulës dhe Standarteve të Cilësisërealizojnë pyetësorin me studentët në fund të vitit akademik për të evidentuar përmirësimet potenciales të evidentuara nga zëri i studentëve. Këndvështrimet e aktorëve të tjerë si institucionet partnere, konkurenca dhe ecuria e dinamikës së tregut janë pjesë e analizës së tregut që bën institucioni si dhe pjesë e analizës që i paraprin formulimit nga ana e institucionit të strategjisë për zhvillimin e programit të studimit. Zyra e komunikimit, karrierës dhe alumni, gjithashtu Qendra e karrierës dhe alumni, si dhe integrimi i eksperiencave Erasmus të stafit dhe studentëve janë dy instrumenta të tjerë që i shërbejnë procesit të përmirësimit dhe përshtatjes së programit të studimit.</p> <p><i>Referenca: An. 13 Rregulloret e Sektorit të Komunikimit,</i></p>

	<p><i>Alumnit _Karrierës.pdf;</i> Referenca: An. <u>16</u> <i>UAMD Udhezues nga Qendra e Karrieres dhe Alumni.pdf;</i> Referenca: An. <u>22</u> <i>Raporti 2020 - 2021 mbi marreveshjet e bashkëpunimit dhe nderkombetarizimi.pdf;</i> Referenca: An. <u>26</u> <i>Analiza Vjetore e Departamentit të Marketingut, 2021-2022.pdf;</i> Referenca: An. <u>28</u> <i>Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Cilësisë UAMD.pdf;</i> Referenca: An. <u>29</u> <i>Model pyetsori për studimin e stafit akademik.pdf;</i> Referenca: An. <u>30</u> <i>Formulare vetvleresimi i performancave Model.pdf;</i> Referenca: An. <u>33</u> <i>Tabela e vleresimit te stafit akademik nga rektorati.pdf;</i> Referenca: An. <u>34</u> <i>Urdher i Rektorit per ngritjen e NJSBC.pdf;</i> Referenca: An. <u>35</u> <i>Kerkese nga studente per futjen e lendeve te reja ne kurrikulen e MSC.pdf;</i> Referenca: An. <u>39</u> <i>Raporti i Vetevleresimit2019-2020 NJSBC.pdf;</i> Referenca: An. <u>40</u> <i>Analiza e rezultateve të anketimit për studentët, stafin akademik dhe administrativ).pdf;</i> Referenca: An. <u>41.2</u> <i>Pyetesor per Studentet Master Qershor 2023.pdf;</i> Referenca: An. <u>42</u> <i>Sugjerim nga një biznes për riorganizimin e programit Master shkencor Menaxhim Marketing.pdf;</i> Referenca: An. <u>43</u> <i>Takim informon në NJSBC me koordinatorete dhe GVB -te.pdf;</i> Referenca: <i>RVB MSC. Menaxhim Marketing.pdf; Vizita në institucion;</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Sektori i komunikimit, alumnit dhe karrierës, koordinatori i programit të studimit dhe përgjegjësi i departamentit realizojnë takime me studentët e diplomuar në IAL UAMD, për tu mbështetur në eksperiencën e tyre si një burim i rëndësishëm informacioni që mundëson përshtatjen me kërkesat e tregut të punës. Pyetësori me studentët në fund të vitit akademik nëpërmjet bashkëpunimit të departamentit me Drejtorinë e Kurrikulës dhe Standarteve të Cilësisë përfaqëson një tjetër formë të përfshirjes së studentëve.</p>

	<p><i>Referenca: An. _13_Rregulloret e Sektorit të Komunikimit, Alumnit _Karrierës.pdf;</i></p> <p><i>Referenca: An. _16_UAMD Udhezues nga Qendra e Karrieres dhe Alumni.pdf;</i></p> <p><i>Referenca: An. _26_Analiza Vjetore e Departamentit të Marketingut, 2021-2022.pdf;</i></p> <p><i>Referenca: An. _35_Kerkese nga studente per futjen e lendeve te reja ne kurrikulen e MSC.pdf;</i></p> <p><i>Referenca: An. _40_Analiza e rezultateve të anketimit për studentët, stafin akademik dhe administrativ).pdf;</i></p> <p><i>Referenca: An. _41.2_Pyetesor per Studentet Master Qershor 2023.pdf;</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Bashkëpunimi me studentët Alumni si dhe marrëdhënie e qëndrueshme me institucionet partnere nga tregu i punës me të cilat UAMD ka marrëveshje krijojnë mundësinë që Departamenti i Marketingut si njësia bazë përgjegjëse për përmirësimin, përditësimin, dhe përshtatjen e programit të studimit të marrë feedbackun e duhur për të ndërmarrë strategjitë dhe hapat e duhur drejt procesit të përditësimit me ndryshimet e kërkuara.</p> <p><i>Referenca: An. _13_Rregulloret e Sektorit të Komunikimit, Alumnit _Karrierës.pdf;</i></p> <p><i>Referenca: An. _16_UAMD Udhezues nga Qendra e Karrieres dhe Alumni.pdf;</i></p> <p><i>Referenca: An. _20_Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të Fakultetit të Biznesit.pdf;</i></p> <p><i>Referenca: An. 21 Marreveshje Bashkepunimi UAMD 2021 - 2022.pdf;</i></p> <p><i>Referenca: An. 22Raporti 2020 - 2021 mbi marreveshjet e bashkepunimit dhe nderkombetarizimi.pdf;</i></p> <p><i>Referenca: An. _23_Marreveshjet e bashkepunimit te Departamentit Marketing.pdf;</i></p> <p><i>Referenca: An. _26_Analiza Vjetore e Departamentit të Marketingut, 2021-2022.pdf;</i></p> <p><i>Referenca: An. 42Sugjerim nga një biznes për riorganizimin e programit Master shkencor Menaxhim Marketing.pdf;</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstatoi se Njësia përgjegjëse për programin e studimit Master Shkencor në “Menaxhim Marketing” nxit përfshirjen e studentëve, partnerëve, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të</i></p>

	<i>programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6

Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>Programi i studimit Master Shkencor në “Menaxhim Marketing” përcakton objektivat e studimit në përputhje me objektivat e Institucionit.</p> <p>Në kuadër të vizionit të tij <i>Universiteti “Aleksandër Moisiu”, synon të karakterizohet gjithnjë e më shumë si një qendër akademike cilësore dhe inovatore, si një realitet i ri dhe dinamik duke ofruar një alternativë serioze në panoramën e Arsimit të Lartë.</i></p> <p>Rregullorja e Programit të Studimit Master Shkencor në “Menaxhim Marketing” në nenin 2 të saj “Misioni dhe objektivat e programit të studimit Master Shkencor në Menaxhim Marketing” thekson se nëpërmjet programit të studimit Master Shkencor në Menaxhim Marketing synohet përgatitja e specialistëve për fushën e Marketingut si dhe përgatitja e kualifikimit shkencor për studime doktorate të mëtejshme. Në funksion të përmbushjes së këtij misioni synohet të arrihen objektivat si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të aftësohen studentët në përzgjedhjen e teknikave të duhura për menaxhimin e mediave. • Të zhvillojnë aftësinë e zhvillimit të fushatave marketing. • Të mësojnë si të ekzaminojnë sistematikisht tema të ndryshme mbështetur në baza të fortateorike. • Të përgatiten profesionistë në fushën e drejtimit marketing, në përzgjedhjen e alternativave të marketingut dhe të mënyrave më të mira për menaxhimin e tyre. • Të zhvillojnë aftësinë për të ndërtuar dhe vlerësuar raporte ekonomike dhe marketing. • Të njihen dhe të aftësohen në njohjen e sistemit marketing në nivel ndërkombëtar.

	<ul style="list-style-type: none"> • Të përgatisë profesionistë në fushën e kërkimit sasiore dhe cilësor dhe njohjen e modeleve përvlerësimin e tyre. <p><i>GVJ konstaton se institucioni nuk ka hartuar një Plan Strategjik për zhvillimin e programit të studimit i cili do të reflektonte më qartësisht përputhjen mes prioriteteve dhe objektivave të përshkruara në planin strategjik të institucionit dhe prioriteteve dhe objektivave të studimit dhe kërkimit shkencor të programit të studimit.</i></p> <p><i>Referenca: An. 1Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025.pdf;</i> <i>Referenca: An. 12Rregullore e programit Master shkencor MM.pdf;</i> <i>Referenca:RVB MSC. Menaxhim Marketing.pdf; Vizita në institucion;</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Liria akademike në UAMD garantohet nëpërmjet së drejtës (referuar statutit të IAL UAMD, neni 5 pika 2):</p> <ul style="list-style-type: none"> • Për të organizuar veprimtarinë e mësimdhënies, të kërkimit shkencor si dhe veprimtaritë krijuese; • Për të hartuar dhe zhvilluar programet e studimit dhe për të përcaktuar fushat e kërkimit shkencor; • Për të organizuar procesin e promovimit të personelit akademik; <p>Departamenti është njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe punës kërkimore shkencore. Departamenti nxit, programon, bashkërendon, zhvillon, organizon dhe administron veprimtarinë e mësimdhënies dhe punës kërkimore shkencore si dhe garanton integrimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore me atë të mësimdhënies.</p> <p>Në takimin e realizuar me pedagogët e këtij programi studimi u pohua se departamenti mbështet, nxit dhe respekton pedagogët në organizimin e veprimtarive të mësimdhënies, në punën e tyre kërkimore-shkencore, në pjesëmarrjen në studime dhe projekte të ndryshme në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë vendas dhe të huaj.</p> <p><i>Referenca: An. 1Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025.pdf;</i></p>

	<p><i>Referenca: An. _2_Statuti i UAMD.pdf;</i> <i>Referenca:RVB MSC. Menaxhim Marketing.pdf; Vizita në institucion;</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Departamenti i Marketingut angazhon, nxit dhe motivon studentët të bëhen pjesë e studimeve dhe projekteve kërkimore në nivel njësie apo fakulteti. Nëpërmjet moduleve të ofruara nga programi i studimit nuk synohet vetëm formimi i studentëve në kuadrin e konceptimeve teorike por në plotësim të kësaj për të zhvilluar dhe aftësi praktike të tyre duke aplikuar konceptet teorike. Departamenti i ka angazhuar nëpërmjet stafit akademik studentët në projekte të ndryshme kërkimore.</p> <p>Konkretisht, studentët e masterit shkecor marrin pjesë në konferencën shkencore të organizuar nga Departamenti i i Marketingut International Scientific Conference on Innovative Marketing (ISCOIM) dhe inkurajimi i pjesëmarrjes së tyre në këtë konferencë reflektohet në cmimin e akorduar për punimin e ri më të mirë. Gjithashtu pjesëmarrja e studentëve inkurajohet për përfshirje në konferencën e përvitshme studentore si dhe në konkurse për punimet shkencore më të mira. Lidhur me angazhimin në projekte, 2 prej studentëve të programit Master Shkencor në Menaxhim Marketing janë aktivizuar në projektin nëFshat të financuar nga GIZ në kuadër të programit Sustainable Rural Development.</p> <p><i>Referenca: An. 64Pjesemarrja e studenteve ne projektin Ne fshat.pdf;</i> <i>Referenca: An. _100_Libri i Abstrakteve - ISCOIM 2022pdf.pdf;</i> <i>Referenca:RVB MSC. Menaxhim Marketing.pdf; Vizita në institucion;</i></p>
<p>Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>GVJ konstaton se IAL UAMD mbështet aktivitetin kërkimor dhe shkencor të stafit akademik, konkretisht referuar nenit 5 të Rregullores për menaxhimin e aktiviteteve kërkimore shkencore specifikohet rimbursimi i botimeve me Scopus. Kërkesat e anëtarëve të departamentit të Marketingut paraqesin kërkesën për buxhet për aktivitetet kërkimore shkencore çdo fillim viti akademik, kërkesa të cilat miratohen me vendim të Bordit të Administrimit. Këto fonde i shërbejnë aktiviteteve kërkimore shkencore të organizuara nga departamenti.</p> <p><i>Referenca: An. _3_Plan Strategjik i Departamentit Marketing 2021 - 2025 .pdf;</i></p>

	<p>Referenca: An. <u>26_Analiza Vjetore e Departamentit të Marketingut, 2021-2022.pdf</u>;</p> <p>Referenca: An. <u>65_Rregullore për menaxhimin e aktiviteteve kerkimore - shkencore.pdf</u>;</p> <p>Referenca: An. <u>66_Projekti buxheti i konferences.pdf</u>;</p> <p>Referenca: An. <u>67_Thirrja nga UAMD per projektet kerkimore shkencore dhe te nderkombetarizimit.pdf</u>.</p>			
Konkluzione	<p>GVJ konstaton se programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.</p> <p>GVJ konstaton se institucioni nuk ka hartuar një Plan Strategjik për zhvillimin e programit të studimit i cili do të reflektonte më qartësisht përputhjen mes prioriteteve dhe objektivave të përshkruara në planin strategjik të institucionit dhe prioriteteve dhe objektivave të studimit dhe kërkimit shkencor të programit të studimit.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kerkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kerkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>Departamenti Marketing mbështet grupet lëndore dhe projektet kerkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kerkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor nëpërmjet aktiviteteve si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Këshillim dhe suport për studentët pjesëmarrës në projekte nëpërmjet organizimit dhe përpilimit të projekteve dhe ofrimin e burimeve • Sigurimin e bashkëpunimeve me strukturat kerkimore brenda dhe jashtë institucionit • Duke ndjekur vazhdimisht cilësinë e programit • Nëpërmjet planifikimit dhe zhvillimit të materialeve kerkimore <p>Referenca: An. <u>49.1_Lista e studenteve per udheheqjet e mikrotezave te MSH 2021 dhe e-mail informues.pdf</u>;</p> <p>Referenca: An. <u>49.2_E-mail kerkese nga studente te MSH per</u></p>

	<p><i>udheheqje diplome.pdf;</i> <i>Referenca:RVB MSC. Menaxhim Marketing.pdf; Vizita në institucion;</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>Referenca nr. 69 ilustron anagzhimin e IAL UAMD në projektin GRADUA financuar në kuadër të programit Erasmus + dhe koordinuar nga Universiteti Bujqësor i Tiranës me qëllim krijimin konkrete midis Universitetit dhe tregut të punës nëpërmjet ofrimit të një instrumenti të unifikuar në dispozicion të të dy përfituesve për vlerësimin e të diplomuarve, performancave të sistemit arsimor dhe sigurimin e mjeteve novatore të rekrutimit. Gjithashtu në rang fakulteti UAMD organizon çdo vit Konferencën studentore në cilë studentët e programit Master Shkencor në Menaxhim Marketing janë të inkurajuar të marrin pjesë si student të Fakultetit të Biznesit. Krahas kësaj Departamenti i Marketingut inkurajon edhe pjesëmarrjen e stafit akademik dhe të studentëve në konferencën ISCOIM të organizuar nga ky department në funksion të kërkesave për analiza e studime.</p> <p><i>Referenca: An. 69Projekti Gradua dhe agjenda e takimit.pdf</i> <i>Referenca: An. _100_Libri i Abstrakteve - ISCOIM 2022pdf.pdf;</i> <i>Referenca:RVB MSC. Menaxhim Marketing.pdf; Vizita në institucion;</i></p>
<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>Fakulteti i Biznesit pranë IAL UAMD si njësi kryesore e programit të studimit Master Shkencor në Menaxhim Marketing organizon në mënyrë të përvitshme Konferencën Shkencore Studentore. Ndërsa Departamenti I Marketingut si një nga njësitë e Fakultetit të Biznesit Dhe si njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit Master Shkencor në Menaxhim Marketing organizon konferencën shkencore ndërkombëtare International Scientific Conference on Innovative Marketing (ISCOIM).</p> <p><i>CLibri proceeding i konferencës studentore fq e para.pdf;</i> <i>Referenca: An. _100_Libri i Abstrakteve - ISCOIM 2022pdf.pdf;</i> <i>Referenca:RVB MSC. Menaxhim Marketing.pdf; Vizita në institucion;</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p>	<p>Programi i studimit Master Shkencor në Menaxhim Marketing përmban modulet të përshtatshme për të ndihmuar studentët në progresin e dijeve njerëzore, në krijimtarinë dhe praktikën profesionale, me qëllim që të krijojë impakt mbi shoqërinë dhe ekonominë nëpërmjet transferimit të dijes përtej komunitetit akademik, tek institucionet publike e private dhe grupet e interesit.</p>

	<p><i>Referenca: An. _44_Kurrikul dhe plani mesimor Master shkencor MM riorganizim1.pdf</i> <i>Referenca:RVB MSC. Menaxhim Marketing.pdf; Vizita në institucion;</i></p>			
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.</p>	<p>Këto kritere nuk aplikohen për këtë program studimi.</p>			
<p>Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).</p>				
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit Master Shkencor në “Menaxhim Marketing” garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Në programin e studimit Master Shkencor në “Menaxhim Marketing” format kryesore të mësimdhënies dhe mësimnxënies janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Leksionet (560 orë totale në auditor) ✓ Seminarët (330 orë totale në auditor) ✓ Projekte/Detyra Kursi ✓ Praktika profesionale ✓ Leksionet e hapura <p>Ndërsa tre të parat janë pjesë e vlerësimit të lëndës, dy të fundit shërbejnë për konsolidimin e njohurive teorike dhe nëpërmjet tyre, krijimin e shprehive praktike.</p> <p>Këto metoda kryesore të mësimin janë përcaktuar edhe në dokumentat: Rregullore e programit të studimit Master Shkencor në “Menaxhim Marketing” dhe Rregulloren e UAMD.</p> <p>Përmirësimi i metodave të mësimdhënies përbën prioritet për njësinë (departamentin), dhe është reflektuar jo vetëm në dokumentat zyrtarë si Analiza vjetore e departamentit, por edhe në takimet e GVJ me drejtuesin e departamentit dhe stafin akademik të programit të studimit.</p> <p>GVJ konstatoi një përpjekje serioze nga ana e stafit në dobi të rritjes së nivelit të mësimdhënies. Gjithashtu, pedagogët janë angazhuar për një përfshirje aktive të studentëve gjatë orës së mësimin, në diskutimin e rasteve studimore dhe detyrave në grup e individuale. Kjo e fundit u pohua dhe gjatë takimit që GVJ zhvilloi me studentët, të cilët vlerësonin interaktivitetin në klasë, diskutimet gjatë orës së mësimin të rasteve praktike dhe marrëdhënien e gatishmërinë e pedagogëve për t’iu përgjigjur çdo pyetje e paqartësie të studentit.</p> <p><i>Referenca: An. _4_Rregullore e UAMD.pdf;</i> <i>Referenca: An. _12_Rregullore e programit Master shkencor MM.pdf;</i> <i>Referenca: An. _26_Analiza Vjetore e Departamentit të</i></p>

	<p><i>Marketingut, 2021-2022.pdf;</i> <i>Referenca: An. _44_Kurrikul dhe plani mesimor Master shkencor MM riorganizim1.pdf;</i> <i>Referenca:RVB MSC. Menaxhim Marketing.pdf; Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Në përputhje me rregulloren mësimore, format e mësimdhënies dhe mësimnxënies dhe kontrollit të dijeve parashikohen në planet mësimore, dhe syllabuset e lëndëve. Programi i studimit Master Shkencor në “Menaxhim Marketing” përfshin format e mësimimit teorik e praktik si leksionet, seminarët, projektet e kërkimit, detyrat e kursit, prezantime, etj. Mënyra e vlerësimit të dijeve është e vazhdueshme duke përfshirë aktivizimin gjatë orëve mësimore, provimet ndërmjetëse, mbrojtja e detyrave dhe projekteve të kursit, dhe provimet përfundimtare.</p> <p>Nga takimi që GVJ zhvilloi me studentë të programit u theksua se zhvillimi i orëve interaktive, diskutimet dhe puna në grupe, nxisin të menduarit kritik dhe ndihmon mësimnxënie.</p> <p><i>Referenca: An. _4_Rregullore e UAMD.pdf;</i> <i>Referenca: An. _12_Rregullore e programit Master shkencor MM.pdf;</i> <i>Referenca: An. _26_Analiza Vjetore e Departamentit të Marketingut, 2021-2022.pdf;</i> <i>Referenca: An. _44_Kurrikul dhe plani mesimor Master shkencor MM riorganizim1.pdf;</i> <i>Referenca: An. _50_Syllabuset e lendeve te MSH per vitin 2022 - 2023.pdf;</i> <i>Referenca:RVB MSC. Menaxhim Marketing.pdf; Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënës.</p>	<p>Institucioni trajnon në mënyrë të vazhdueshme pedagogët mbi specifikat e rregullores, metodat didaktike të mësimdhënies dhe organizimin e punës akademike e shkencore. Në kuadër të respektimit dhe vlerësimit të lirisë akademike, stafi motivohet të sjellë risi në mësimdhënie me module interaktive dhe forma që nxisin debatin dhe zhvillojnë aftësitë praktike të studentëve.</p> <p>Institucioni mundëson kualifikime të vazhdueshme për stafin akademik si brenda dhe jashtë vendit. Personeli akademik angazhohet në punë kërkimore dhe pedagogjike brenda dhe jashtë vendit, ku nëpërmjet vizitave dhe shkëmbimeve në institucionet e huaja universitare, u mundëson ndjekjen e</p>

	<p>zhvillimeve më të fundit të fushës.</p> <p><i>Referenca: An. 1 Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025.pdf;</i> <i>Referenca: An. 26 Analiza Vjetore e Departamentit të Marketingut, 2021-2022.pdf;</i> <i>Referenca: An. 115 Publikime dhe konferenca shkencore stafi i departamentit.pdf; Referenca: RVB MSC. Menaxhim Marketing.pdf; Vizita në institucion.</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të personelit akademik, të angazhuar në mësimdhënien në programin Master Shkencor në “Menaxhim Marketing”, u vu re se në tërësi fusha e ekspertizës së pedagogut përputhet me syllabusin e lëndës në të cilën është titullar.</p> <p>Personeli akademik është i angazhuar në kërkim shkencor. Fusha kërkimore shkencore e personelit akademik është në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikat e moduleve të tyre të mësimdhënies. Rezultatet e punës kërkimore shkencore paraqiten në botime brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Nga takimi që GVJ realizoi me stafin akademik dhe studentët, evidentoi se mësimdhënia është interaktive duke inkurajuar pjesëmarrjen e të gjithë studentëve në diskutim. Përdorimi i rasteve të studimit me tematika aktuale dhe integrimi i literaturës ndërkombëtare krijon interes dhe përfshirje të studentëve në zgjidhje analitike të rasteve të huaja dhe vendase.</p> <p>Metodat interaktive të mësimdhënies përqendrohen tek mundësitë dhe interesat e studentëve. Personeli akademik i programit të studimit nxit studentët të ndërmarrin iniciativa të lira dhe të pavarura në ngritjen e grupeve të punës, zgjedhjen e temave, përgatitjen e detyrave të kursit në të cilat vlerësohen dhe mbi bazën e iniciativës dhe krijimtarisë së tyre, bashkëpunim në zgjidhjen e problemeve në seminare etj.</p> <p>Bashkëpunimi i ndërsjellë pedagog-studentë vihet re në auditor, në detyrat e ndryshme të kursit, në projekte kërkimi edhe në mbikqyrjen e praktikës mësimore, realizimi i të cilës mundësohet në sajë të kontakteve dhe bashkëpunimeve të Institucionit me institucionet publike dhe jo publike.</p> <p><i>Referenca: An. 115 Publikime dhe konferenca shkencore stafi i departamentit.pdf;</i></p>

	<p><i>Referenca: An. _26_Analiza Vjetore e Departamentit të Marketingut, 2021-2022.pdf;</i></p> <p><i>Referenca:RVB MSC. Menaxhim Marketing.pdf; Vizita në institucion.</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e progamit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Institucioni ka ndërtuar disa instrumentë që përdoren për përmirësimin e veprimtarisë mësimore. Performanca e personelit akademik vlerësohet edhe duke marrë shqetësimet apo sugjerimet e studentëve, përmes përdorimit të pyetësorëve anonimë dhe bisedave që realizohen në mbledhjet me studentët. Konkluzionet e marra nga këto vlerësime i shërbejnë procesit të përmirësimit të vazhdueshëm të kurrikulave, metodave të mësimdhënies si dhe përmirësimit të komunikimit e bashkëpunimit me studentët. Në këtë proces të monitorimit të procesit mësimor Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë dhe Drejtoria e Kurrikulës dhe Standarteve të Cilësisë luan rol të rëndësishëm pasi në mënyrë semestraledërgon një pyetësor tek të gjithë studentët për të marrë opinionin e tyre lidhur me format dhe metodat e mësimdhënies si dhe vlerësimin e dijeve. NJSBC i përdor këto rezultate të studentëve në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së procesit mësimor.</p> <p><i>Referenca: An. _29_Model pyetësori për studimin e stafit akademik.pdf;</i></p> <p><i>Referenca: An. _30_Formulare vetvlerësimi i performancave Model.pdf;</i></p> <p><i>Referenca: An. _34_Urdher i Rektorit për ngritjen e NJSBC.pdf;</i></p> <p><i>Referenca: An. _35_Kerkese nga studente për futjen e lendeve të reja në kurrikulën e MSC.pdf;</i></p> <p><i>Referenca: An. _39_Raporti i Vetvlerësimit 2019-2020 NJSBC.pdf;</i></p> <p><i>Referenca: An. _40_Analiza e rezultateve të anketimit për studentët, stafin akademik dhe administrativ).pdf;</i></p> <p><i>Referenca: An. _41.2_Pyetësori për Studentet Master Qershor 2023.pdf;</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë</p>	<p>Në funksion të procesit mësimor-kërkimor, në IAL UAMD janë organizuar struktura të posaçme dhe njësi që promovojnë përmirësimin e cilësisë.</p> <p>Sipas nenit 2 të Rregullores së Sistemit të Brendshëm të Cilësisë në nivel Institucional strukturat përgjegjëse për Sigurimin e Standarteve të Cilësisë janë:</p>

dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.

- Senati Akademik
- Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë (KPGSC)
- Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC)
- Koordinatori Institucional pranë ASCAL (KIAL)
- Drejtoria e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë (DKSC)

Ndërsa ë nivel Fakulteti përgjegjës për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë janë:

- Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë Fakulteteve (NjBSC Fakulteti)
- Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për çdo program (GVB.Bch. /GVB.MP. /GVB.Msc.)
- Koordinatorët e Programeve (Ko.Bch./Ko.MP/ Ko.Msc.)

NjBSC ne nivel Fakulteti, realizon në mënyrë autonome objektivat dhe masat e vendosura nga NjBSC ne nivel Institucional. Në realizimin e këtyre objektiveve NjBSC në nivel Fakulteti kërkon dosjen e programeve të studimit nga koordinorët e programeve. Në realizimin e objektiveve të akreditimit NjBSC në nivel Fakulteti bashkëpunon me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm për programet e studimit, duke u koordinuar nga NjBSC në nivel Institucional. Dokumentacioni i NjBSC në nivel Fakulteti i përcillet Dekanit dhe NjBSC në nivel Institucional.

Institucioni mbështet në relacionin e NJSBC për metodat e mësimdhëniesbazuar në rezultatet e pyetësorit me studentët si dhe nga diskutimet e analizës vjetore në departament për përmirësimin dhe integrimin e metodave të reja në mesimdhënie. Nga ana tjetër edhe pjesëmarrja në mobilitete sjell praktika të reja mësimdhënie, të cilat ndahen dhe diskutohen në departament dhe ndihmojnë njësinë për të krijuar dhe zbatuar metoda të reja novatore.

GVJ, pasi analizoi dokumentacionin përkatës si edhe diskutoi me stafin përgjegjës gjatë vizitës në institucion, konstaton seInstitucioni i ka realizuar me përgjegjësi detyrimet e tij në lidhje me organizimin e strukturave në nivel institucional për të nxitur përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinuar dhe bashkërenduar aktivitetin e përgjithshëm në

	<p>kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Gjithashtu Institucioni përdor instrumenta dhe zbulon mekanizma të rinj në funksion të përdorimit të metodave inovative të mësimdhënies.</p> <p><i>Referenca: An. _4_Rregullore e UAMD.pdf;</i> <i>Referenca: An. _25_Analiza vjetore e UAMD 2021 - 2022.pdf;</i> <i>Referenca: An. _26_Analiza Vjetore e Departamentit të Marketingut, 2021-2022.pdf;</i> <i>Referenca: An. _28_Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Cilësisë UAMD.pdf;</i> <i>Referenca: An. _38_Relacion i NjBSC mbi realizimin e mesimdhënies online dhe pyetesori.pdf;</i> <i>Referenca: An. _40_Analiza e rezultateve të anketimit për studentët, stafin akademik dhe administrativ).pdf;</i> <i>Referenca:RVB MSC. Menaxhim Marketing.pdf; Vizita në institucion.</i></p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ, pasi analizoi dokumentacionin përkatës si edhe diskutoi me stafin përgjegjës gjatë vizitës në institucion, konstaton se Institucioni i ka realizuar me përgjegjësi detyrimet e tij në lidhje me organizimin e strukturave në nivel institucional për të nxitur përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinuar dhe bashkërenduar aktivitetin e përgjithshëm në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Gjithashtu Institucioni përdor instrumenta dhe zbulon mekanizma të rinj në funksion të përdorimit të metodave inovative të mësimdhënies.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të	<p>Analiza paraprakisht e dokumentacionit rregullator të institucionit dhe njësisë qartësisht tregoi se kriteret dhe mënyra e vlerësimit të studentëve janë të përcaktuara në rregulloret përkatëse.</p> <p>Vizita në instucion, veçanërisht diskutimi me studentët konfirmoi vlerësimin se të gjitha kriteret dhe rregullat e mënyrat</p>

<p>studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>e testimit janë të njohura në sajë të publikimit në faqen e institucionit të planit mësimor, në syllabusin e lëndës si edhe informimit e sqarimit nëpërmjet strukturave të institucionit.</p> <p>GVJ konstaton se vlerësimi i dijeve është i vazhdueshëm duke përfshirë provimet ndërmjetëse, mbrojtjen e detyrave dhe projekteve të kursit, provimin final të lëndës dhe mbrojtjen e mikrotezës.</p> <p><i>Referenca: An. _4_Rregullore e UAMD.pdf;</i> <i>Referenca: An. _12_Rregullore e programit Master shkencor MM.pdf;</i> <i>Referenca: An. _19_Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf;</i> <i>Referenca: An. _31_Rregullore provimesh FB.pdf;</i> <i>Referenca: An. _48_Rregullore e Mikrotezës .pdf;</i> <i>Referenca: An. _50_Syllabuset e lendeve te MSH per vitin 2022 - 2023.pdf;</i> <i>Referenca: An. _74_Provimet dhe asistimet per sem I BSC + MSC.pdf;</i> <i>Referenca: An. _78_Komisionet dhe tabela e provimeve per sezonin e vjeshtes Master.pdf;</i> <i>Referenca:RVB MSC. Menaxhim Marketing.pdf; Vizita në institucion.</i></p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Në vijim të informacionit të dhënë tek kriteri 1 i këtij standardi, GVJ vlerëson se pedagogët i informojnë studentët në fillim të procesit mësimor me programin e lëndës, mënyrën e vlerësimit të njohurive dhe literaturën që do të përdoret në modulin përkatës.</p> <p>Metodologjia e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuse është e përshkruar edhe në nenin 68 të Rregullores së IAL, nenin 59 të Rregullores së Fakultetit të Biznesit si dhe nenin 19 të Rregullores së programit të studimit, gjithashtu edhe në rregulloren e provimeve të Fakultetit të Biznesit.</p> <p><i>Referenca: An. _4_Rregullore e UAMD.pdf;</i> <i>Referenca: An. _12_Rregullore e programit Master shkencor MM.pdf;</i> <i>Referenca: An. _19_Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf;</i> <i>Referenca: An. _31_Rregullore provimesh FB.pdf;</i> <i>Referenca: An. _50_Syllabuset e lendeve te MSH per vitin 2022 - 2023.pdf;</i></p>

	<i>Referenca:RVB MSC. Menaxhim Marketing.pdf; Vizita në institucion.</i>			
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	<p>GVJ konstatoi se në Rregulloren e Institucionit dhe atë të studimeve në Fakultetin e Biznesit dhe të njësinë bazë përcaktohen qartë se format e kontrollit të dijeve janë komplekse dhe të larmishme, përkatësisht nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Testimi i ndërmjetëm (vlerësuar me 400 pikë) • Detyrat e kursit ose projekte (vlerësuar me 100 pikë) • Provimi final (vlerësuar me 500 pikë) <p>Studentët njihen qysh në fillim të semestrit me mënyrën e kontrollit të dijës dhe formën e organizimit të saj, në secilin modul. Sistemi i pikëzimit dhe i vlerësimit mbi bazën e pikëzimit është gjithashtu i standardizuar dhe i përcaktuar.</p> <p><i>Referenca: An. _4_Rregullore e UAMD.pdf;</i> <i>Referenca: An. _12_Rregullore e programit Master shkencor MM.pdf;</i> <i>Referenca: An. _50_Syllabuset e lendeve te MSH per vitin 2022 - 2023.pdf;</i></p>			
Konkluzione	<i>Analiza paraprakisht e dokumentacionit rregullator të institucionit dhe njësisë qartësisht tregoi se kriteret dhe mënyra e vlerësimit të studentëve janë të përcaktuara në rregulloret përkatëse. Institucioni konsideron me përparësi identifikimin e metodave inovative të mësimdhënies dhe sigurimin e zbatimit të tyre në të gjithë procesin akademik.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara	Dokumentacioni rregullator si edhe syllabuset e çdo lënde përcaktojnë qartë mënyrën e vlerësimit të studentit, e cila bazohet në vlerësimin e studentit në mënyrë të vazhduar. Vlerësimi përfundimtar i studentit përmbledh vlerësimin gjatë zhvillimit të moduleve (provim i ndërmjetëm dhe detyra apo projekte kursi) dhe vlerësimin përmbyllës të çdo moduli

<p>në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>(provimi përfundimtar i modulit). Eshtë kompetencë e pedagogut që të përcaktojë raportin ndërmjet vlerësimit të vazhduar gjatë vitit dhe vlerësimit përfundimtar, si edhe të informojë studentët, të cilët duhet të njohin jo vetëm mënyrën por edhe nivelin e përgjithshëm të pikëve paraprake, përpara se sa të përfundojë kursi përkatës. Vizita në institucion tregoi se nuk ekzistojnë paqartësi apo konflikte për këtë çështje.</p> <p><i>Referenca: An. _4_Rregullore e UAMD.pdf;</i> <i>Referenca: An. _12_Rregullore e programit Master shkencor MM.pdf;</i> <i>Referenca: An. _19_Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf;</i> <i>Referenca: An. _31_Rregullore provimesh FB.pdf;</i> <i>Referenca: An. _50_Syllabuset e lendeve te MSH per vitin 2022 - 2023.pdf;</i> <i>Referenca:RVB MSC. Menaxhim Marketing.pdf; Vizita në institucion.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Në funksion të eliminimit të abuzimit dhe rritjes së transparencës IAL UAMD ka nënshkruar një marrëveshje me Fondin Shqiptar të Zhvillimit për implementimin e projektit Clean Score afati përfundimtar i të cilës është 31.12.2024. Ky projekt mundëson korigjimin e provimeve në formatin e pyetjeve me altermatitva nëpërmjet skanimit dhe leximit të përgjigjeve në formë kompjuterike përmes skanerave optikë. Stafi i fakultetit të Biznesit ka marrë trajnimin përkatës për qartësimin e funksionimit të kësaj metodologjie vlerësimi, dhe Departamenti i Marketingut e ka aplikuar këtë metodologji vlerësimi për programet bachelor dhe master.</p> <p>Evidentimi i vlerësimeve të studentëve bëhet nëpërmjet platformës së sekretarisë dixhitale të ngritur nga RASH sipas sistemit Pitagora. Në rast të hedhjes gabim të pikëve apo ndryshimit të tyre pas procesit të ballafaqimit të rezultateve me studentët, pedagogu i lëndës paraqet një kërkesë me shkrim drehtuar Dekanit të Fakultetit dhe kryesektetares dhe ndryshimi në sistem mund të realizohet vetëm në rast të miratimit të kërkesës.</p> <p><i>Referenca: An. 75Marreveshja UAMD - AADF Projekti Clean Score.pdf;</i> <i>Referenca: An. _75.1_Relacion zbatimi i Clean Score Sezoni i</i></p>

	<p><i>veres dhe dimrit 2021.pdf;</i> <i>Referenca: An. _75.2_Njoftim per trajnim Clean Score Trajnim.pdf;</i> <i>Referenca: An. 76Sistemi PITAGORA (RASH).pdf;</i> <i>Referenca: An. 7777. Manual perdorimi Aula.pdf;</i> <i>Referenca:RVB MSC. Menaxhim Marketing.pdf; Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Vlerësimi përfundimtar i moduleve që zhvillohen në këtë program studimi bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p> <p>Siç është përmendur edhe në kriteret e mësipërme, vlerësimi përfundimtar i studentit përmbledh vlerësimin gjatë zhvillimit të moduleve (provimi i ndërmjetëm dhe detyra apo projekte kursi) dhe vlerësimin përmblyllës të çdo moduli (provimi përfundimtar i modulit), saktësuar në syllabuset e çdo moduli. Ashtu siç e përcakton edhe ligji për arsimin e lartë modulet e programit të studimit janë të vlerësuara në kredite (ECTS), të cilat student i fiton pasi ka marrë një vlerësim pozitiv të vlerësimit përfundimtar.</p> <p>Korigjimi i provimeve semestrale realizohet nga pedagogu i lëndës, ndërsa riprovimet e sezoneve të vjeshtës, verës dhe dimrit korigjohen me komision provimesh të përbërë nga jo më pak se tre anëtarë përcaktuar nga përgjegjësi i departamentit dhe miratuar me vendim dekani. Në funksion të rritjes së objektivitetit dhe transparencës në vlerësim, departamenti si njësi bazë ngre një grup pune për verifikimin e kontrollit të procesit të provimeve.</p> <p><i>Referenca: An. _12_Rregullore e programit Master shkencor MM.pdf;</i> <i>Referenca: An. _50_Syllabuset e lendeve te MSH per vitin 2022 - 2023.pdf;</i> <i>Referenca: An. _78_Komisionet dhe tabela e provimeve per sezonin e vjeshtes Master.pdf;</i> <i>Referenca: An. _79_Vendim për ngritjen e grupeve të kontrollit te provimeve.pdf</i> <i>Referenca:Ligji per Arsimin e Larte 2015; VKM 412,viti 2018;VKM 879,viti 2019;VKM 185,viti 2021.</i> <i>Referenca:RVB MSC. Menaxhim Marketing.pdf; Vizita në institucion.</i></p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i</p>	<p>Vlerësimi i vazhduar dhe përmblyllës i çdo moduli njohurive</p>

<p>njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>shoqërohet me komente dhe argumentim për të ndihmuar studentin të kuptojë situatën e të nxënit dhe të përmirësohet. Ballafaqimi i studentit me rezultatet e provimeve përcaktohet në nenin 69 të rregullores së IAL, nenin 60 të rregullores së Fakultetit të Biznesit, si dhe nenet 22 dhe 23 të rregullores së programit të studimit.</p> <p>Studentët gjithashtu gëzojnë të drejtën e ankimit, pasi njihen me rezultatet e provimeve. Vizita në institucion ndihmoi GVJ të konkludojë se pedagogët e ushtrorin kompetencën e tyre të vlerësimit në mënyrë të përgjegjshme dhe të ndërgjegjshme.</p> <p><i>Referenca: An. 4_Rregullore e UAMD.pdf;</i> <i>Referenca: An. 12_Rregullore e programit Master shkencor MM.pdf;</i> <i>Referenca: An. 19_Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf;</i> <i>Referenca: An. 31_Rregullore provimesh FB.pdf;</i> <i>Referenca:RVB MSC. Menaxhim Marketing.pdf; Vizita në institucion.</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Njësia përgjegjëse dhe personeli akademik përpiqen që të eliminojnë kopjimin dhe plagjiaturën.</p> <p>Së pari, personeli i ngarkuar me mbikqyrjen e provimit zbaton tërësisht rregulloren. Së dyti, komisioni i ngarkuar për vlerësimin jo vetëm zbaton rregulloren por ndërmerr edhe masa ndëshkimore në rast të shkeljes së saj. Masat ndëshkimore për studentin përcaktohen sipas nenit 117 të rregullores së IAL. Ndërsa rregullat specifikohen në nenin 5 të rregullores së provimeve të Fakultetit të Biznesit.</p> <p><i>Referenca: An. 4_Rregullore e UAMD.pdf;</i> <i>Referenca: An. 31_Rregullore provimesh FB.pdf;</i> <i>Referenca:RVB MSC. Menaxhim Marketing.pdf; Vizita në institucion.</i></p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Në nenin 4 të rregullores së provimeve të Fakultetit të Biznesit “Zhvillimi i provimeve” përcaktohet se përgjegjësi i departamentit kontrollon dhe miraton tezën, mbi bazën e të cilës kontrollohen dhe vlerësohen njohuritë dhe dijet e përfituara. Gjithashtu përcaktohet afati i komunikimit të rezultateve të provimeve tek studentët, përkatësisht për provimet e ndërmjetme në javën pasardhëse të mësimit bëhet komunikimi i rezultateve dhe ballafaqimi i studentëve me tezën, ndërsa për provimet përfundimtare ky proces duhet të përfundojë jo më vonë se 72</p>

	<p>orë nga dita e zhvillimit të provimit përfundimtar.</p> <p><i>Referenca: An. _4_Rregullore e UAMD.pdf;</i> <i>Referenca: An. _31_Rregullore provimesh FB.pdf;</i> <i>Referenca:RVB MSC. Menaxhim Marketing.pdf; Vizita në institucion.</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Sikurse është përmendur edhe në kriterin e mësipërm studentët kanë të drejtën për tu njohur me rezultatet e provimit dhe për të parë tezën e tyre si dhe për tu njohur me zgjidhjen e saktë të secilës prej 4 tezave të realizuara gjatë orës mësimore në javën e parë pas provimit në rastin e provimit të ndërmjetëm dhe brenda 72 orëve në rastin e provimit përfundimtar.</p> <p><i>Referenca: An. _4_Rregullore e UAMD.pdf;</i> <i>Referenca: An. _31_Rregullore provimesh FB.pdf;</i> <i>Referenca:RVB MSC. Menaxhim Marketing.pdf; Vizita në institucion.</i></p>
<p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Studenti nëse do të ankimojë rezultatin e provimit, brenda tre ditëve kalendarike nga marrja e rezultatit paraqet kërkesën pranë njësisë kryesore. Njësia kryesore ia kalon këtë kërkesë njësisë bazë e cila mbledh anëtarët e saj dhe i drejton një relacioni me shkrimnjësisë kryesore. Në rastin kur njësia kryesore e miraton kërkesën, ajo ngre një komision ad-hock për rishikimin e tezës i cili rishikon vlerësimin e provimit në prani të studentit dhe anëtarëve të njësisë bazë brenda tre ditëve nga miratimi i kërkesës. Kjo procedurë specifikohet në nenin 71 të rregullores së IAL-së dhe nenin 62 të rregullores së Fakultetit të Biznesit.</p> <p><i>Referenca: An. _4_Rregullore e UAMD.pdf;</i> <i>Referenca: An. _12_Rregullore e programit Master shkencor MM.pdf;</i> <i>Referenca: An. _19_Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf;</i> <i>Referenca:RVB MSC. Menaxhim Marketing.pdf; Vizita në institucion.</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se jo vetëm nëpërmjet rregulloreve, por edhe si veprimtari praktike, e drejta e studentëve për t'u njohur me vlerësimin dhe ankimuar atë në rast se ankimi është i nevojshëm, është e garantuar dhe ushtrohet. Vizita në institucion ndihmoi GVJ të konkludojë se pedagogët e ushtrojnë kompetencën e tyre të vlerësimit në mënyrë të përgjegjshme dhe të ndërgjegjshme. Vlerësimi përfundimtar i moduleve që</i></p>

	zhvillohen në këtë program studimi bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.</p>	<p>Programi i studimit Master Shkencor në “Menaxhim Marketing” realizohet me 120 kredite, në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë me kohëzgjatje normale 2 vite akademike (4 semestra). Lidhur me përmbajtjen e programit të studimit, përbëhet nga (3) lëndë bazë, (9) lëndë të formimit karakterizues (4) lëndë ndërdisiplinore dhe me zgjedhje, lëndë plotësuese përfshihet vetëm praktika profesionale dhe në detyrimet përmblyëse përfshihet mikroteza.</p> <p>Programi ka përmbajtje të atillë që u ofron studentëve njohuritë bazë të nevojshme për profilin e programit, për të fituar aftësi dhe kompetenca në fushën e menaxhimit të marketingut dhe për tëndërtuar një karrierë të qëndrueshme në tregun e punës. GVJ konsideron të përshtatshme dhe efektive strukturën e programit si në raport me kërkesat bashkëkohore akademike ashtu edhe në raport me kërkesat e tregut lokal dhe rajonal të punës.</p> <p><i>Referenca: An. _12_Rregullore e programit Master shkencor MM.pdf;</i> <i>Referenca: An. _44_Kurrikul dhe plani mesimor Master shkencor MM riorganizim I.pdf;</i> <i>Referenca: RVB MSC. Menaxhim Marketing.pdf; Vizita në institucion.</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Plani Mësimor siguron informacion të mjaftueshëm për të konfirmuar se program i studimit Master Shkencor në “Menaxhim Marketing” me garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në teknologji (lënda E-Marketing- kategoria B), shkenca humane dhe shoqërore (Drejtim i Burimeve Njerëzore-kategoria A, Komunukimi i Integruar Marketing dhe Sjellje Konsumatore-kategoria B).</p>

	<p>Veçanërisht me vlerë është organizimi dhe realizimi i praktikës profesionale në institucione, organizata dhe ndërmarrje publike dhe jo publike.</p> <p><i>Referenca: An. _44_Kurrikul dhe plani mesimor Master shkencor MM riorganizim1.pdf;</i> <i>Referenca:RVB MSC. Menaxhim Marketing.pdf; Vizita në institucion.</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti në programin e studimit paraqiten në syllabuset e çdo lënde. Vlerësimi dhe analizimi i tyre bëhet në bazë të statistikave të rezultateve të pyetësorit të studentëve, diskutimeve me studentët dhe vlerësimeve përfundimtare të lëndës të cilat analizohen nga pedagogu përkatës i lëndës dhe diskutohen në mbledhje të departamentit për reflektime të mëtejshme në përputhje me qëllimet e programit të studimit. Tregues statistikorë të mbledhur nga institucioni (aneksa tabela 21), që reflektojnë ecurinë e studentëve, gjithashtu konsiderohen për të argumentuar efektivitetin e programit të studimit.</p> <p><i>Referenca: An. _26_Analiza Vjetore e Departamentit të Marketingut, 2021-2022.pdf;</i> <i>Referenca: An. _32_Raport vlerësimi për stafin akademik nga studentët shembull.pdf;</i> <i>Referenca: An. Tabelat shoqeruese ASCAL.pdf;</i> <i>Referenca:RVB MSC. Menaxhim Marketing.pdf; Vizita në institucion.</i></p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e</p>	<p>Vizita në institucion, veçanërisht diskutimi me studentët, konfirmoi vlerësimin e GVJ, mbështetur në përshtypjet dhe deklaratimet mjaft pozitive të studentëve. Praktika profesionale iu mundëson studentëve të vendosin në praktikë kompetencat e fituara gjatë zhvillimit të moduleve të programit. Një nga mënyrat e vlerësimit të studentëve realizohet nëpërmjet bashkëpunimit dhe mbikqyrjes së përgatitjes të një detyre kursi ose projekti, të vlerësuar me 10 % të vlerësimit përfundimtar, në varësi nga specifikat e modulit si edhe vendimi i pedagogut përkatës. Detyrat e kursit shërbejnë si një bazë praktike shumë e rëndësishme për punën e temës së diplomës.</p> <p>Personeli akademik në mënyrë të vazhdueshme mbështet, orienton dhe instrukturon studentët sipas grupeve të punës në lidhje</p>

<p>ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>me realizimin e detyrës së caktuar dhe stimulon zgjidhjen e një problemi biznesi në kontekstin e marketingut. Në këtë proces personeli akademik mbështet idetë inovative të studentëve në zgjidhjen e problemeve të biznesit dhe identifikon fushat të cilat kanë nevojë për thellim teorik dhe studim të mëtejshëm. Njësia, nga ana tjetër i krijon studentëve mundësi në përfshirjen e tyre në kërkime shkencore, dhe është vazhdimisht aktive në sigurimin e programeve të shkëmbimeve Erasmus.</p> <p><i>Referenca: An. _1_Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025.pdf;</i> <i>Referenca: An. _24_Lista e Mobiliteteve të Stafit & Studenteve në fakultetin e biznesit.pdf;</i> <i>Referenca: An. _50_Syllabuset e lendeve të MSH për vitin 2022 - 2023.pdf;</i> <i>Referenca: An. _71_71. Libri proceeding i konferencës studentore fq e para.pdf;</i> <i>Referenca: An. _94_Rregullore e Praktikës Profesionale.pdf;</i> <i>Referenca: RVB MSC. Menaxhim Marketing.pdf; Vizita në institucion.</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se njësia bazë bën përpjekje intensive që të ofrojë të reja më të përditësuara të shkencës dhe teknologjisë si nëpërmjet leksioneve të hapura ashtu edhe organizimit të seminareve. Gjatë vitit akademik 2022-2023 janë realizuar disa leksione të hapura me pjesëmarrje të ekspertëve. Në këto aktivitete gama e çështjeve të trajtuara paraqitet e larmishme. GVJ vlerëson gjithashtu edhe kontributin dhe punën e Departamentit të Marketingut në sjelljen e zhvillimeve të reja të shkencës dhe teknologjisë nëpërmjet organizimit të Konferencës Shkencore Ndërkombëtare ISCOIM.</p> <p><i>Referenca: An. _70_Foto nga stafi akademik organizativ i konferencës dhe nga video-konferenca.pdf;</i> <i>Referenca: An. _83_Lista Aktiviteteve Dep Marketingut v.a. 2020-2021.pdf;</i> <i>Referenca: RVB MSC. Menaxhim Marketing.pdf; Vizita në institucion.</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni nxit</p>	<p>Iinstitucioni mbështet studentët duke nxitur zhvillimin e ideve</p>

<p>zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>inovative dhe iu krijon mundësi për përfshirje në projekte, i përfshin në kërkim nëpërmjet shkrimit dhe mbrojtjes së mikrotezës së diplomës si dhe nëpërmjet pjesëmarrjes në konferencën e përvitshme studentore të Fakultetit të Biznesit si dhe në konferencën ISCOIM të organizuar nga Departamenti i Marketingut.</p> <p><i>Referenca: An. _70_Foto nga stafi akademik organizativ i konferencës dhe nga video-konferenca.pdf;</i> <i>Referenca: An. _71_Libri proceeding i konferencës studentore fq e para.pdf</i> <i>Referenca: An. _83_Lista Aktiviteteve Dep Marketingut v.a. 2020-2021.pdf;</i> <i>Referenca: An. _84_Vendim dekanati per ngritje komisioni per konferencen studentore pdf;</i> <i>Referenca:RVB MSC. Menaxhim Marketing.pdf; Vizita në institucion.</i></p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konsideron të përshtatshme dhe efektive strukturën e programit si në raport me kërkesat bashkëkohore akademike ashtu edhe në raport me kërkesat e tregut lokal dhe rajonal të punës.</i></p> <p><i>Vizita në institucion, veçanërisht diskutimi me studentët, konfirmoi vlerësimin e GVJ, mbështetur në përshtypjet dhe deklaratimet mjaft pozitive të studentëve. Praktika profesionale iu mundëson studentëve të vendosin në praktikë kompetencat e fituara gjatë zhvillimit të moduleve të programit.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi III.5 Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.</p>	<p>Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike, që në fillim të semestrit. Për t'u diplomuar studenti të mbrojtë një punim diplome krijues dhe origjinal, i cili mund të jetë i karakterit teorik ose empirik që lidhet ngushtë me tematikën që mbulon programi i studimit. Përcaktimet për këtë</p>

	<p>procedurë përshkruhen qartësisht në rregulloren e IAL, rregulloren e Fakultetit, rregulloren e Departamentit si dhe rregulloren e programit të studimit, ndërsa specifikimet e detajuara jepen në rregulloren e diplomimit.</p> <p>Pasi njësia bazë vë në dispozicion të studentëve fushat e ekspertizës së stafit, studentët paraqesin kërkesat e tyre për miratimin e udhëheqësit të mikrotezës i cili miratohet nga njësia bazë sipas nenit 14 (aneksi B) të rregullores së diplomimit. Ndërsa neni 14 (aneksi C) përshkruan kriteret dhe standartet e punimit të mikrotezës.</p> <p><i>Referenca: An. _4_Rregullore e UAMD.pdf;</i> <i>Referenca: An. _12_Rregullore e programit Master shkencor MM.pdf;</i> <i>Referenca: An. _19_Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf;</i> <i>Referenca: An. _48_Rregullore e Mikrotezës .pdf;</i> <i>Referenca: An. _54_Rregullore e Departamentit Marketing.pdf</i> <i>Referenca:RVB MSC. Menaxhim Marketing.pdf; Vizita në institucion.</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Njësia bazë mbështet studentët duke iu vënë në dispozicion të gjithë informacionin e duhur në funksion të mbrojtjes së mikrotezës duke përfshirë këtu listen e stafit akademik me fushën përkatëse të ekspertizës dhe numrat e tyre të kontaktit, listen e studentëve që mund të paraqiten për mbrojtjen e mikrotezës si dhe kriteret dhe standartet e punimit të mikrotezës.</p> <p><i>Referenca: An. _48_Rregullore e Mikrotezës .pdf;</i> <i>Referenca: An. _62.1_E-mail formatet e udhëheqjes dhe lista e pedagogeve udhëheqes.pdf;</i> <i>Referenca: An. _86_Komunikimi me student te msc per temen e diplomes.pdf;</i> <i>Referenca: An. _87_Tabela e shperndarjes se temave te diplomes me udhëheqes ne MSH .pdf</i> <i>Referenca:RVB MSC. Menaxhim Marketing.pdf; Vizita në institucion.</i></p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/</p>	<p>Kjo formë aplikohet për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e ciklit të dytë MP dhe jo për këtë program studimi.</p>

<p>modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbysllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentin në përcaktimin e temës së diplomës (sipas specifikimeve në kreun III të rregullores së mikrotezës), apo për çdo vështirësi me të cilin studenti ndeshet gjatë punës së tij, nëpërmjet konsultimeve të vazhdueshme me studentin, si dhe duke i përcaktuar studentit programin e punës dhe afatet e realizimit të tij. Gjithashtu, njësia bazë gjatë shqyrtimit të propozimeve të studentëve për temën e tezës master, garanton që udhëheqësi i propozuar nga studentët të jetë në përputhje me fushën e programit të studimit dhe temën e propozuar. Studentët njoftohen për listën e miratuar me temat dhe pedagogët udhëheqës.</p> <p>Udhëheqësi gjatë konsultimeve me studentin duhet të trajtojë çështje të tilla si: diskutimin e dobisë së punimit; përzgjedhjen e tematikës dhe të problematikës që do të trajtohet; ndërtimin e hipotezave dhe saktësimin e tyre; ndërtimin e strukturës së punimit etj. Udhëheqësi është garantues i cilësinë së punimit të diplomës të studentit. Diploma nuk mund të dorëzohet për mbrojtje nga studenti, pa marrë firmën e pedagogut udhëheqës si garantues i cilësisë së saj akademike. Studenti nuk mund të mbrojtë punimin e diplomës pa përmbushur të gjitha detyrimet e tjera të programi.</p> <p><i>Referenca: An. _48_Rregullore e Mikrotezës .pdf;</i> <i>Referenca: An. _88_Pjese nga Mikrotezë me komente.pdf;</i> <i>Referenca: An. _89_Shembull diplome e firmosur.pdf;</i> <i>Referenca:RVB MSC. Menaxhim Marketing.pdf; Vizita në institucion.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Pedagogu udhëheqës gjatë konsultimeve që i ofron studentit trajton çështje të tilla si: sqarimin e aspekteve metodologjike, përpunimin e të dhënave me metoda sasiore dhe cilësore; punën në terren, planifikimin, implementimin, raportimin e gjetjeve/të dhënave, etj. Sipas nenit 84 (pikat ç, d dhe i) të rregullores së Fakultetit të Biznesit IAL vë në dispozicion të studentëve bibliotekën dhe laboratorët e kompjuterave për kryerjen e analizave statistikore dhe përpunimin e të dhënave të të mikrotezës.</p> <p><i>Referenca: An. _19_Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf;</i> <i>Referenca: An. _48_Rregullore e Mikrotezës .pdf;</i></p>

	<i>Referenca:RVB MSC. Menaxhim Marketing.pdf; Vizita në institucion.</i>
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studentit vlerësohet me notë.	<p>Mbrojtja e e mikrotezës së diplomës bëhet përballë një komisioni të propozuar nga njësia bazë dhe të miratuar nga njësia kryesore i cili duhet të ketë të paktën një gradë shkencore. Vlerësimi përfundimtar i mikrotezës llogaritet si mesatare e vlerësimeve të komisionit. Nëse anëtari i komisionit është edhe udhëheqës i diplomës nuk ka të drejtën e vlerësimit, për të garantuar objektivitetin dhe transparencën e vlerësimit.</p> <p>Vlerësimi i mikrotezës bëhet me një system prej 1000 pikësh i cili konvertohet në notë në systemin shqiptar dhe në shkronjë në sistemin amerikan. Studenti njoftohet për rezultatin në fund të ditës.</p> <p><i>Referenca: An. _19_Rregullore e Fakultetit të Biznesit.pdf;</i> <i>Referenca: An. _85_Rregullore Diplomimi.pdf;</i> <i>Referenca: An. _90_Procesverbal i mbrojtjes se diplomes MSC.pdf;</i> <i>Referenca:RVB MSC. Menaxhim Marketing.pdf; Vizita në institucion.</i></p>
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studentit pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	<p>Në përfundim të studimeve në programin Master Shkencor në “Menaxhim Marketing”, studentit pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Studentit i vihet në dispozicion një kopje e plotë e programit të studimit të zhvilluar nga IAL UAMD nga Drejtoria e Kurrikulës dhe Standarteve të Cilësisë, sektori i çështjeve mësimore, vetëm në rastet kur kjo kërkohet nga studentit dhe ai paraqet kërkesë pranë sekretarisë mësimore.</p> <p><i>Referenca: An. _56_Suplement diplome Master shkencor.pdf;</i> <i>Referenca: An. _91_Diploma Master Shkencor “Menaxhim Marketing” model.pdf;</i> <i>Referenca:RVB MSC. Menaxhim Marketing.pdf; Vizita në institucion.</i></p>
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	<p>Dokumentacioni i studentëve ruhet nga Institucioni për një periudhë të pacaktuar që nga koha e rregjistrimit në programin e studimit deri në përfundim të studimeve. Çdo dokumentacion është i arkivuar në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi. GVJ vizitoi nga afër arkivin e sekretarisë mësimore ku verifikoi dosje të studentëve të regjistruar në këtë program ndër vite të cilat ruhen 5 vite, regjistrin themeltar (amzat) i cili ruhet</p>

	<p>përgjithmonë, regjistrin e arritjeve akademike (regjistrin mësimor semestral), proces verbale të provimeve dhe vlerësoi angazhimin e institucionit në këtë drejtim.</p> <p>Ruajtja e dokumentacionit bëhet në hard copy si dhe në databazën digjitale të IAL-së sipas përcaktimeve në nenin 24 të Rregullores për arshivimin e dokumentave.</p> <p><i>Referenca: An. _18_Rregullorja për Qarkullimin dhe Arshivimin e dokumentacionit të brendshëm në UAMD.pdf</i> <i>Referenca:RVB MSC. Menaxhim Marketing.pdf; Vizita në institucion.</i></p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ gjykon që procedura e ndjekur për paraqitjen dhe mbrojtjen e detyrimeve përmbyllëse është përshkruar qartë në rregulloret përkatëse, ndërsa njësia realizon detyrimet e saj për të informuar, ndihmuar, koordinuar dhe udhëhequr studentët drejt plotësimit të tyre.</i></p> <p><i>Dokumentacioni i studentëve ruhet nga Institucioni për një periudhë të pacaktuar që nga koha e rregjistrimit në programin e studimit deri në përfundim të studimeve.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit		Përmbushe t pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Këto kritere aplikohen për programet e studimit të Masterit Profesional.
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet,	

garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.									
Kriteri 3. Praktikat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.									
Konkluzione	<i>GVJ për tu shprehur në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bën një përmbledhje të shkurtër bazuar në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkrimore.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA
PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve						
<p>Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Institucioni ka angazhuar staf akademik PAE dhe PAK për të plotësuar kërkesat e programit, të cilët kanë përgatitjen profesionale në fusha të ndryshme dhe të angazhuar në mësimdhënie të lëndëve që përputhen me fushat e tyre të kërkimit shkencor. Në programin e studimit master shkencor në MM, stafi PAE mbulon 90% të ngarkesës. Në rregulloren e departamentit është e percaktuar qartësisht se është në mbështetje të aktivitetit kërkimor dhe shkencor dhe e ka realizuar atë praktikisht. Organizimi i grupeve mësimore dhe kërkimore parashikon një ndarje më të orientuar të punës kërkimore e shkencore, në drejtim të fushave dhe projekteve prioritare. Në rregulloren e Departamentit të Menaxhim-Marketingut janë të përcaktuara qartë detyrat dhe funksionet e grupeve kërkimore, në drejtim të procesit mësimor dhe atij kërkimor, siç është hartimi i planeve vjetore të kërkimit shkencor, përgatitja, propozimi, ndjekja dhe realizimi i projekteve kërkimore shkencore e atyre aplikative, organizimi i bashkëpunimeve me grupe të tjera kërkimore e shkencore brenda ose jashtë departamentit, fakultetit apo universitetit, brenda ose jashtë vendit, organizimi i bashkëpunimeve me sipërmarrjet private, organizimi i publikimit të rezultateve të punës kërkimore shkencore që zhvillon grupi apo anëtarët në përbërje të grupit si edhe nxit botimet shkencore brenda dhe jashtë vendit.</p>						
		2020 – 2021		2021 – 2022		2022– 2023	
Stafi akademik i programit të studimit		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr		0	1	5	0	1	1
Prof.As.Dr		6	0	1	0	5	2
Dr/PhD		6	1	7	2	6	0
Dr në proces		0	0	0	0	0	0
Msc		0	0	0	0	0	0
Total		12	2	12	2	12	3

	<ul style="list-style-type: none"> • Për vitin akademik 2020 – 2021 kanë dhënë mësim 14 pedagogë nga të cilët 12 PAE dhe 2 PAK. Raporti është 85,7% PAE dhe 14,3% PAK. Ky fakt tregon se personeli akademik me kohë të plotë kundrejt atij me kohë të pjesshme, përmbush detyrimet ligjore (Vendimit Nr 418, date 10/05/2017) për raportin të paktën 70 % PAE dhe jo më shumë se 30 % PAK. • Për vitin akademik 2021 – 2022 kanë dhënë mësim 14 pedagogë nga të cilët 12 PAE dhe 2 PAK. Raporti është 85,7% PAE dhe 14,3% PAK. Ky fakt tregon se personeli akademik me kohë të plotë kundrejt atij me kohë të pjesshme, përmbush detyrimet ligjore (Vendimit Nr 418, date 10/05/2017) për raportin të paktën 70 % PAE dhe jo më shumë se 30 % PAK. • Për vitin akademik 2022 – 2023 kanë dhënë mësim 15 pedagogë nga të cilët 12 PAE dhe 3 PAK (Raporti është 80 % PAE dhe 20 % PAK. Ky fakt tregon se Personeli akademik me kohë të plotë kundrejt atij me kohë të pjesshme, përmbush detyrimet ligjore (Vendimit Nr 418, date 10/05/2017) për raportin të paktën 70 % PAE dhe jo më shumë se 30 % PAK. <p><i>Referenca: Evidenca 6 Stafi akademik i departamentit Marketing, ne fushat specifike</i></p> <p><i>Referenca: Evidenca 5 Stafi akademik i departamentit Marketing ne vitet 2013-2023,</i></p>
--	--

<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Si u analizua edhe më sipër personeli akademik mbulon 90% të ngarkesës akademike në lidhje me programin e studimit MM duke siguruar qëndrueshmërinë e programit të studimit. Universiteti Aleksandër Moisiu, Fakulteti i Biznesit, Departamenti i Menaxhim-Marketingut në përputhje me kornizën ligjore në fuqi është i fokusuar në respektimin e planeve, objektivave dhe rezultateve të parapërcaktuara të programit Master Shkencore Menaxhim-Marketing. Përcaktimi i qartë i detyrave dhe objektivave, rregullimi i tyre me rregullore, udhezime. Ky angazhim mund të vihet re në aspektin formal dhe përmbajtësor të programit. Krahasimi i planeve mësimore, syllabusit, orarit të mësimit dhe dokumentave që personeli akademik depoziton në departament si regjistri i pedagogut, rezultatet evlerësimit të studentëve gjatë semestrit, dëshmojnë për korrektësi të respektimit të planit mësimor, orarit të mësimit si dhe mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit, vendit ku zhvillohet mësimi duke krijuar një vazhdimësi komunikimi me studentet. Kjo u vu re dhe nga vizita ne IAL dhe takimi me pedagoge, student.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Nga intervistimi stafit të angazhuar në programin e studimit, të personelit të Zyës së Personelit dhe pagave por edhe nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, u vu re qëndrueshmëria në vite e angazhimit të stafit si dhe procedurat institucionale për ta siguruar atë. Në zyrën Personelit dhe pagave u konsultua dokumentacioni i stafit të angazhuar dhe nuk u vu re asnjë parregullsi sa i takon pajisjes me kontrata dhe mbulimet me sigurime shoqërore e shëndetësore.</p> <p>Në përputhje me statutin e UAMD-së dhe rregulloren e Departamenti të Menaxhim-Marketingut administrohet Informacioni në lidhje me aktivitetin e personelit akademik, ndihmës akademik, administrativ dhe partner të angazhuar. Ky informacion ruhet në forme hardcopy dhe elektronike ne disa njësi të UAMD-së: Departamenti, Fakulteti niversiteti, Zyra e Personelit dhe Pagave, Zyra e finances.</p> <p><i>Referenca: Evidenca 106 Vertetim per kontributet e sigurimit shoqeror dhe shendetesor</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe</p>	<p>Nga verifikimet e dokumentacionit dhe vizita ne institucion, u konstatua që përzgjedhja Përzgjedhja e personelit me kohë të</p>

<p>vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>plotë bëhet me konkurim në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p> <p>Njësia bazë përcakton kriteret specifike për pozicionet e punës duke u mbështetur në nevojave të tyre, të cilat miratohen nga rektori.</p> <p>Njoftimi i konkursit për vendet e lira të punës shpallet në faqen zyrtare të Universitetit https://uamd.edu.al/mundesi-punesimi/, në formë të shkruar dhe elektronike, në të cilën përfshihen procedurat e aplikimit (pranohen vetëm me poste, dhe postimi bëhet brenda afateve të parashikuara në njoftim, kushtet që duhet të plotësojnë kandidatet dhe kriteret e vlerësimit).</p> <p>Nga drejtuesi i njësisë kryesore krijohet komisioni ad hoc për përzgjedhjen e kandidateve fitues, i cili do të bëjë shqyrtimin e dosjeve jo më shpejt se dhjetë ditë pune nga perfundimi i afatit të parashikuar</p> <p>Komisioni ad hoc përbëhet nga pesë anëtarë, nga të cilët, jo më pak se tre janë përfaqësues të njësive bazë, 3(tre) antarët e komisionit nga njësia baze propozohen nga Drejtuesi i Departamentit, Rektori dhe Dekani, përfaqësohen në komision respektivisht me nga një anëtarë të miratuar nga ata vetë. Vlerësimi i kandidatëve përfshin dy faza të njëpasnjëshme, që janë vlerësimi i dosjes dhe intervista. Vetëm kandidatët e kualifikuar nga data e shqyrtimit të dosjeve i nënshtrohen intervistës. Kriteret me të detajuara për vlerësimin me pike të kandidateve përcaktohen në rregulloren e universitetit si dhe ato të njësive kryesore në përputhje me specifikat e tyre. Drejtuesi i njësive kryesore i paraqet rektorit renditjen e kandidateve sipas vendimit të komisionit ad hoc dhe rektori lidh kontratën me kandidatin e përzgjedhur, mbështetur në legjislacionin në fuqi. Për përvojat të procesit mesimor/kerkimor me propozim të drejtuesit të njësive bazë rektori mund të komandojë me afat të caktuar staf akademik me kohe, të plote. Kontratat e punës, për të gjithë personelin akademik të universitetit, nënshkruhen nga rektori. Kontrata duhet të përmbajë përshkrimin e vendit të punës dhe detyrimet e personelit, sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p><i>Referenca: Evidenca 108 Model për aplikim për staf akademik</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshatshëm dhe të</p>	<p>Universiteti i Durrësit angazhon staf ndihmës akademik për zhvillimin e laboratorëve, por në rastin e programit të studimit MM, studentet kryejnë disa ore në laboratorët kompjuterike në lëndën “E-Marketing” me qëllim që të vëne në praktikë njohuritë</p>

<p>mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>që kanë marre nga ana teorike si dhe aftësimin e tyre për përpunimin e të dhënave të kërkimeve empirike në kuadër të punimeve të diplomës (takimi me stafin e angazhuar në programin e studimit MSHMM.)</p> <p><i>Referenca: Evidenca 52 Foto te laboratoreve</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Institucioni në strukturën e tij ka edhe Drejtorinë e Burimeve Njerëzore. Zyra e Burimeve njerëzore, mbledh, ruan dhe përditëson të dhënat e personelit akademik dhe ndihmës akademik pranë UAMD Pra sektori i Burimeve Njerëzore funksionojnë në nivel IAL-je .</p> <p>Nga intervistimi i personelit të Zyrës së Burimeve njerëzore por edhe nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion, kjo zyrë është përgjegjëse për të ruajtur të gjithë dokumentacionin procedural lidhur me stafin që angazhohet në fakultet, ruajtjen dhe përditësimin në çdo vit akademik të të dhënave të personelit efektiv dhe atij me kontratë (Rregullore e organizimit dhe funksionimit UAMD,)</p> <p>Kjo zyrë ka ndjekur procedurat për rekrutimin e personelit, ku kriteret i përcaktonte njësi bazë përkatëse, në vijim priteshin aplikimet, kontrolloheshin nga personeli përgjegjës, dhe procedoheshin për intervistim . Zyra e personelit ishte pjesë e të gjitha hallkave të procesit duke siguruar transparencën dhe përmbushjen e kërkesave ligjore dhe institucionale. Nga investigimi i dy dosjeve të rastësishme (një PAE dhe një PAK) nuk u vërejtën mangësi në dokumentacion.</p> <p><i>Referenca: Evidenca 107 Rregullore drejtoria e burimeve njerezore dhe juridike</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të</p>	<p>Institucioni është në gjendje të garantojë kapacitete infrastrukturore për të kryer veprimtaritë praktike lidhur me programin e studimit. UAMD dhe Fb kanë marrëveshje të shumta bashkëpunimi me kompani dhe institucione te tjera, në kuadër të zhvillimit të praktikave profesionale për studentët e këtij programi studimi. Në kurrikulën dhe planin mësimor të Masterit Shkencorë Menaxhim-Marketing pas përfundimit me sukses duke marrë notë kaluese në secilën prej tyre, përfshijnë detyrimet përmbyllesë të kryerjes dhe mbrojtjes së Praktikës Profesionale dhe të mbrojtjes së temës së diplomës. Në asistimin dhe ndihmën e zhvillimit me sukses të temës së diplomës angazhohet pothuaj i gjithë stafi akademik i brendshëm I</p>

<p>tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Departamentit Marketing. Në këtë program praktika profesionale zë të një vend të rëndësishëm në aftësimin praktik të studentëve, mbasi zhvillimi i praktikës ndihmon jo vetëm në aftësimin praktik të studentëve por, mund të konsiderohet një mundësi angazhimin e mëtejshëm në po atë punë. Njësia Nga komunikimi me studentet e këtij programi, me pedagogët që japin mësim në këtë program studimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit, u vërejt që Fakulteti i Biznesit si dhe UAMD-ja kanë bërë përpjekje për të ndihmuar studentët në lidhje me institucionet, bizneset apo kompanitë ku do të bëjnë praktikën profesionale, duke ju vënë në dispozicion studentëve marrëveshjet e bëra prej tyre. Edhe zhvillimi i Panairit të Punës & Karrierës, i organizuar nga Fakulteti i Biznesit duke filluar nga qershor të vitit 2021 (dhe duke vazhduar në prill 2022 dhe maj 2023) ku kanë marrë pjesë mbi 200 biznese dhe institucione publike ka qenë një mundësi konkrete e kontakteve të drejtperdrejta (nëpërmjet intervistave dhe dorëzimit të CV) të studentëve me institucionet publike dhe private.</p> <p><i>Referenca: Evidenca 20 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit FB</i></p> <p><i>Referenca: Evidenca 23 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit te departamentit Manaxhim marketingu</i></p>
<p>Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Në bazë të marrëveshje të bëra me institucionet pritëse për zhvillimin e praktikës, departamenti e pajis studentin me atë që quhet paketë e praktikës. Në këtë dokument paraqiten pritshmëritë e IAL për studentin praktikant por edhe vlerësimi që i bën institucioni pritës studentit sipas një fishe vlerësimi. Në dokumentin e ofruar nga IAL paraqitet kjo praktikë si dhe lista e studentëve që kanë kryer praktikat në institucionet pritëse Pedagogu udhëheqës duhet të ushtrojë kontrollë periodike pranë institucioneve/kompanive që studenti po zhvillon praktikën. Kohëzgjatja e Praktikës Mësimore është 3 muaj. Në fund të praktikës e përpara mbrojtjes përfundimtare të praktikës mësimore, studenti praktikant ka për detyrë të dorëzojë pranë departamentit dokumentacionin e miratuar për praktikën mësimore sipas formateve përkatëse të paraqitura në rregulloren e praktikës profesionale Aneksi 1,2,3)</p> <p>Tre dokumentet janë: Formulari i vlerësimit të studentit nga pedagogu mbikëqyrës (Aneksi 1); Formulari i vlerësimit të studentit nga mbikëqyrësi në kompani/institucion/organizatë ku</p>

	ai/ajo ka bërë praktikën (Aneksi 2); Raporti përfundimtar i praktikës, e përgatitur nga studenti sipas formatit përkatës (Aneksi 3).			
	<i>Referenca: Evidenca 94 Rregullore e Praktikës profesionale</i>			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson që personeli akademik që mbulon programin e studimit, përbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	<p>Duke Referuar RVB, vizitës në institucion dhe të dhënave në portalin e ASCAL për infrastrukturën e UAMD dhe Fakultetit të Biznesit, GVJ konstaton se institucioni disponon salla leksionesh dhe auditorë për seminare. Sallat e leksioneve dhe të seminareve janë të pajisur me kompjutera e projektorë. Procesi mësimor për programin e studimeve Master Shkencor në "Menaxhim Marketing", zhvillohet pranë ambienteve të Fakultetit të Biznesit, Godina 2, Kampus, Spitalë, Durrës. Kjo godinë është e organizuar në 4 kate dhe ka në përbërje të saj 15 auditorë, 2 laboratore për zhvillimin e lëndëve të ndryshme si Informatikë, Statistikë, Ekonometri, Kontabilitet, Metoda të Kërkimit Shkencor etj.</p> <p>Ka 1 sallë konferencash 4 salla mbledhjesh 43 zyra, bibliotekë Ndërkohë që studentët e Masterit Profesional "Menaxhim Marketing" kanë në dispozicion edhe një bibliotekë tjetër e cila nuk ndodhet te godina Nr. 2 por është e pëbashkët për tre Fakultete dhe ndodhet te godina Nr. 1. Sipërfaqja e kësaj biblioteke është afërsisht 200 m² dhe</p>

	<p>ka një kapacitet për të studiuar 30 studentë njëkohësisht.</p> <p><i>Reference: Evidenca 105 Permbledhese e kapaciteteve te UAMD-se</i></p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Nga konstatimi gjatë vizitave në institucion, u vu re që ambientet Godinës Nr. 2 janë të mjaftueshme për realizimin e programit të studimit. Këto ambiente përfshijnë salla, zyra, laboratorë, biblioteke.</p> <p>Godina ku zhvillohet mësimi për këtë program studimi, plotëson kriteret teknike si edhe normativën e sipërfaqes së shfrytëzueshme, referuar VKM Nr. 418, datë 10.05.2017 “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe degëve të tyre”, sipas të cilit kërkohen 2.5 m²/student. Rezultonse referuar sipërfaqes gjithsej, Fakulteti i Biznesit ka kapacitete mbajtëse për një numër prej 5066 studentësh.</p> <p>Në godinën Nr. 2, në auditore, laboratorë, sallën e konferencave, sallat e mbledhjeve dhe zyra funksionon sistemi i ajrit të kondicionuar ngrohje-ftohje. Gjithashtu në varësi të funksionit të orëve mësimore këto ambiente janë të pajisura me mjetet e nevojshme të përshtatshme për mësimdhënie si kompjutera (desktop, laptop), video-projektorë, lidhje interneti, prize etj.</p> <p><i>Reference: Evidenca 105 Përmbledhëese e kapaciteteve të UAMD-së</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Në këtë program studimi nuk zhvillohen laboratorët, për shkak të tipologjisë së lëndëve që zhvillohen, por gjithsesi, Departamenti përgjegjës për këtë program studimi, ka vënë në dispozicion ambientet e laboratorëve që gjenden në Fakultet, të cilët janë të pajisur me një sërë software. Për realizimin e disa lëndëve (ne cikle te tjera studimi) dhe/ose disa temave të veçanta është i nevojshëm shfrytëzimi i laboratorëve kompjuterike. Studentët e të gjitha cikleve të studimit në Fakultetin e Biznesit në përgjithësi dhe ata të Departamentit të Marketingut në veçanti, kanë mundësi të shfrytëzojnë të gjitha ambientet e mëposhtme. Ne dispozicion te tyre jane dy salla kompjuterash (rreth 50 kompjutera gjithësej). Salla e konferencave është në dispozicion të studentëve të masterit gjatë kohës së mbrojtjes së praktikës mësimore ose mbrojtjes së diplomës para komisioneve përkatës. Të gjitha këto salla janë të pajisura me softeware specifike që ndihmojnë në realizimin e punës së pavarur të studentëve. Kjo e fundit përdoret</p>

	<p>edhe për mbrojtjen e dizertacioneve para jurisë dhe prezantime të ndryshme në kuadër të promovimit të stafit akademik.</p> <p><i>Referenca: Evidenca 52 Foto te laboratoreve dhe auditoreve</i> <i>Referenca: Vizita e GVJ ne institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Godina ku zhvillohet mësimi për këtë program studimi, disponon laboratore informatike, por gjithashtu klasat e leksioneve janë të pajisura me videoprojektor dhe me mundësi për të aksesuar sistemin Wireless të internetit, që mund të nevojitet për zbatimin apo përmirësimin e procesit mësimor. Edhe në klasat e seminareve mund të përdoren mjetet audiovizuale, që janë të depozituara në department dhe mund të ofrohen nga sekretaria e departamentit për të realizuar prezantime, detyra, projekte kursi. Gjithashtu u evidentua nga vizita e GVJ ne UAMD se disa klasa jane te pajisura me tabela, Whiteboard Smartboard dhe Wireless qe mundëson zhvillimin e mësimit në kushte shumë të mira. Çdo zyrë, sallë, ambient i bibliotekës dhe ambient në dispozicion të studentëve është e pajisur me internet Ethernet Cable.</p> <p><i>Referenca: Evidenca 52 Foto te laboratoreve dhe auditoreve</i> <i>Referenca: Vizita e GVJ ne institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorore me kapacitetet e nevojshme.</p>	<p>Konstatohet se Institucioni është në gjendje të garantojë kapacitetet infrastrukurore për të kryer veprimtaritë praktike lidhur me programin e studimit. Kurse ne lidhje me praktikat profesionale ato zhvillohen ne kompani, institucione te ndryshme. Institucioni dhe Fakulteti kanë marrëveshje të shumta bashkëpunimi me kompani dhe institucione te tjera në kuadër të zhvillimit të praktikave.</p> <p><i>Referenca: Evidenca 20 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit</i> <i>FB</i></p>
<p>KKonkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson që IAL ka vënë në dispozicion mjedise mësimore</i></p>

	<i>dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Referuar RVB dhe vizitës në institucion u konstatua se në dispozicion të studentëve ekziston biblioteka, në mesin ku zhvillohet mësimi për këtë program studimi. Në mjediset e këtyre bibliotekave studentët kanë mundësi të barabarta për të marrë shërbime si për të studuar ashtu edhe për të shfrytëzuar literaturën e tyre. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve të Masterit Shkencor Menaxhim-Marketing është e përditësuar dhe bashkëkohore. Ajo përditësohet në sillabuset e programit nga lektorët dhe në fillim të çdo viti akademik, lektorët pasqyrojnë në department përditësimet e bëra në syllabus mbi literaturën bazë dhe ndihmëse.
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet të literaturës me botime të viteve të fundit.	GVJ gjatë vizitës në IAL dhe dokumenteve në RVB konstatoi se departamenti Menaxhim-Marketing, njësia bazë, që ofron programin e studimit Masterit Shkencor në Menaxhim marketing, raporton në bibliotekën e Universitetit përditësimet dhe risit me botimet e reja të sjella nga pedagogët për sillabuset përkatës. <i>Referenca: Evidenca 50 Syllabuset e lendeve për MSH, për vitin 2022-2023</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Institucioni ka krijuar akses në bibliotekë për të gjithë studentët dhe garanton barazi në akses për literaturë të huaj dhe në gjuhën shqipe, si për programin e studimit në fjalë por edhe për UAMD në përgjithësi. Universiteti Aleksandër Moisiu siguron mjedise të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore. Godina ku ndodhet Fakulteti i Biznesit është përfunduar së ndërtuar në vitin 2018 dhe ofron kushtet më moderne dhe bashkëkohore për zhvillimin e aktiviteteve mësimore. Studentët e Masterit Shkencor e realizojnë mësimin nga dita e enjte deri ditën e diel.

	<p>Ditën e enjte dhe të premte oraret e leksioneve fillojne ne oren 17.50 - 20.50, orar i përshtatshëm që u krijon mundësi studentëve edhe të punojnë dhe të studiojnë pranë bibliotekës. Ditën e shtunë dhe të diel oraret e mësimave janë nga ora 8.30-17.40.</p> <p><i>Referenca: Evidenca 102 rregullorja e bibliotekes</i> <i>Referenca: Evidenca 103 Strategjia e bibliotekes</i></p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ gjatë vizites në biblioteke evidentoi që ishte përgjithësisht e pajisur me literaturë fizike në shqip dhe anglisht. Studentët mund të shfrytëzojnë mjediset e bibliotekës e cila është krijuar në fund të vitit 2007 dhe ka aktualisht në fondin e saj rreth 12000 tituj ne gjuhën shqipe dhe të huaj, në formatin letër dhe elektronik. Fondi shqip dhe i huaj mbulon gjithë fakultetet eunivrsitetit. Literatura është bashkëkohore, kryesisht shkencore memoshë mesatare 5-10 vjeçare.</p> <p>Biblioteka është e abonuar në një sërë revistash shkencore. Kapacitet e bibliotekës së FEA-së ofron 126 vende, kënde pune për punë në grup, kompjutera me mundësi akses në internet. Të gjitha këto kapacitete mund të shfrytëzohen nga studentët e masterit për të studiuar, realizuar detyrat dhe projektet e kursit apo prezantuar projektete tyre.</p> <p><i>Referenca: Evidenca 68 Të dhëna për platformën online Biblioteka</i> <i>Referenca: Vizita në IAL</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka krijuar akses të plotë në shfrytëzimin e kapaciteteve të bibliotekës për studentet e UAMD, përfshirë dhe studentët e këtij programi studimi, pa pagesë duke ofruar edhe platforma online. Biblioteka e Universitetit "Aleksandër Moisu" përfaqësohet gjithashtu në Bibliotekën Virtuale të Shqipërisë: COBIB.AL.</p> <p><i>Referenca: Evidenca 102 rregullorja e bibliotekes</i> <i>Referenca: Evidenca 103 Strategjia e bibliotekes</i> <i>Referenca: Evidenca 68 Të dhëna për platformen online Biblioteka</i></p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë</p>	<p>GVJ gjatë vizites ne UAMD, konstatoi se biblioteka është e pajisur me programe të integruara bibliotekare: COBISS (sistemi bibliografik kombëtar për vlerësimin e rezultateve të kërkimit në Shqipëri), me një rol qendror në sistemin e katalogimit të</p>



shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	përbashkët, në kërkimin e informacioneve bibliografike dhe nëudhëheqjen e bibliografive të kërkuesve shkencorë shqiptarë.
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Baza përmban regjistrime bibliografike për materiale libra (monografi, seriale, artikuj) dhe jolibra (CD, DVD etj.). Ky Sistemi mundëson shfrytëzimin pa kufizime nga i gjithë komuniteti i UAMD-se Studentët e Masterit Shkencor e realizojnë mësimin nga dita e enjte deri ditën e diel. Ditën e enjte dhe të premte oraret e leksioneve fillojnë në orën 17.50 - 20.50, orar i përshtatshëm që u krijon mundësi studentëve edhe të punojnë dhe të studiojnë pranë bibliotekës. Ditën e shtunë dhe të diel oraret e mësimave janë nga ora 8.30-17.40.</p> <p><i>Referenca: Evidenca104 Memo e kalendarit te biblotekes per fundjave</i> <i>Referenca: Evidenca102 rregullorja e biblotekes</i> <i>Referenca: Evidenca 103 Strategjia e biblotekes</i> <i>Referenca: Evidenca 68 Te dhena per platformen online Bibloteka</i></p>
<p>Kriteri 8.Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Departamenti i Marketingut, si pjesë e Fakultetit të Biznesit, është i orientuar për pasurimin e fondit fizik dhe të fondit online të bibliotekës. Përditësimet e pedagogëve që përcillen në sylabuse por dhe në literaturë ndihmëse, monitorohen dhe depozitohen në Bibliotekën e Universitetit.</p> <p>Konstatuam që biblioteka qendrore e Universitetit e ka parashikuar në Rregulloren e saj si objektivin kryesorë rritjen dhe pasurimin e fondit të literaturës mbi lëndët që zhvillohen në Universitetin Aleksandër Moisiu Biblioteka pasurohet edhe me punimet, materialet didaktike dhe librat universitar që depozitohen në bibliotekë. Çdo vit akademik, pedagogët mund të depozitojnë kërkesat e tyre për literaturën e nevojshme dhe mbështetëse të re për tu patur në bibliotekë.</p> <p><i>Referenca Evidenca 102 rregullorja e biblotekes</i> <i>Referenca: Evidenca 103 Strategjia e biblotekes</i> <i>Referenca: Vizita ne IAL</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson që IAL bën përpjekje të vazhdueshme për pajisur dhe përditësuar literaturën në mbështetje të mësimdhënies dhe</i></p>

	<i>mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	<p>Institucioni disponon një sërë procedurash, të mbështetura në statutin e UAMD-se, të cilat rregullojnë menaxhimin e informacionit që lidhet me studentin. Sekretaria mësimore disponon një sistem kompjuterik menaxhimi dhe administrimi të informacionit të studentit nga krijimi i kartelës dhe regjistrimi i parë deri në diplomim të tij (sekretaria online). Dokumentacioni themelor për studentët është: regjistri themeltar, që vërteton regjistrimin e studentit pajiset me numër matricullimi, regjistri i arritjeve akademike të studentëve si dhe regjistri i lëshimit të diplomave. Këto regjistra pas diplomimit të studentëve arkivohen në arkivën e Universitetit, si dhe ne arkiven e Shtetit shqiptar në formë hardcopy dhe elektronike. Gjatë vizitës në institucion, GVJ verifikoi mbajtjen e regjistrave manual nga sekretaria mësimore në lidhje me studentët e programit.</p> <p><i>Referenca: Evidenca 2 Statuti I UAMD neni 63, 91,92</i></p>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	<p>Referuar takimit të zhvilluar të GVJ me stafin e zyrës së personelit dhe pagave, rezulton se kjo zyre administron të dhënat dhe dokumentacionin për aktivitetin e personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ. Këto të dhëna ruhen kryesisht në formë manuale por edhe elektronike në disa njësi të Universitetit si departamenti, fakulteti, universiteti, zyra e finances dhe buxhetit etj. Informacioni në lidhje me veprimtarine e stafit akademik ruhet dhe nëpërmjet accounteve që stafi ka në portalin e UAMD-se apo sistemin ESSE3 ku ruhet dhe analizohet marrëdhënia e stafit me studentin ne termat e vleresimit per lendet ku pedagogu eshte kordinator</p> <p><i>Referenca: Evidenca 76 Sistemi Pitagora</i></p>

<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ vlerësoi se sistemi i menaxhimit të informacionit krijon akses për personelin dhe studentët përmes formave të ndryshme si raportet e analizës shkencore dhe mësimore në nivel departamenti, publikimi i detyrueshëm i aktiviteteve të stafit të programit në website personale, web, stenda dhe shpërndarja e informacionit që lidhet me mbarevajtjen e procesit mësimor. Të gjitha informacionet në lidhje me programin e studimit publikohen në stenda dhe web site të UAMD dhe janë të aksesueshme për publikun.</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Në Sistemin ESSE3 hidhen, ruhen dhe përpunohen të dhëna në lidhje me vlerësimin e studentit. Këtu studenti merr informacion në lidhje me të drejtën për të hyrë në provim, vlerësimin gjatë semestrit, notën përfundimtare etj, kurse portali i UAMD-së shërben si platformë ku studenti merr informacion në web-et e pedagogëve për materiale të ndryshme, cikël leksionesh ose informacione të tjera të rëndësishme për studentët.</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Monitorimi në kohë reale i aktivitetit të personelit akademik dhe ndihmës akademik, në Departamentin e Menaxhimit marketingut, bëhet nga përgjegjësi i departamentit dhe drejtuesit e grupeve mësimore kërkimore. Raportet e monitorimit në lidhje me orarin e mësimit, ngarkesën mësimore, etikën e komunikimit etj, përcillen në fakultet. Gjatë takimit që GVJ pati në institucion, u evidentua se sistemi i hedhjes së vlerësimit në platformën ESSE3 mund të vlerësojë në kohë reale nderhyrjet në sistem, si dhe parregullsi të tjera të stafit. Ky informacion vlerësohet dhe i dërgohet organeve drejtuese, për marrjen e masave.</p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Informacioni në lidhje me programin e studimit, publikohet në web në dy gjuhë, në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze. Faqja në gjuhën shqipe përmban të gjithë informacionet, ndërsa faqja në gjuhën angleze është në përditësim të siper.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson që UAMD dhe FB disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional, dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</i></p>
<p>Shkalla e përmbushjes së</p>	<p>Nuk Përmbushet Përmbushet Përmbushet</p>

standardit	përmbyshet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	GVJ referuar RVB dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Institucioni, konstaton se IAL harton një raport financiar dhe planin për mbështetjen financiare konform legjislacionit në fuqi, që rregullon veprimtarinë e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë. Raporti financiar shqyrtohet nga Drejtoria e Finances dhe Buxhetit në nivel institucional dhe jo në nivel njësie kryesore. <i>Referenca: Evidenca 109 Raporti financiar 2021-2022</i>
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	GVJ referuar RVB dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Institucioni, konstaton se në planin financiar përfshihen <ul style="list-style-type: none"> të ardhura: buxheti i shtetit, tarifat e shkollimit, tarifat e regjistrimit, të ardhura nga shërbime të ndryshme të kryera, donacione e burime të tjera etj; shpenzime: për pagat, shpenzime operative, sigurimin e cilësisë, pasurimin e bibliotekës etj; Të gjitha kategoritë e këtij kriteri janë të përfshira në këtë plan buxhet. <i>Referenca: Evidenca 109 Raporti financiar 2021-2022</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe	Referuar RVB-së konstatohet se IAL, auditohet në mënyrë të rregullt nga grupi i Auditit të Brendshëm pranë UAMD.

dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Për të siguruar transparencën e mbledhjes dhe përdorimit të fondeve, UAMD bën publike pasqyrat financiare të të ardhurave nga tarifat e studenteve dhe burimet e tjera të financimit. <i>Referenca: Evidenca 112 Raporti vjetor i auditit të brendshëm 2018-2019</i>			
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar. Relacioni mbi projekt buxhetin afatmesëm dhe afatgjatë hartohet në mënyrë periodike nga njësitë përgjegjëse të UAMD-se. Qëllimi është të kontrollohet i mbarevajtjes së programit të studimit si dhe vendosjen e objektivave dhe investimeve për përmirësimin e cilësisë dhe kërkimit shkencor. Ky raport financiar përmban informacion lidhur me tarifat e shkollimit dhe kontributet e tjera, si dhe ndarjen e burimeve financiare. <i>Referenca: Evidence 111 Tabela e kostove të programit MSHMM</i>			
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	GVJ, duke ju referuar RVB, e vërteton se Institucioni harton dhe raporton e analizës financiare për të paktën tre vitet e kaluara për të vërtetuar masën e realizimit të të ardhurave, si dhe nivelin e realizimit të shpenzimeve Ky dokument shërben për të identifikuar nevojat për financim dhe për të planifikuar ndërhyrjet e nevojshme.			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson që UAMD garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve. Por gjithashtu vlerësojmë që IAL duhet të bëjë më shumë përpjekje për t'u diferencuar në treg në mënyrë që të sigurojë qëndrueshmërinë e programit dhe të ardhurat që vijnë nga studentët.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Nga analiza e GVJ, u konstatua se IAL (Universiteti “Aleksandër Moisiu”) ka hartuar politika dhe procedura që mbulojnë në mënyrë të plotë ciklin hyrje deri në dalje të studentit në ciklin e dytë të studimeve universitare, Master Shkencor, në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi. Të gjitha këto politika janë të evidentuara në Statutin e Universitetit, në rregulloren e studimeve universitare të UAMD, Fakultetit të Biznesit, të programit të studimit të Ciklit të Dytë “Master Shkencor” në Menaxhim Marketing dhe Departamentit të Marketingut.</p> <p>Ky program studimi, funksionon ne baze te nje rregulloreje, sipas se ciles studenti qe ndjek kete program studimi pajiset me njohuri teorike dhe aftësim për të përballuar sfidat nga ana praktike në profesionin e tyre, i cili përshtatet me profilin e studimeve. Në fund të ciklit të dytë të studimeve Master Shkencor student merr nje diplome me 120 kredite në një kohëzgjatje normale studimi prej 2 vitesh. Gjuha e zhvillimit te programit është gjuhashqipe. Kriteret dhe procedurat e pranimit janë në përputhshmëri me kriteret e përcaktuar në legjislacionin në fuqi.</p> <p>Funksionimi i Fakultetit te biznesit, ku ben pjese dhe ky program studimi është përcaktuar sipas legjislacionit dhe Statutit dhe rregulloreve te UAMD.</p> <p><i>Referenca : Evidenca 4: Rregullore e UAMD</i></p>

	<p><i>Referenca: Evidenca 2 Statuti i UAMD</i> <i>Referenca: Evidenca 19 Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i> <i>Referenca: Evidenca 12 Rregullore e programit Master shkencor MM</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>IAL ka hartuar dhe ndjek politika dhe ka procedura te percaktuara qartesisht ne rregulloren e UAMD, rregulloren e FB per kandidatët studentë dhe studentët e programit të studimit</p> <p>Ne keto rregullore percaktohen qarte procedurat qe nga propozimi i kriterëve nga njesia baze, të cilat pastaj miratohen nga Dekanati dhe pas miratimit në Senatin Akademik, u vihen në dispozicion Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe ministrisë përgjegjëse për arsimin para fillimit të aplikimeve për pranime. Pranimet e studentëve në të gjitha programet e studimit bëhen me vendim të veçantë të komisioneve ad-hoc, në përputhje me standardet shtetërore, kapacitetet akademike dhe infrastrukturore, të cilat verifikohen dhe certifikohen nga ministria përgjegjëse për arsimin, të ngritura nga njësi kryesore, etj.</p> <p>Specifikisht ne rregulloren e programit te studimit Master shkencor “Menaxhim Marketing” jane percaktuar politika dhe procedura transparente për barazinë dhe të drejta për të gjithë kandidatët për studentë në këtë program studimi. Këto politika sigurojnë, informim për kriteret, afatet dhe procedurat e kalimit nga njëri vit në tjetrin, ciklet dhe programet e studimit nga ku mund të pranohet kontigjenti i aplikantëve.</p> <p><i>Referenca: Evidenca 4: Rregullore e UAMD</i></p> <p><i>Referenca: Evidenca 19: Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i></p> <p><i>Referenca: Evidenca 55: Kriteret e pranimeve per vitin 2022 - 2023</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas</p>	<p>IAL harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve, duke u mbështetur ne ligjet ne fuqi dhe rregulloret e saj. Departamenti si rregull propozon çdo vit kuotat dhe kriteret e pranimet, bazuar në kriteret ligjore, kapacitetet njërzore dhe ato infrastrukturore dhe më pas ato miratohen në Senat.</p> <p>Në këtë program mund të aplikojnë:</p>

<p>ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>Kandidatët që kanë përfunduar me sukses ciklin e parë të studimeve dhe plotësojnë kriteret e përcaktuara nga Departamenti.</p> <p>Kandidatët që kanë një diplomë të shkollës së lartë ekuivalente të një vendi të huaj;</p> <p>Si edhe shtetasit e huaj në kushtet dhe mënyrat e parashikuara nga marrëveshjet dypalëshe ose shumëpalëshe.</p> <p><i>Referenca: Evidenca 4: Rregullore e UAMD</i></p> <p><i>Referenca: Evidenca 19: Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i></p> <p><i>Referenca: Evidenca 55: Kriteret e pranimeve për vitin 2022 - 2023</i></p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Transferimi i studimeve, njohja dhe njësimi i diplomave“, Rregullorja e UAMD , miratuar me Vendim nr 154 datë 26.11.2018 të Senatit Akademik, Rregullorja e Fakultetit të Biznesit (neni 34,42,43) përcakton qartësisht kriteret e pranimit dhe përparimit të studimeve të studentëve, transferimit nga një program studimi tjetër, njohjes së studimeve të kryera në një program tjetër i plotë ose i pjeshëm apo edhe i realizuar në kuadër të projekteve të shkëmbimit Erasmus apo programe të tjera shkëmbimi studimesh. Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës ofron mundësi për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve për të gjithë ata që gëzojnë statusin e studentit, midis programeve të të njëjtit cikël studimi, brenda tij, apo institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë. Transferimet lejohen në të njëjtin cikël studimi e në fusha studimi të njëjta ose të përafërta dhe vetëm në fillim të vitit akademik.</p> <p>Në rregulloren e Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Fakultetit të Biznesit dhe Rregullore e Programit të studimeve Master në Menaxhim Marketing, propozohen kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve, të cilat miratohen në dekanat dhe shpallen në web-in e Universitetit / Fakultetit sipas programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me</p>	<p>Në nivel njësie bazë, bëhet një punë e vazhdueshme me studentët e FB, për t'i orientuar në studimet master, ndërkohë që departamenti ka hartuar dhe një politikë marketingu. Gjithashtu, përmes WEB, faqes zyrtare të facebook synohet të promovohet</p>

<p>kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>programi. Informacioni shpërndahet nëpërmjet mediave sociale si dhe stafit akademik të departamentit, studenteve të mëparshëm. Në rregulloren e Fakultetit të Biznesit neni 29, "Format e studimeve" dhe neni 34 "Pranimi në Programet e ciklit të dytë të studimeve" përcaktohen organet përgjegjëse dhe procedurat për përcaktimin e kriterëve të pranimeve të studentëve në Programet e ciklit të Dytë të studimeve.</p> <p>Gjithashtu: <i>Në këndvështrimin e ekspertëve të jashtëm, mund të shihen dhe forma të tjera të promovimit, sepse një master shkencor në MM mund të kryqëzohet me shumë programe studimi brenda UAMD.</i></p> <p><i>Referenca: Evidenca 19 Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Në lidhje me kriterin 6 dhe 7, duhet thënë që institucioni respekton aspektet ligjore të cilat përcillen vit pas viti nga MAS në lidhje me pranimin e kandidatëve që vijnë nga vendet fqinjë shqipfolëse dhe më gjerë, individët me aftësi të veçanta dhe individë që vijnë nga shtresat e marxhinalizuara. Këto kriteret përcaktojnë notën mesatare, formimin e aplikantit etj</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Vendimi për kuotat e pranimin të kategorive të studentëve si më lart merret në përputhje me rregulloret e institucionit në senat, pas propozimeve që vijnë nga njësitë kryesore/bazë dhe shpallen në web-in e Universitetit.</p> <p><i>Referenca: Evidenca 19: Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i></p> <p><i>Referenca: Evidenca 92: Memo shembull e pergjegjesit te departamentit mbi kriteret e pranimin ne Bsc dhe Msc</i></p> <p><i>Referenca: Evidenca 55: Kriteret e pranimeve per vitin 2022 - 2023</i></p>
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimin në programe me përparësi për institucionin dhe për</p>	<p>Në lidhje me këtë kriter institucioni ka ngritur një grup pune në Fakultetin e Biznesit, për pranimin dhe shqyrtimin e dokumentacionit për studentët e ciklit të parë dhe të dytë të cilët do të përfitojnë përjashtim apo reduktim të tarifës së shkollimit.</p> <p>Ky grup përcakton dhe dokumentacionin e paraqitur nga</p>

zhvillimin ekonomik të vendit.	studentët e cikit të parë të cilët do të trajtohen me bursë <i>Referenca: Evidenca 93 Vendime per reduktimin e tarifave v.a 2021 – 2022</i>			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson së në lidhje me këtë standard “Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit” UAMD ka formalizuar përmes rregulloreve dhe procedurave të gjitha elementët nga pranimi deri në diplomim.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Fakulteti i Biznesit, Departamenti i Marketingut realizojnë transparencën lidhur me përparimin akademik të karrierës së studentit përmes rregullores së UAMD dhe të Fakultetit e cila specifikon saktë organizimin e studimeve, vlerësimin e dijeve, transferimet dhe ekuivalentimi i studimeve Ekonomik pasqyrohen në mënyrë të hollësishme procedurat e përparimit akademik. Sipas rregullores së Fakultetit të Biznesit, Neni 52: “Frekuentimi i orëve mësimore”, lektori ka detyrim qe syllabusin t’ja bëj present që në orën e parë. <i>Referenca Evidenca 2: Statuti i UAMD</i> <i>Referenca: Evidenca 94: Rregullore e Praktikës Profesionale</i> <i>Referenca: Evidenca 48: Rregullore e mikrotezes</i> <i>Referenca: Evidenca 4: Rregullore e UAMD</i> <i>Referenca: Evidenca 85: Rregullore diplomimi</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të	FB informon studentët me të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me programet e studimit, procesin mësimor, rregulloren e institucionit, rregulloren e studimeve, procedurat në lidhje me aktivitete të ndryshme të procesit mësimor, etj. Ky informacion publikohet në format elektronik në websit-in e universitetit, i cili

<p>pjeshme.</p>	<p>është i aksesueshëm nga të gjithë studentët.</p> <p>Nga komunikimi me studentët dhe stafin gjatë vizitës në institucion u konstatua nga GVJ se në dispozicion të studentëve dhe të aksesueshëm nga ata, janë të gjithë dokumentet si Statuti i Universitetit, Rregullorja e UAMD, Rregullorja e Fakultetit, Rregullore e Programit të studimeve Master Shkencor “Menaxhim Marketing”, Rregullorja e departamentit. Të gjitha këto ndihmojnë dhe informojnë studentët për të parë qartazi kriteret e përcaktuara për procesin e konvertimit si dhe njohjen e kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.</p> <p><i>Referenca Evidenca 2: Statuti i UAMD</i> <i>Referenca: Evidenca 94: Rregullore e Praktikës Profesionale</i> <i>Referenca: Evidenca 48: Rregullore e mikrotezes</i> <i>Referenca: Evidenca 4: Rregullore e UAMD</i> <i>Referenca: Evidenca 85: Rregullore diplomimi</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se në Fakultetin e Biznesit, UAMD ka një strukturë të organizuar për të pajisur studentët me të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me programet e studimit, procesin mësimor, rregulloren e Fakultetit, Rregulloren e Programit, Rregulloren e Departamentit,</p> <p>Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të tyre në programin e studimit, procedurat në lidhje me aktivitete të ndryshme të procesit mësimor, etj. Informacioni i duhur publikohet përmes njoftimeve në stendat e Fakultetit të Biznesit, në format digjital përmes faqes së Fakultetit dhe Departamentit në rrjetet sociale.</p> <p><i>Referenca Evidenca 2: Statuti i UAMD</i> <i>Referenca: Evidenca 94: Rregullore e Praktikës Profesionale</i> <i>Referenca: Evidenca 48: Rregullore e mikrotezes</i> <i>Referenca: Evidenca 4: Rregullore e UAMD</i> <i>Referenca: Evidenca 85: Rregullore diplomimi</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Studimet e ciklit të dytë Master Shkencor në Menaxhim Marketing, përmbillen me punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë "Master Shkencor" në Menaxhim Marketing. Punimi i diplomës është një punim i pavarur shkencor i studentit. Departamenti informon studentët përmes stendave në Fakultet, rrjeteve sociale, apo leksione të hapura me</p>

	<p>studentët për kriteret që kërkohet të plotësohen për procedurat e punimit të diplomës. Nga ana tjetër, departamenti i vë në dispozicion studentëve përmes adresave të tyre elektronike Rregulloren e Diplomimit e cila njih studentët me mënyrën e punimit të tezës së masterit duke përfshirë jo vetëm formatin e shkrimit por edhe udhëzime në lidhje me organizimin e përgjithshëm të saj, kontrollin, vlerësimin e punimit etj. Të gjitha këto u konstatuan nga GVJ nga dokumentacioni dhe në takimet në institucion.</p> <p><i>Referenca Evidenca 2: Statuti i UAMD</i> <i>Referenca: Evidenca 94: Rregullore e Praktikës Profesionale</i> <i>Referenca: Evidenca 48: Rregullore e mikrotezes</i> <i>Referenca: Evidenca 4: Rregullore e UAMD</i> <i>Referenca: Evidenca 85: Rregullore diplomimi</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Departamenti i Marketingut ka faqen e tij në Facebook dhe Instagram ku informon publikun, partnerët dhe studentët e ardhshëm lidhur me programin e studimit. Gjatë vizitës në institucion, takimeve me stafin e departamentit të Administrim – Biznesit, takimeve me sekretarinë mësimore dhe studentët që ndjekin Masterin në Manaxhim marketingu, vlerësuam që përgjithësisht ndiqen rregulloret, procedurat dhe sistemet funksionojnë në plotësimin e veprimtarive mësimore të studentëve.</p> <p><i>Referenca Evidenca 2: Statuti i UAMD</i> <i>Referenca: Evidenca 94: Rregullore e Praktikës Profesionale</i> <i>Referenca: Evidenca 48: Rregullore e mikrotezes</i> <i>Referenca: Evidenca 4: Rregullore e UAMD</i> <i>Referenca: Evidenca 85: Rregullore diplomimi</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson se në lidhje me standardin "Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program" njësia kryesore dhe bazë ka ngritur strukturën e rregulloreve, ka vendosur në silabus elementët e duhur dhe ka ngritur punën në sekretarinë mësimore, në përmbushje të plotë të tij.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>Studentët kanë disa rrugë për t'u informuar për përmbajtjen e programit MSHM. Fillimisht është web i universitetit, fletëpalosjeve, komunikimit të drejtpërdrejtë në departamenti, faqes së fcb dhe instagramit, etj.</p> <p>Programi përmban 120 kredite, që ndahen mes lëndëve bazë, lëndëve karakterizuese, lëndëve plotësuese, lëndë më zgjedhje; praktikës mësimore dhe detyrimit përmbyllës të diplomës. Mësimi organizohet në 4 semestra, çdo semestër përmban 30 ECTS dhe zgjat 15 javë.</p> <p>Informacioni i përgjithshëm mbi politikat dhe procedurat mund të aksesohen në Rregulloren e Fakultetit të Biznesit, Rregulloren e Programit të studimeve Master Shkencor "Menaxhim Marketing".</p> <p><i>Referenca: Evidenca 4: Rregullore e UAMD</i> <i>Referenca: Evidenca 12: Rregullore e programit Master shkencor MM</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Fakulteti i Biznesit, Universiteti "Aleksandër Moisiu" ka një sistem të organizuar informacioni për të transmetuar te studentët të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me programet e studimit, procesin mësimor. Një burim tjetër i rëndësishëm informacioni është silabusi i lëndëve i cili qartëson llojin e lëndës, numrin e krediteve, semestrin në të cilin zhvillohet, mënyrën e vlerësimit të njohurive, detyrimet e lëndës, frekuentimin.</p> <p><i>Referenca: Evidenca 4: Rregullore e UAMD</i> <i>Referenca: Evidenca 12: Rregullore e programit Master shkencor MM</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe</p>	<p>Gjithashtu, në përputhje me Statutin e UAMD dhe Rregulloren e FB, Sekretaria mësimore dhe Zyra e Karrierës dhe Alumnit suportojnë studentët për të gjitha nevojat dhe kërkesat e tyre. Në</p>

<p>mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>kuadër të ofrimit të mundësive për përfshirjen e studentëve në tregun e punës, Zyra e Karrierës zhvillon aktivitete për studentët të cilat kanë si qëllim njohjen dhe përafrimin e tyre me tregun e punës, përgatitjen e tyre për t'u bërë pjesë e këtij tregu që në fazën e ndjekjes së studimeve, duke injohur ata me mënyrat e përpilimit të CV-ve për të aplikuar për punë (Curriculum Vitae), letrave të interest (Cover Letter), përgatitjen për të zhvilluar intervista sa më të mira pune, si dhe ofrimin e një pakete të plotë këshillimi për karrierën.</p> <p><i>Referenca:</i> Evidenca 13: Rregullore e Sektorit të Komunikimit, Alumnit _ Karrierës</p> <p><i>Referenca:</i> Evidenca 41: Shoqata Alumni UAMD dhe Aktivitetet</p> <p><i>Referenca:</i> Evidenca 95: Udhezues nga Qendra e Karrieres dhe Alumni UAMD</p> <p><i>Referenca:</i> Evidenca 96: Rregullore e Sekretarise Mesimore Karriera dhe Alumni - Universiteti "Aleksandër Moisiu" (uamd.edu.al)</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Studentëve u krijohet mundësia të aksesojnë informacion të plotë në lidhje me organizimin e mësimin përmes afishimit të orarit në stendat e vendosura në ambientet e Fakultetit të Biznesit, si dhe në facebook dhe Instagram të Fakultetit të Biznesit dhe të Departamentit. Nje vecanti eshte dhe sinjalistika e qartë që fillon që në hyrje të Fakultetit (në stenda apo dysheme), e bën të thjeshtë aksesimin e sallave të leksioneve, laboratorëve apo ambienteve të tjera ku studentët zhvillojnë veprimtarinë e tyre të përditshme. E vecanta per studentët e Programit Master është edhe zhvillimi i mësimin në fundjavë, gjë që ju krijon atyre mundësinë të ndjekin studimet në shërbim të kualifikimit të tyre për pozicionin e punës, pa patur nevojë të ndërpresin punën për të ndjekur studimet. Pjesë e infrastructures lehtësuese është edhe funksionimi i Bibliotekës ditën e shtunë, Sekretaria e Masterit krijon mundësinë që student tëi nformohet në mënyrë profesionale në lidhje me problematikat që ata hasin gjatë procesit mësimor.</p> <p><i>Referenca:</i> Evidenca 96: Rregullore e Sekretarise Mesimore</p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të</p>	<p>Nga vizitat ne institucion dhe komunikimin me studentet e ketij programi studimi GVJ, konstatoi se i gjithë informacioni në lidhje me procesin mësimor bëhet lehtësisht i aksesueshëm përmes website dhe rrjeteve sociale të UAMD, si dhe rrjeteve sociale</p>

brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Facebook dhe Instagram të Fakultetit dhe Departamentit (që i jep studentëve mundësinë e informimit në distancë), sekretarisë mësimore të Masterit, gjithashtu dhe nëpërmjet e-maileve të pedagogëve mentorues që ka Departamenti i Marketingut. Komunikimi me studentët mbështetet dhe në Strategjinë e komunikimit të UAMD-së.			
	<i>Referenca: Evidenca 97: Strategjia e Komunikimit – UAMD</i>			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson që në lidhje me standardin “Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit”.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	<p>Bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015, Rregulloren e UAMD çdo fakultet ka brenda njësinë e administratës, Sekretarinë Mësimore. Sekretaria Mësimore funksionon në bazë të të gjithë akteve ligjore dhe nënligjore, mbi këtë bazë njësia kryesore ka formuluar Rregulloren e Sekretarisë , që në setin e dokumentave të vendosura në platformën e ASCAL vjen si rregullore për krijimin, rregjistrimin, ruajtjen dhe dorëzimin e dokumentave</p> <p>Gjithashtu departamenti i Marketingut përgatit çdo vit analizën mësimore në të cilën janë të pasqyruara statistikave vjetore në lidhje me numrin e të diplomuarve në programin e masterit shkencor. Kjo bëhet pjesë e RVB të Fakultetit të Biznesit të çdo Viti Akademik si dhe e analizës vjetore të departamentit</p> <p>Ky informacion ruhet në Departament së bashku me shumë të dhëna të tjera në lidhje me studentët.</p> <p><i>Referenca: Evidenca 26: Analiza Vjetore e Departamentit të Marketingut, 2021-2022</i></p>

<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Në Sekretarinë Mësimore mbahen të gjitha statistikat në lidhje me numrin e studentëve: të regjistruar, të diplomuar, largimet, pezullimet, transferimet, ecuria e studentëve; proces-verbalet e provimeve, regjistri themeltar, dosjet e çdo studenti sipas udhëzimeve të MAS.</p> <p>Por, gjithashtu të dhënat që lidhen me statistikat, mund të gjenerohen në çdo kohë pranë Zyrës së komunikimit, Alumnit dhe Karrierës e cila funksionon si zyrë statistikash duke qenë se përpunon të gjitha të dhënat statistikore duke përfshirë statistikat mbi numrin e studentëve aktualë, studentëve të diplomuar, stafit mësimor efektiv dhe joefektiv, ngarkesës mësimore efektive, studentët që përfitojnë bursë etj., si dhe raportin periodikisht në Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve në lidhje me këto të dhëna. (Një informacion i detajuar gjendet në raportin e analizës mësimore, material i cili përgatitet çdo vit.)</p> <p><i>Referenca: Evidenca 26 Analiza Vjetore e Departamentit të Marketingut, 2021-2022</i></p>
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, ekspertët e jashtëm kaluan një kohë dhe në sekretarinë mësimore. Dosjet e ecurisë së studentëve nga semestri në semestër dhe për çdo vit akademik, regjistri themeltar dhe çdo informacion tjetër që ju kërkua stafit u vendos në dispozicion. Ruajtja dhe përpunimi i të dhënave personale të studentëve bazohet në parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje të plotë me kërkesat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe rregulloren e brendshme të universitetit dhe rregulloren e Fakultetit të Biznesit. I gjithë informacioni që lidhet me studentët ruhet në databazën e sistemit të brendshëm të informacionit në formë fizike dhe elektronike. Ky informacion është konfidencial dhe mund të aksesohet vetëm përmes një kërkesë me shkrim nga studenti, për të dhënat e tij për sa kohë studenti është i regjistruar.</p> <p><i>Referenca: Evidenca 96 Rregullore e Sekretarise Mesimore</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit,</p>	<p>Në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe me Ligjin 80/2015 të Arsimit të Lartë, sekretaria mësimore si pjesë e njësisë së Administratës të FB ne UAMD, ka ndërtuar gjithë sistemin e brendshëm të menaxhimit të informacionit për studentët që nga momenti i regjistrimit në përputhje me rregullat e MAS, deri në përfundim të studimeve dhe pajisjen me diplomë dhe suplementin e diplomës.</p>

<p>etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Gjatë vizitës në sekretarinë e studimeve master, dosjet fizike dhe “dosjet elektronike”, regjistrat, proces-verbalet, regjistri themeltar dhe çdo dokument tjetër që është nën përgjegjësinë e zyrës ishin lehtësisht të verifikueshme dhe mjaft mirë të sistemuara.</p> <p>Ruajtja dhe përpunimi i të dhënave personale të studentëve kryhej, bazuar në parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje të plotë me kërkesat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe rregulloren e brendshme të universitetit dhe rregulloren e Fakultetit të Biznesit.</p> <p><i>Referenca: Evidenca 96 Rregullore e Sekretarise Mesimore</i></p>			
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre regjesve.</p>	<p>Universiteti “Aleksandër Moisiu” harton raporte të përvitshme në lidhje me ecurinë e procesit mësimor, bazuar në udhëzimet e MAS, harton raportet vjetore, me një format standard dhe një nga rubrikat i referohet të dhënave të studentëve për çdo program studimi.</p> <p>Një Raport tjetër i rëndësishëm është dhe analiza vjetore e punës së departamentit, Një vend të veçantë në këtë Raport zë edhe analiza e gjendjes aktuale të programit duke i kushtuar vëmendje problematikave të ndryshme që lidhen me këtë program apo përmirësimeve të mundshme në funksion të mbarëvajtjes së tij, si dhe gjurmimit të studenteve të këtij programi.</p> <p>Këto raporte bëhen pjesë e raportit vjetor të UAMD dhe RVB-se fakultetit.</p> <p><i>Referenca: Evidenca 27 RVB e fakultetit të biznesit 2020-2021</i> <i>Referenca: Evidenca 26: Analiza Vjetore e Departamentit të Marketingut, 2021-2022</i> <i>Referenca: Evidenca 25: Analiza vjetore e UAMD 2021 – 2022</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ në lidhje me këtë standard vlerëson se UAMD administron gjithë informacionin në lidhje me studentët, nga pranimi, ecurinë e tyre në proces, deri në diplomimin e tyre dhe më tej si alumni në përputhje me bazën ligjore, një sërë rregulloresh të brendshme dhe raportime në nivel institucional dhe departamenti. Standardi përmbushet plotësisht. .</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>Ligji për Arsimin e Lartë Nr 80/2015 përcakton të drejtën e studentëve për t'u përfaqësuar në një sërë organesh vendimmarrëse dhe me rol konsultativ brenda strukturave të universitetit. Referuar këtij ligji dhe në zbatim të plotë të tij, Statutit të UAMD, Rregullores së UAMD, Rregullores së Fakultetit të Biznesit parashikohet përfshirja e studentëve në mënyre thelbësore në organet vendimmarrëse (senatin akademik) dhe këshilluese të institucionit, Përfaqësimi i studentëve bëhet edhe në Komisionin e etikës, Statuti i UAMD, neni 22. Gjithashtu, Një veprimtari e rëndësishme e sanksionuar në rregulloren e FB janë Këshillat e Studentëve të cilat mbrojnë dhe përfaqësojnë interesat e studentëve në të gjitha programet e studimit dhe për të bërë të ndjeshëm opinionin e tyre.</p> <p><i>Referenca: Evidenca 2: Statuti i UAMD, neni 22</i> <i>Referenca: Evidenca 4: Rregullore e UAMD, Neni 12</i> <i>Referenca: Evidenca 19: Rregullore e Fakultetit të Biznesit</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Mbështetur në Statut, në disa nga rregulloret sanksionohet e drejta e studentëve për t'u përfaqësuar dhe patur rol në vendimmarrje.</p> <p>Pjesëmarrja e studentëve në disa komisione, në Senat, në grupet e vlerësimit të brendshëm të programeve është mundësi e drejtpërdrejtë për të ndikuar në rishikimin e përmirësimin e programeve.</p> <p>https://www.uamd.edu.al/index.php/sq/2022/02/04/njoftim-mbi-zgjedhjet-studentore/</p> <p><i>Referenca: Evidenca 29 Model pyetsori për vlerësimin e stafit akademik</i> <i>Referenca: Evidenca 40 Analiza e rezultateve të anketimit për studentët, stafin akademik dhe administrativ)</i> <i>Referenca: Evidenca 32 Raport vlerësimi për stafin akademik nga studentët shembull</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse</p>	<p>Departamenti i marketingut, referuar Statutit të UAMD,</p>

<p>garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Rregullores së UAMD “Të drejtat dhe detyrimet e studentëve “Rregullores së Fakultetit të Biznesit, u krijon studenteve mundësi të jenë të perfaqësuar, të mbrojnë interesat e tyre , të shprehin lirisht mendimet dhe opinionet, nepermjet zbatimit te Pyetësorit të studentit</p> <p>Ky pyetesor vlerëson performancën e stafit akademik të angazhuar në mësimdhënie, vlerëson karakteristika që lidhen me aftësitë komunikuese dhe profesionale të pedagogut, etikën, metodat inovative të përdorura, korrektesën, vlerësimet e dijeve të studentit etj. Ky pyetësor zhvillohet në fund të çdo semestri, zakonisht javën e 13 dhe të 14-të. Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies kryhet për të gjithë pedagogët me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, por që në formën që bëhet është shumë i përgjithshëm, duke mos kontribuar drejtëpërdrejtë në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm të kurrikulës dhe dinamikës gjatë studimeve.</p> <p><i>Duhet bërë më shumë për të krijuar traditën e fokus grupeve, mbledhjeve peridoke dhe mbështetjes për hapat më tej të karrierës së studentëve.</i></p> <p><i>Referenca: Evidenca 19 Rregullore e Fakultetit të Biznesit, neni 79</i></p> <p><i>Referenca: Evidenca 27 RVB e fakultetit te biznesit 2020-2021, Seksioni III</i></p> <p><i>Referenca: Evidenca 99 Pyetsor për studentët e Masterit Shkencor “Menaxhim Marketing”</i></p> <p><i>Referenca: Evidenca 38 Relacion i NjBSC mbi realizimin e mesimdhënies online dhe pyetesori</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>GVJ duke u bazuar ne takimet ne IAL si dhe duke studiuar rregulloren e FB, konstatoi se sipas rregullores se Fakultetit të Biznesit, neni 54, “ Kontrolli i dijeve”, forma e vetme e kontrollit të dijes në Fakultetin e Biznesit është provimi me shkrim. Për çdo kurs 10% e vlerësimit bazohej në detyrat e kursit, projektet individuale apo në grupe, dhe esetë, sipas programit të lëndës se miratuar. Në format e kontrollit përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit kthehet në notë sipas formulës së përcaktuar me vendim të Senatit Akademik. Vlerësimi përfundimtar i çdo kursi kryhet duke u bazuar në shumën e pikëve të grumbulluara gjatë zhvillimit të kursit (maksimalisht 1000 pikë) si më poshtë: a) Provimi i parë i ndërmjetëm, i cili zhvillohet në javën e shtatë dhe/ose të tetë të</p>

	<p>semestrit, përmban 400 pikë ose 40% të vlerësimit përfundimtar; b) Provimi përfundimtar, i cili zhvillohet në javën e pesëmbëdhjetë dhe/ose të gjashtëmbëdhjetë të semestrit, përmban 500 pikë ose 50% të vlerësimit përfundimtar; c) Detyrat, projektet, esetë, të cilat zhvillohen gjatë gjithë semestrit, aktivizimi gjatë orëve të mësimi, përmbajnë 100 pikë ose 10% e vlerësimit përfundimtar.</p> <p>Gjate takimeve me studentet dhe pedagogët e këtij programi studimi, u vërejt që në lidhje me procesin e ankimimit të rezultateve të provimit studentët kanë të drejtë të ankohen (kjo e mbështetur dhe në rregulloren e programit Master mbi ankimimin e rezultatit të provimit, neni 26) sipas nje procedure te mire percaktuar, duke ju drejtuar me nje ankese me shkrim drejtuesit të Njësisë Kryesore ku bën pjesë ai/ajo, jo më vonë se 3 ditë kalendarike nga dita e publikimit të rezultateve. Nëse e sheh të arësyeshme drejtuesi i Njësisë Kryesore, i kalon për shqyrtim kërkesën përgjegjësit të departamentit që mbulon kete program studimi, shqyrton kërkesën dhe vë në dijeni personelin akademik të kursit. Me pas ai dërgon një relacion shpjegues tek drejtuesi i Njësisë Kryesore. Drejtuesi i Njësisë Kryesore vendos për miratimin ose refuzimin e kërkesës së studentit në bazë të relacionit. Nëse kërkesa refuzohet, studenti njoftohet për këtë vendim dhe për arësyet e refuzimit. Nëse kërkesa miratohet, Dekani ngrë një komision ad-hoc për rishikimin e tezës, e cila realizohet në prezencë të studentit dhe komisionit. Në përfundim të ketij procesi mbahet një procesverbal i veçantë ku pasqyrohet vendimi me arësytimin përkatës. Në rast se ka ndryshim në vlerësimin e provimit, atëherë ky ndryshim pasqyrohet në procesverbalin e kursit duke ndjekur procedurat e përcaktuara në rregulloren e UAMD-së.</p> <p><i>Referenca: Evidenca 4: Rregullore e UAMD, nenet 68, 69 &70</i> <i>Referenca: Evidenca 19: Rregullore e Fakultetit të Biznesit, nenet 53, 54, 55</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ në lidhje me standardin "Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre" vlerëson që përtej pjesës formale ka hapësira për përmirësim dhe ndërveprim</i></p>

	<i>real, pyetësori i vlerësimit të procesit mësimor dhe stafit duhet të jete me specifik duke kontribuar drejtëpërdrejtë në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm të kurrikulës dhe dinamikës gjatë studimeve në këtë program studimi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë, Statutin dhe Rreguloret intucionale në nivel universiteti dhe fakulteti, në shërbim të informimit të studentit dhe të përparimit të tij në sistem nga momenti që kërkon informacion mbi programin, deri në diplomimin e tij, janë një sërë zyrash brenda njësisë kryesore dhe në rang universiteti. Gjithashtu ky informimi i studenteve bëhet dhe në forma të ndryshme si takime të drejtëpërdrejta me studentët, shpalljeve në mjediset e caktuara të universitetit, njoftimeve në website apo rrjete sociale të cilat janë mjaft aktive. Në website studentët mund të shkarkojnë çfarëdo lloj dokumenti që ju shërben edhe për tarifën e studimeve.
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	GVJ konstatoi se institucioni ka vënë në dispozicion, disa instrumente për informimin dhe ndjekjen e përparimit të studentëve. Vënia në dispozicion i emaileve të pedagogëve mentorues përmes të cilëve studentët krijojnë një komunikim të vazhdueshëm për procesin mësimor oraret e konsultimeve të pedagogëve , Sekretaria e Masterit, e cila ndër të tjera shërbente edhe për të asistuar studentët për problematikën që ata ndeshin në përditshmërinë e tyre, Zyra e këshillimit të karrierës e cila pervec mbajtjes se statistikave mundeson dhe lidhjen e studenteve me tregun e punes. Por ne vleresojme se këtu ka vend për përmiresime.
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës.	Universiteti “Aleksandër Moisiu” e ka në strukturën e tij Zyrën e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës, e cila ka si funksion parësor të saj ofrimin e mundësive për vende pune, trajnime dhe

<p>Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>internship-e për studentët aktualë dhe ata që janë diplomuar pranë Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës. Kjo Zyrë ka mundësuar disa bashkëpunime efektive me Kompani të ndryshme por nga GVJ gjatë takimit me studentët, evidentuan që studentët në përgjithësi u shprehën pozitivë për eksperiencën e tyre në programin MSH MM, ndonëse dukeshin konfuzë për kompetencat që ky program ofron dhe për perspektivën që ata kanë në tregun e punës.</p> <p><i>GVJ sugjeron më shumë aktivitete për studentët, më shumë ndërveprim me tregun e punës, më shumë nxitje për studentët që të aplikojnë për Erasmus, më shumë mundësi intership-esh dhe punësimi.</i></p> <p>https://www.uamd.edu.al/index.php/sq/karriera/</p>			
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Nga vizita ne institucion dhe keqyrja e dokumentacionit perkates u konstatua se Zyra e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi punësimin e studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ në lidhje me standardin “Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët” vlerëson që ka vend për përmirësim, më shumë ndërveprim e fokus të studenti. Si u permend me lart GVJ sugjeron më shumë aktivitete për studentët, më shumë ndërveprim me tregun e punës, më shumë mundësi intership-esh dhe punësimi.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së</p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet</p>
--	--------------------------	--------------------------	--------------------------

standardeve të fushës V	permbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>GVJ konstatoi qe institucioni inkurajon zhvillimin e metodave innovative të mësimdhënies permes ndërthurjes së metodave teorike me ato praktike. Disa nga metodat ishin vizitat studimore të studentëve në bizneset e lidhura me fushën e studimit, leksione të hapura me të ftuar ekspertë nga tregu i punës. U vu re se një objektiv rëndësishëm strategjik i institucionit është edhe favorizim i metodologjive të reja dhe mësimdhënia inovative, që e pozicionojnë studentin në qendër të procesit duke inkurajuar të menduarin kritik, përgatitjen për tregun e punës dhe promovimin e dialogut student-pedagog</p> <p>UAMD i kushton rëndësi metodave dhe përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies, të parashikuara edhe në Rregulloren për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, ku jepen edhe standardet kryesore për sigurimin e brendshëm të cilësisë kjo nuk është e mjaftueshme pasi vlerësojmë që institucioni nuk duhet të limitohet vetëm në këtë aspekt dhe duhet të bëjë më shumë për tu pajisur në nivel institucional me metoda të ndryshme innovative në fushën e mësimdhënies.</p> <p><i>Referenca: Evidenca 1: Plani i zhvillimit strategjik te UAMD 2020 – 2025</i></p> <p><i>Referenca: Evidenca 22: Analiza vjetore e departamentit 2021 – 2022, fq 22 – 24</i></p> <p><i>Referenca: Evidenca 28: Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Cilësisë UAMD</i></p>

<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>UAMD ka ngritur struktura për monitorimin dhe vlerësimin në mënyrë periodike të aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik. IAL përdor këto instrumenta si:</p> <p>Analizimi i kalendarit të aktiviteteve, Pyetësi i vlerësimit të pedagogëve nga studentët si dhe formularet e vlerësimit të performancës. Këto vlerësime behen nga njësia baze, nga stafi i drejtorisë përgjegjëse për sigurimin e cilësisë në UAMD. Nga takimi i GVJ me stafin e angazhuar në Njësinë e sigurimi të cilësisë u vu re që ata kishin eksperiencë me këto procedura. Pavarësisht kësaj, u vu re dhe një qasje pro-aktive për të përmirësuar procedurat e monitorimit, dokumentimin etj.</p> <p><i>Referenca: Evidenca 29 Model pyetësi për vlerësimin e stafit akademik</i></p> <p><i>Referenca: Evidenca 30 Formulari vetëvlerësimit të performancës model Referenca: Evidenca 28: Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Cilësisë UAMD</i></p> <p><i>Referenca: Evidenca 29: Model pyetësi për vlerësimin e stafit akademik</i></p> <p><i>Referenca: Evidenca 30: Formular i vetëvlerësimit të performancës model</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>GVJ nga analiza që I beri dokumentacioneve dhe RVB si dhe nga vizita në institucion konstatoi se NjSBC evidenton dhe ndjek problematikat e lidhura me cilësinë e mësimdhënies; bën vlerësimin periodik të rezultateve të veprimtarive mësimore dhe kërkimore shkencore; Organizon dhe ndjek zhvillimin e pyetësorit për cilësinë e mësimdhënies për çdo program studimi. Nga ky pyetësor sigurohet mbledhja e informacionit nga ana e studentëve, me qëllim tërheqjen e opinionëve të tyre lidhur me procesin mësimor apo edhe ndonjë dukuri tjetër e lidhur direkt dhe/ose indirekt me të.</p> <p>Pyetësi është i miratuar nga Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standarteve dhe Cilësisë (KPGSC) dhe Senati Akademik dhe përcaktuar në Rregulloren e Sistemit të Brendshëm të Cilësisë, neni 6, dhe ky pyetësor shërben si një instrument vlerësimi në Fakulteti i Biznesit, dhe nga departamenti i Marketingut për këtë program studimi, MSHMM.</p>

	<p><i>Referenca: Evidenca 28: Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Cilësisë UAMD</i></p> <p><i>Referenca: Evidenca 29: Model pyetesori për vlerësimin e stafit akademik</i></p> <p><i>Referenca: Evidenca 31: Rregullore provimesh FB, paragrafi C, pika 8 dhe 10</i></p> <p><i>Referenca: Evidenca 4: Rregullore e UAMD, neni 71</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Drejtoria e Kurrikulës dhe Standarteve të Cilësisë ja dërgon rezultatet e marra nga pyetësi i studentit në formë elektronike përgjegjësit të departamentit në tabelë përmbledhëse vetëm për lektorët e departamentit të tij, dekanatit në tabelë përmbledhëse vetëm për lektorët e Njësisë Kryesore të tij, si edhe për transparencë i dërgohen edhe çdo lektori personalisht duke ruajtur konfidencialitetin e të dhënave, sipas ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.</p> <p>Në qoftë se nje lektor nuk del me rezultat pozitiv, sipas dokumentit, atëherë kërkohet që këta lektorë të thirren në takim nga përgjegjësi i departamentit për të kryer një analizë të arsyeve të vlerësimit të lartpërmendur. Gjithashtu, duhet që ata të marrin masat e nevojshme përmes veprimeve konkrete për përmirësimin e rezultatit në vlerësimet e mëvonshme, përfshirë edhe pjesëmarrjen në trajnimet e organizuara nga Qendra për Edukimin në Vazhdim në UAMD. Por se si këto rezultate janë përdorur në qëllim të përmirësimit të programit të studimit nuk mund të vlerësohet pasi mungojnë evidenca. Po kështu nga takimi me studentët që ndjekin këtë program studimi mungonte feedback që ata kanë sepse ata nuk janë të informuar sa duhet për procesin dhe rolin që ata kanë në përmirësimin e programit të studimit.</p> <p><i>Referenca: Evidenca 32: Raport vlerësimi për stafin akademik nga studentët shembull</i></p> <p><i>Referenca: Evidenca 33: Tabela e vlerësimit të stafit akademik nga rektorati</i></p> <p><i>Referenca: Evidenca 25: Analiza vjetore e UAMD, 2021-2022, fq 52-53</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të</p>	<p>GVJ nuk mund të japë vlerësim në lidhje me këtë kriter pasi mungojnë evidenca për këtë pikë.</p> <p><i>Prandaj është e nevojshme që njësia e sigurimit të cilësisë të krijojë mekanizma për ta vlerësuar dhe promovuar më pas.</i></p>

praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.									
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson perpjekjet që UAMD ka bere për të institucionalizuar procesin e matjes, krijimi të indikatorëve dhe më pas monitorimit e vlerësimit të cilësisë për programin e studimit në fjalë dhe në përgjithësi, por duhen te kete evidenca si kane ndikuar keto ne kete program studimi. Duhet të krijohen dhe mekanizma për ta vlerësuar dhe promovuar më pas.</i>								
Shkalla e përbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <th>Nuk përbushet</th> <th>Përbushet t pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </table>	Nuk përbushet	Përbushet t pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht			X	
Nuk përbushet	Përbushet t pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
		X							

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	<p>Në mbështetje të Ligjit 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, nenit 103, Senati Akademik i UAMD ka miratuar Rregulloren e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë. Deri në Prill të vitit 2021, në UAMD, Drejtoria e Kurrikulave & Standarteve të Cilësisë funksiononte edhe si Njësi e Sigurimit Brendshëm të Cilësisë.” Më pas, me Urdhër të Rektorit, është ngritur Njësia e re e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë me anëtarë të stafit akademik nga çdo fakultet i UAMD, drejtuesi i drejtorisë përgjegjëse për sigurimin e cilësisë, si dhe një student. Risia e përbërjes së njësisë ishte përfaqësimi me anëtarë nga stafi akademik me kohë të plotë, si përfaqësues dhe njohës të drejtëpërdrejtë të mjedisit akademik. Misioni kryesor i NjBSC është planifikimi i përmirësimit të vazhdueshëm të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës (UAMD) dhe realizimi i proceseve që e garantojnë këtë përmirësim. Procesi i përmirësimit të vazhdueshëm mundësohet nga angazhimi i të gjitha palëve të përfshira në SBSC.</p> <p><i>GVJ vlerëson që duhet të bëhen më shumë përpjekje për të hartuar indikatorë të matjes së cilësisë që bëjnë të mundur</i></p>

	<p><i>monitorimin e vazhdueshëm të cilësisë.</i></p> <p><i>Referenca: Evidenca 34 Urdheri i Rektorit per ngritjen e NjsBC-se</i></p> <p><i>Referenca: Evidenca 28 Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Cilësisë UAMD,</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Institucioni ka të ngritur dhe mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë I cili perbehet nga Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë (KPGSC), Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë në nivel institucional, si dhe Drejtoria e Kurrikulave dhe Standardeve të Cilësisë që ushtrojnë detyrat e tyre në ruajtjen e standardeve dhe sigurimin e cilësisë së institucionit. Prioritetet strategjike të universitetit dhe të fakultetit, janë të fokusuar në përmirësimin e vazhdueshëm, në drejtim të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, ku studentët janë në qendër të filozofisë së universitetit, mbështetur nga grupet e interesit Për të siguruar një informacion sa më të saktë mbi studentët dhe kërkesat e tyre, si dhe për të marrë vendime në interes të tyre NJSBC dhe KPSC kanë në përbërje edhe një student.</p> <p>Universiteti në nivel fakulteti si edhe Departamenti, ka realizuar takime me biznese dhe ka angazhuar edhe bashkëpunëtorë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj, si pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë. Në disa raste merren parasysh edhe sugjerimet e studentëve.</p> <p>Këto aktivitete, kanë ndikuar në rritjen e vazhdueshme të cilësisë.</p> <p><i>GVJ vlerëson që duhet të bëhen më shumë përpjekje për ta bërë aktiv këtë komponent.</i></p> <p><i>Referenca: Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Cilësisë UAMD, nenet 2, 8.9,10</i></p> <p><i>Referenca: Evidenca 35 Kerkese nga studente per futjen e lendeve te reja ne kurrikulen e MSC</i></p> <p><i>Referenca: Evidenca 26 Analiza Vjetore e Departamentit të Marketingut, 2021-2022</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e</p>	<p>Nga GVJ u arrit në konkluzionin se UAMD përdor instrumente për sigurimin e cilësisë të cilat janë dhe pjesë e Rregullores për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të</p>

<p>cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Sigurimit të Cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit në bashkëpunim me ASCAL.</p> <p>Nga takimet me stafin e angazhuar në programin e studimit u pranua se më shumë praktika duhen dokumentuar dhe institucionalizuar dhe se proceset e akreditimit janë një mënyrë për të nxitur IAL-në në këtë drejtim.</p> <p><i>Akreditimi institucional dëshmon që IAL është në drejtimin e duhur dhe se çdo strukturë përbërëse e IAL duhet të bëjë përpjekje për tu pajisur me mekanizma dhe indikatorë të matshëm të cilët më pas i japin mundësinë IAL-së , të masë, analizojë, krahasojë dhe përmirësojë programin e studimit në mënyrë periodike.</i></p> <p><i>Referenca: Evidenca 37 Vendimi i akreditimit institucional 2022 UAMD</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, RVB dhe vizita në IAL vihet re se akoma instiucioni nuk ka konsoliduar një paketë indikatorësh dhe plan aktiviteti për procesin e monitorimit të cilësisë përveç pyetësorit të studentëve. Këtij të fundit duhet ti bashkëngjiten edhe instrumenta të tjerë. Gjatë periudhës së pandemisë, NJSBC ka zhvilluar një pyetësor drejtuar studentëve mbi mësimdhënien online, si një formë relativisht e re në kulturën akademike shqiptare. Qëllimi i këtij anketimi ishte konstatimi i problematikave dhe pikave të forta që paraqet mësimi online. Rezultatet e këtij pyetësori u përmbledhën në një raport dhe ju vunë në dispozicion stafit akademik.</p> <p><i>Referenca: Evidenca 38 Relacion i NjBSC mbi realizimin e mesimdhënies online dhe pyetesori</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson që IAL duhet të bëjë më shumë përpjekje për të hartuar një paketë dhe plan veprimi periodik për monitorimin e cilësisë së programit të studimit. Cdo strukturë përbërëse e IAL duhet të bëjë përpjekje për tu pajisur me mekanizma dhe indikatorë të matshëm të cilët më pas i japin mundësinë IAL-së , të masë, analizojë, krahasojë dhe përmirësojë programin e studimit në mënyrë periodike.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se institucioni UAMD përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të dytë. Ky proces kryhej nga DKSC, e cila harton raporte periodike kontrolli mbi programet e studimeve dhe kurrikulat në veçanti duke konstatuar problematika dhe duke dhënë sugjerimet përkatëse për përmirësimin e tyre, të cilat ja drejton departamenteve përkatëse zyrtarisht. Gjithashtu, nga DKSC realizohej kontrolli i kurrikulave të propozuara, sipas akteve ligjore në fuqi mbi riorganizimin mbi dhe nën 20%, si dhe për hapjet e programeve të reja</p> <p>Nga ky proces ishte kryer një riorganizim i programeve të studimit në Fakultetin e Biznesit, sigurisht dhe i këtij programi, në vitin akademik 2021-2022, për arsye të përshtatjes me kërkesat e studentëve dhe të tregut të punës për njohuri e kompetenca më të gjëra.</p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Raportet e vlerësimit japin një analizë të qartë të aspekteve akademike mbi kurrikulat, mësimdhënien, ndërkombëtarizimin e universitetit, projektet dhe aktivitetet e zhvilluara si pjesë e aktiviteteve jashtë kurrikulare etj. Raportet e vlerësimit kryhen në nivel institucional nga NJSBC e institucionit, strukturat administrative të Rektoratit, NJSBC-të e fakulteteve dhe departamentet, <i>por nuk ka praktikë për përfshirjen e rezultateve për të motivuar arritjet më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët apo masat e marra për adresimin e mangësive në vijim të përmirësimin të cilësisë.</i></p> <p><i>Referenca: Evidenca 39 Raporti i vetevlerësimit 2019 – 2020</i></p>

	<p><i>NJSBC</i> <i>Referenca: Evidenca 27 RVB e fakultetit te biznesit 2020 – 2021</i> <i>Referenca: Evidenca 26 Analiza vjetore e departamentit 2021 – 2022</i> <i>Referenca: Evidenca 25 Analiza vjetore e UAMD 2020 – 2021</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve dhe këtë e bën nëpërmjet Drejtorisë së Kurrikulës dhe Standarteve të Cilësisë (DKSC). Kjo drejtori mban të dhëna të ndryshme mbi institucionin dhe mbledh të dhëna nga NjBSC-të në nivel Fakulteti dhe Koordinatorët e Programeve. Kjo njësi realizon raportin e vlerësimit të brendshëm, i cili paraqet një studim të funksionimit institucional të UAMD-së dhe përmbushjen e standardeve të cilësisë për vitin akademik, i cili hartohet duke u bazuar në 5 fushat e vlerësimit. Ky raport përmbledh evidencat me anë të të cilave vlerësohet përmbushja e standardeve të cilësisë dhe veprimtarive akademike dhe mësimore, si dhe mundëson analizimin e nevojave dhe vendosjen e synimeve për zhvillimin e cilësisë.</p> <p>GVJ konstatoi se procesi i vlerësimit të stafit akademik në departament realizohet nga drejtuesi i njësisë bazë dhe nga drejtuesi i njësisë kryesore. Në bazë të formularëve të raporteve çdo lektor vlerësohet me pikë për çdo fushë të kërkimit të tij shkencor gjatë një viti akademik, i cili bëhet në bazë të formatit të vlerësimit. Gjithashtu, cilësia e mësimdhënies vlerësohet edhe përmes procesit të vlerësimit të stafit akademik, që zhvillohet nëpërmjet plotësimit nga studentët të një pyetësori (në javën e 13 ose të 14 të semestrit përkatës).</p> <p>Nga takimet e realizuara në institucion u verejt që lektorët dorëzonin në mënyrë periodike dhe CV-të e rifreskuara dhe dosjet e tyre të vetëvlerësimit, të cilat i dispononin të gjithë përgjegjësat e departamenteve, drejtorja e burimeve njëzëzore.</p> <p><i>Referenca: Evidenca 30 Formular vetëvlerësimi e performances Model</i> <i>Referenca: Evidenca 29 Model pyetësori për vlerësimin e stafit akademik</i></p>

<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>GVJ konstatoi se UAMD aplikon një sërë instrumentash vlerësimi, si në drejtim të mësimdhënies, përmes pyetësorit që studentët plotësojnë për pedagogët e tyre, vlerësimi i institucionit nga stafi administrativ, ai akademik dhe studentët, si dhe propozime të ndryshme për risi apo përmirësime të kurrikulave që vijnë si nga partnerët nga tregu i punës, ashtu edhe nga studentët e ciklit të parë. Sondazhet që zhvillohen rregullisht mbi punësimin e ish - studentëve alumni zga Zyra e Karrierës janë një bazë të dhënash me shumë vlerë për të parë ndikimet e arsimit tek studentët dhe oportunitetet e tregut të punës, te cilat ndikojne ne permiresimin e kurrikules se programit te studimit MSHMM.</p> <p><i>Referenca: Evidenca 38: Relacion i NjBSC mbi realizimin e mesimdhënies online</i> <i>Referenca: Evidenca 40: Analiza e rezultateve të anketimit për studentët, stafin akademik dhe administrative</i> <i>Referenca: Evidenca 41: Shoqata Alumni UAMD dhe aktivitetet</i> <i>Referenca: Evidenca 41.1: Punesime master shkencor Menaxhim Marketing</i></p>		
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ vlerëson që IAL monitoron dhe vlerëson përmes njërive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, duke garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi VI.4 Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për</p>	<p>GVJ nga vlerësimi që i bëri materialeve dhe vizitave në institucion, arriti në përfundimin që në UAMD është i rëndësishëm angazhimi i studentëve në çdo nivel të vendimarrjes. Përfaqësues të studentëve ka pothuajse në çdo organ kolegjal duke filluar nga Senati Akademik, Bordi i Administrimit, NjBSC e institucionit, Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standarteve dhe Cilësisë e deri tek GVB për hartimin e Raporteve të Vlerësimit të</p>

<p>sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Brendshëm për akreditimin institucional dhe të programeve të studimit. Gjithashtu, edhe partnerët e departamentit nga tregu i punës që lidhet me programin e studimit, janë pjesë e vendimarrjeve të departamentit duke propozuar lëndë të reja apo ndryshime kurrikulare në përputhje me nevojat e biznesit për burime njerëzore.</p> <p><i>Referenca: Evidenca 42 Sugjerim nga një biznes për riorganizimin e programit Bachelor ne Menaxhim marketing</i> <i>Referenca: Evidenca 35 Kerkese nga studente per futjen e lendeve te reja ne kurrikulen e MSC</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>GVJ nga analizimi I dokumentacionit dhe RVB, konstatoi se përgjegjësitë dhe detyrat konkrete të personave dhe strukturave përkatëse janë të përcaktuara në nenet e rregullores për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë dhe rregulloren e Fakultetit të Biznesit.</p> <p><i>Referenca: Evidenca 28 Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Cilësisë UAMD</i> <i>Referenca: Evidenca 19 Rregullore e fakultetit te biznesit, neni 22</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit pjesë e sigurimit të cilësisë është edhe NJSBC e fakultetit, në përbërje të së cilës ka një anëtar nga çdo department. Gjithashtu, për hartimin e RVB – ve, si asaj të fakultetit, ashtu edhe të programeve të studimit kontribuojnë të gjitha strukturat ndihmës akademike dhe administrative që kanë lidhje me vlerësimin e standarteve dhe kritereve të cilësisë. Në këtë mënyrë, sigurohet një gjithëpërfshirje e të gjitha strukturave të cilat kanë edhe përgjegjësitë e tyre specifike në këtë drejtim.</p> <p>Megjithatë, GVJ vlerëson që IAL duhet të bëjë përpjekje për të rregulluar procesin e vlerësimin në të gjithë komponentët e programit të studimit. Kjo e fundit patjetër që kërkon bashkëpunimin e të gjithë aktorëve që kanë lidhje direkte dhe indirekte me programin e studimit dhe përmirësim të vazhduar të institucionalizimit të proceseve që lidhen me të.</p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimin duhet</p>	<p>Nga vizita në IAL u kuptua që ky kriter plotësohet për proceset e vlerësimin që janë realizuar deri tani, përmendim këtu që IAL ka kaluar dy procese të vlerësimin dhe akreditimit institucional. Ky i fundit e ka ndihmuar institucionin të identifikojë fushat e</p>

të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	përmirësimit në procesin e vlerësimit të cilësisë së programit të studimit.								
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Nga vizita në IAL dhe shqyrtimi i dokumentacionit, evidentohet që ekspertë të jashtëm apo bashkëpunëtorë të tjerë janë të përfshirë në procesin e vlerësimit. Ekspertët e jashtëm, bashkëpunëtorët e departamentit të marketingut dhe UAMD-së në tregun e punës, specialistë nga institucionet ku studentët kryejnë praktikat profesionale, si dhe punëdhënësit e studentëve të diplomuar në fakultetin e biznesit kanë dhënë propozime të vlefshme për përmirësimin e cilësisë veçanërisht të kurrikulave, duke marrë pjesë si të ftuar gjatë leksioneve me anëtarët e departamentit, si dhe pjesë aktive në konferencat shkencore të organizuara nga departamenti i marketingut dhe fakulteti i biznesit vitet e fundit, dhe duke ndihmuar në iniciimin e propozimeve konkrete për përmirësime të kurrikulës por ka nevojë për përmirësim të mëtejshëm. <i>Referenca: Evidenca 42 Sugjerim nga një biznes për riorganizimin e programit Master shkencor Menaxhim Marketing</i> <i>Referenca: Evidenca 26 Analiza vjetore e departamentit 2021 – 2022, fq 31 – 35</i>								
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson që IAL ka bërë përpjekje për të përfshirë njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC- së të programit të studimit por ky proces ka nevojë për përmirësim të mëtejshëm në drejtim të: praktikave të vlerësimit, institucionalizimit të tyre si dhe përfshirjes së një baze të gjerë studentësh dhe aktorë me ekspertizë në tregun e punës.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia,	GVJ duke u mbështetur në dokumentacionin perkates dhe nga

<p>organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>vizita ne institucion, takimet me stafin, studentet etj konstatoi se fakulteti dhe departamenti realizonte në mënyrë periodike raportin vjetor te vetevleresimit të brendshëm dhe analizat vjetore, të cilat japin informacion mbi çështjet akademike dhe të programeve të studimit nga lektorët, stafit administrativ dhe studentët. Gjithashtu u konstatua se ne UAMD realizohej nje raportim vjetor nga ana e rektoratit mbi çështjet akademike, kërkimore shkencore dhe financiare të universitetit. Rezultatet e këtij raporti prezantoheshin në fund të vitit në një mbledhje të hapur me prezencën e Senatit.</p> <p><i>Referenca: Evidenca 17: Analiza vjetore e UAMD 2021 – 2022</i> <i>Referenca: Evidenca 39: Raport i vetevleresimit 2019 – 2020 NjSBC</i> <i>Referenca: Evidenca 26: Analiza Vjetore e Departamentit të Marketingut, 2021-2022</i> <i>Referenca: Evidenca 27: RVB e fakultetit te biznesit 2020 - 2021</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>GVJ vëren se publikimi i rezultateve të vlerësimit të programit të studimit bëhet në përputhje me ligjin dhe aktet e UAMD-së. Qëllimi i vlerësimit është paraqitja e të dhënave mbi programet e studimit duke bërë të mundur që të gjithë palët e interesuara të kenë mundësinë të njihen me to, si dhe përmirësimi i tyre. Nga shqyrtimi i raporteve të publikuar në faqen e UAMD si dhe pyetësorët e ndryshëm, nuk rezulton që të jetë çenuar liria akademike apo të dhënat personale.</p> <p><i>Referenca https://uamd.edu.al/informacione-dhe-dokumenta/</i> <i>Referenca: https://uamd.edu.al/transparenca/</i></p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>GVJ konstatoi se raporti i vetëvlerësimit në nivel institucional, si dhe ai në nivel fakulteti pas vlerësimit të fushave respektive, referuar rezultateve të konstuara ofron edhe rekomandime dhe masa të caktuara për përmirësimin e situatës.</p> <p><i>Referenca Evidenca 39: Raport i vetëvlerësimit 2019 – 2020 NjSBC, fq 47 – 48</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e</p>	<p>Nga vizita ne UAMD si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit u vu re se planet e masave komunikohen sipas rastit nga Rektorati për dekanët e fakulteteve, nga dekanati apo nga përgjegjësit e</p>

veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	<p>departamenteve për anëtarët e stafit akademik etj Nëpërmjet procesit vlerësues synohet: kontrolli i cilësisë, vlerësimi i gjendjes së cilësisë dhe propozime për përmirësimin e saj.</p> <p><i>GVJ vlerëson që ky proces është në zhvillim e sipër dhe nuk mund të gjykohet akoma për efektivitetin dhe impaktin që ka në sigurimin e cilësisë së programit të studimit MSHMM.</i></p>			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	<p>GVJ vëren se institucioni ka organizuar veprimtari relativisht periodike me personelin dhe me studentët me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin për sigurimin e përmirësimin e cilësisë së programit të studimit, nëpërmjet zhvillimit nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të seancave të informimit të studentëve mbi rëndësinë e zhvillimit të pyetësorëve të vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies, treguesit e përdorur e mënyra e interpretimit të tyre si dhe përfshirjes së stafit akademik në proceset e vlerësimit të brendshëm dhe akreditimit, për mundësinë e trajnimit e të përfitimit të përvojës në këtë</p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ vlerëson punën e vazhdueshme të IAL në procesin e vlerësimit dhe monitorimit të cilësisë së programit të studimit, si dhe perpjekjet e vazhdueshme për të përmirësuar procesin Realizimi i tyre me efektivitet ka bërë të mundur krijimin e një kulture të brendshme të sigurimit të cilësisë.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardevë të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Menaxhim Marketing” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës

Pikat e forta dhe afirmime

1. Programi i studimit Master Shkencor në Menaxhim Marketing i përgjigjet kërkesave dhe nevojave të shoqërisë duke formuar menaxherë marketingu të aftë për adresimin e sfidave të kohës.
2. Kualifikimi i stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi.
3. Metodologjia interactive e mësimdhënies.
4. Mundësitë e sigurimit të institucioneve ku studentët mund të ndjekin praktikën në sajë marrëveshjeve të bashkëpunimit që IAL ka nënshkruar.
5. Organizimi nga Departamenti i Marketingut i një Konference Shkencore Ndërkombëtare të e cila vendos në qendër fushën e marketingut në mënyrë specifike.
6. Mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik.

Pika të dobta

1. Nuk ka një Plan Strategjik për zhvillimin e këtij programi studimi. [(Standardi II.4 /Kriteri 5)]
2. Mungon një studim tregu aktual, studimi më i fundit i realizuar i takon vitit 2009 kur ky program studimi është hapur. [(Standardi II.6/ Kriteri 1)]
3. Ka një mospërputhje në syllabuset e lëndëve të programit të studimit lidhur me % penalizuese të frekuentimit, pasi kjo nuk i përmbahet përshkrimit të përcaktuar në rregulloren e institucionit si dhe është gjithashtu në mospërputhje me udhëzimin ligjor. [(Standardi V.5 /Kriteri 3)]
4. Nuk ka një strategji ndërkombëtarizimi aktuale. [Standardi VI.II/ Kriteri 3)]
5. Mungesa e një pakete dhe plani veprimi periodik për monitorimin e cilësisë së programit të studimit. [(Standardi VI.II /Kriteri 3)]

Rekomandime

1. GVJ konstaton se institucioni nuk ka hartuar një Plan Strategjik për zhvillimin e programit të studimit i cili do të reflektonte më qartësisht përputhjen mes prioriteteve dhe

objektivave të përshkruara në planin strategjik të institucionit dhe prioriteteve dhe objektivave të studimit dhe kërkimit shkencor të programit të studimit.

2. GVJ konstaton se nuk ka një studim tregu të aktualizuar i cili do ti shërbente nevojave të programit të studimit për përditësimin e syllabuseve. GVJ sugjeron ndërmarrjen e një studimi tregu aktual në funksion të përmirësimit të programit të studimit.
3. Sipas nenit 66, pika 2 “Frekuentimi i orëve mësimore”, të Rregullores së IAL frekuentimi në këtë program studimi është i detyrueshëm në masën 75%, dhe përcaktohet se nëse studenti arrin mbi 25% të mungesave skualifikohet dhe nuk mund të futet në provimin përfundimtar. Ky përcaktim në rregulloren e IAL është në përputhje me pikën 3.a të udhëzimit nr.6479 prot. Datë 07.10.2022. Por, GVJ konstaton se në syllabuset e lëndëve të këtij programi studimi përcaktohet se “studenti që mungon në 25% të orëve të kursit vlerësohet automatikisht me notën 4 dhe duhet të ndjekë përsëri kursin vitin e ardhshëm” duke qenë në kontraditë me pikën 2 të nenit 66 të rregullores së IAL si dhe me udhëzimin ligjor.
4. GVJ konstaton se IAL nuk ka një strategji ndërkombëtarizimi aktuale, ndërsa në dokumentin e planit strategjik të IAL përmendet Strategjia e Ndërkombëtarizimit 2019-2021. GVJ sugjeron hartimin e strategjisë së ndërkombëtarizimit për periudhën 2022 e në vijim.
5. GVJ rekomandon përmirësimin e praktikave të vlerësimit, institucionalizimit të tyre si dhe përfshirjes së një baze të gjerë studentësh dhe aktorë me ekspertizë në tregun e punës.
6. GVJ rekomandon që njësia e sigurimit të cilësisë të krijojë mekanizma me te mire të vlerësimit të mesimedhenies dhe sidomos të promovojë praktikat me te mira
7. GVJ sugjeron më shumë aktivitete për studentët, më shumë ndërveprim me tregun e punës, më shumë mundësi intership-esh dhe punësimi.

Evaluation’s conclusions for the second cycle study program Master of Sciences in “Marketing Management” provided by the Higher Education Institution “Aleksandër Moisiu University”

Strengths and affirmations

1. The Master of Science in Marketing Management study program responds to the demands and needs of society by forming marketing managers capable of addressing the challenges of the time.
2. Qualification of the academic staff engaged in this study program.
3. Interactive teaching methodology.
4. Possibilities of securing institutions where students can follow practice thanks to the signed cooperation agreements signed by HEI.
5. The Marketing Department's organization of an International Scientific Conference, which focuses on the field of marketing specifically.
6. Appropriate learning environment and infrastructure for the implementation of the learning process of the study program and for practical training.

Weaknesses

1. There is no Strategic Plan for the development of this study program. [(Standard II.4 /Criterion 5)]
2. A current market study is missing; the most recent study carried out dates back to 2009, when this study program was opened. [(Standard II.6/ Criterion 1)]
3. The syllabi of the study program subjects regarding the penalty percentage of attendance are inconsistent, as this does not comply with the description set out in the institution's regulation and is also inconsistent with the legal instruction. [(Standard V.5 /Criterion 3)]
4. There is no current internationalization strategy. [Standard VI.II/Criterion 3)]
5. Lack of a package and periodic action plan for monitoring the quality of the study program. [(Standard VI.II /Criterion 3)]

Recommendation

1. GVJ finds that the institution has not drawn up a Strategic Plan for the development of the study program, which would more clearly reflect the agreement between the priorities and objectives described in the institution's strategic plan and the priorities and objectives of the study and scientific research of the study program.
2. GVJ finds that there is no updated market study which would serve the needs of the study program for updating the syllabuses. GVJ suggests undertaking an actual market study to improve the study program.

3. According to article 66, point 2, "Attendance of teaching hours" of the HEI Regulation, attendance in this study program is mandatory to 75%. It is determined that if the student reaches more than 25% of absences, he is disqualified and cannot enter the final exam. This definition in the HEI regulation is in accordance with point 3.a. of instruction no. 6479 prot. Date 07.10.2022. However, GVJ finds that in the syllabuses of the subjects of this study program, it is determined that "the student who is absent in 25% of the course hours is automatically assessed with grade 4 and must attend the course again next year" being in contradiction with point 2 of the article 66 of the HEI regulation as well as with the legal instruction.
4. GVJ finds that HEI does not have a current internationalization strategy, while the 2019-2021 Internationalization Strategy is mentioned in the HEI strategic plan document. GVJ suggests drafting the internationalization strategy for the period 2022 and beyond.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE				X

KOMPETENCAT				
V. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA , LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VI. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VII. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
VLERËSIMI TËRËSOR				X

